



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 4 PRILL 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 4. APRILA 2018. GODINE**

**PRILL - APRIL  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Debat parlamentar lidhur me rastin e deportimit të 6 (gjashtë) shtetaseve të Republikës së Turqisë.

## **Dnevni red**

1. Parlamentarna debata o slučaju deportiranja 6 (šest) državljana Republike Turske.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesë të 40 deputetëve të Kuvendit.

### **1. Debat parlamentar lidhur me rastin e deportimit të gjashtë shtetasve të Republikës së Turqisë**

40 deputetë të Kuvendit kanë kërkuar debat parlamentar lidhur me këtë rast. Prandaj do të fillojmë të diskutojmë sipas kërkesës së 40 nënshkruesve të saj.

E ftoj zotin Avdullah Hoti, që në emër të propozuesit të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debat parlamentar. Zoti Hoti, e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Përfaqësuesit e institucioneve, brenda gjashtë muajve, po na shpijnë nga një krizë në tjetrën, nga një aferë në tjetrën, nga një dështim në tjetrin, duke rrezikuar rezultatet e deritashme të shtetit tonë të ri, të arritura me djersë e me gjak të patriotëve, aktivistëve, luftëtarëve e qytetarëve të shumtë.

Sot duhet të merremi me skandalin e radhës, në vend se të merremi me problemet e jetës së qytetarëve, me arsim e shëndetësi, me varfërinë dhe zhvillimin ekonomik, me punësimin, me pensionet, me bujqësinë që nuk ka ministër, me problemet me energji, me zbatimin e pakove fiskale, me promovimin e investimeve.

Ne të gjithë u shtangëm më 29 mars, e harruam 22 dhjetorin e vitit të kaluar, nga lajmi se gjashtë shtetas turq ishin kidnapuar dhunshëm në pikë të ditës, para nxënësve, kolegëve a familjarëve të tyre.

Në vend që të intervistoheshin nga organet kompetente në Prishtinë, ata u deportuan me urgjencë në Turqi.

Të shtangur kishin mbetur kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, por jo presidenti.

Për një kohë, institucionet nuk konfirmonin nëse këta persona ishin dëbuar menjëherë apo mbaheshin në Kosovë. Në shtetin demokratik të Kosovës, atyre nuk iu lejua asnjë kontakt me familjarët dhe avokatët.

Agjencia për Inteligjencë, bazuar në nenin 6 të Ligjit për të huajt, kishte kërkuar revokimin e lejes së qëndrimit, me arsyetimin se “përbënin rrezik për sigurinë kombëtare”.

Si mund të përbënin rrezik njerëz që kishin arsimuar gjenerata të tëra?

Njëri nga avokatët e këtyre personave kishte deklaruar se 80 për qind e politikanëve, përfshirë presidentin Thaçi, i kanë shkolluar fëmijët në kolegjin “Mehmet Akif”.

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion i Ministrisë së Brendshme, të njëjtën ditë kishte revokuar lejet e qëndrimit. Në vendim, palët e pakënaqura kishin të drejtë ankese.

Për shkak të deportimit me urgjencë, ata nuk kishin pasur mundësi ankese. Kështu, shteti i Kosovës kishte shkelur pikën 3 të nenit 6 të Ligjit për të huajt.

Ata me nguti ishin deportuar me aeroplan të inteligjencës turke.

Lejen për zbarkimin e këtij aeroplani e kishte dhënë ministri Lekaj. Kryeministri ishte mbajtur në terr informativ nga vartësit e tij.

Prokuroria e Shtetit u shfaq konfuze, nuk e dinte çfarë ka ndodhur.

Agjencia për Inteligjencë kishte shkelur nenin 25 të ligjit të saj, që e obligon të informojë prokurorinë kur rrezikohet siguria kombëtare.

Në anën tjetër, takimi i krerëve të shtetit për çështje të rëndësishme të veçantë ndodhi në një restorant privat.

Të nderuar deputetë,

Kryeministri nuk mundi të shkarkojë drejtorin e Agjencisë për Inteligjencë. Ky drejtor sot nuk u paraqit as në komisionin parlamentar.

Kujt i raporton ky drejtor nëse jo kryeministrit dhe komisionit parlamentar?

U shkarkua vetëm ministri i Brendshëm, pasi vjen nga një partner i vogël i koalicionit.

Deklarimi i z. Veseli se ngjarje të tilla nuk do të përsëriten asnjëherë nuk ka kuptim për familjarët e këtyre personave.

Shkelja e të drejtave njerëzore të këtyre personave nuk mund të riparohet me asnjë veprim që shteti mund të ndërmarrë tash e tutje.

Imazhi i Kosovës, si shtet i ri, me orientim evropian, ku sundon rendi e ligji, është dëmtuar seriozisht.

Konventat ndërkombëtare, në veçanti Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndalojnë rreptësishtë dëbimin e individëve në shtetet në të cilat rrezikohet keqtrajtimi i tyre, posaçërisht kur kjo bëhet pa ligj dhe pa mundësi ankese.

Organizatave vendore e ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Fondacioni i të Drejtave të Njeriut me bazë në Nju-Jork, si dhe një pjesë e shoqërisë civile, reagueshin ashpër ndaj këtyre shkeljeve të të drejtave elementare njerëzore. Të mos harrojmë asnjëherë se qindra-mijëra shqiptarë ishin strehuar në shtetet perëndimore, edhe atëherë kur kishin emigruar ilegalisht.

Tash vonë, vetë z. Haradinaj është mbajtur në Francë për tre muaj. Falë parimeve të drejtësisë evropiane, ai u kthye te familja dhe sot është kryeministër. Po të sillëshin shtetet perëndimore siç veproni shteti ynë në këtë rast, jo vetëm z. Haradinaj, por një pjesë e mirë e krerëve të institucioneve tona sot nuk do të frymonin fare.

Tentimi për shfuqizimin e Ligjit për dhomat e specializuara, përmes të cilit Kosova kishte marrë obligime ndërkombëtare dhe tani deportimi i gjashtë shtetasve turq në kundërshtim me ligjet vendore dhe konventat e obligueshme ndërkombëtare, krijojnë pasiguri te qytetarët dhe miqtë tanë perëndimorë.

Komisioni Evropian dje e bëri të qartë se respektimi i ligjit dhe konventave ndërkombëtare lidhur me të drejtat njerëzore është në fundament të integritetit evropian.

Ta kemi të qartë, këto janë shenja të diktaturës nga kapja e shtetit nga një individ. Kjo ngjarje konfirmon se kryeministrin nuk e pyet askush. Ai nuk ushtron kontroll mbi institucionet, të cilat duhet t'i raportojnë vetëm atij, askujt tjetër.

Presidenti Thaçi doli hapur në mbrojtje të Agjencisë për Inteligjencë. Por, ai duhet të deklarohet lidhur me falënderimin që ia bëri presidenti turk, që lë të kuptohet se ai e ka dhënë urdhrin. Ai duhet të bëjë transparente telefonatën me presidentin turk pas deportimit.

Është e qartë se presidenti i ka tejkaluar autorizimet e tij kushtetuese, dhe rrjedhimisht ka shkelur Kushtetutën e pasojat e kësaj shkeljeje dihen.

Të nderuar deputetë,

Shteti i Kosovës, me orientim të qartë euro-atlantik, duhet të ruajë rendin kushtetues dhe të sigurisë, shtyllat e demokracisë dhe orientimit gjeostrategjik.

Të gjitha këto janë cenuar të enjten e javës që shkoi, përmes interferimit të Ambasadës Turke, apo edhe të vetë presidentit Erdogan në jetën politike e institucionale të Kosovës.

Në anën tjetër, ne respektojmë sovranitetin e çdo vendi të pavarur, e aq më tepër vendeve mike, siç është Turqia. Çdo herë kur institucionet tona të sigurisë marrin informacione kredibile se individë apo organizata implikohet në aktivitete që rrezikojnë rendin kushtetues të një vendi tjetër, organet kompetente me transparencë të plotë dhe sipas ligjeve dhe konventave ndërkombëtare duhet të marrin vendimet adekuate.

Ne pranojmë dhe njohim të drejtën e vendeve sovrane që të interesohen për aktivitetin e individëve apo organizatave që supozohet se kanë qëllime apo marrin veprime antikushtetuese ndaj vendeve të tyre. Por, trajtimi i këtyre çështjeve duhet bërë sipas konventave ndërkombëtare.

Ne, si shtet dhe si popull jemi falënderues dhe mirënjohës ndaj popullit turk për mbështetjen në momentet tona më të vështira, në çlirimin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Më 29 mars krerët e institucioneve të vendit, me veprim apo mosveprim, kanë shkelur rëndë ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës.

Më 29 mars kishte tejkalim të autorizimeve ligjore dhe kushtetuese dhe dështim në zinxhirit komandues.

Prandaj, duhet të ketë përgjegjësi nga i gjithë zinxhiri komandues, që ka ekzekutuar apo lejuar (me heshtje apo pjesëmarrje aktive) këtë shkelje të ligjeve dhe konventave ndërkombëtare.

Pas këtij debati, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon që të votohet rezoluta si në vijim:

1. Drejtori i Policisë, Kryeprokurori i Shtetit, drejtori i Agjencisë për Inteligjencë, ministri i Brendshëm, ministri i Jashtëm, ministri i Drejtësisë, Autoriteti i Aviacionit bashkë me ministrin e Infrastrukturës, brenda tri dite të raportojnë me shkrim në Komisionin përkatës parlamentar për përgjegjësinë që kanë pasur dhe procedurat që kanë ndjekur në këtë rast.

2. Formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për të zbardhur këtë skandal, që ka cenuar rëndë të drejtat elementare njerëzore.

3. Përgjegjësit e këtij skandali të japin llogari bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga institucionet e rendit dhe ligjit në Kosovë që përgjegjësve të këtij skandali institucional t'u respektohet e drejta për gjykim të drejtë, transparent, sipas ligjeve dhe konventave ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe të drejtën e ankesës, të cilën gjë këta ua mohuan gjashtë shtetasve turq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne mirëpresim debatin e sotëm, meqë do të flasim për zhvillimet e javës së kaluar, të cilat me të drejtë kanë shqetësuar jo vetëm skenën politike, por edhe opinionin publik, më së shumti për shkak paqartësive të shumta që janë shfaqur në lidhje me aksionin e deportimit të gjashtë shtetasve turq që tashmë publikisht thuhet se i përkasin lëvizjes gyleniste.

Është e domosdoshme që Kuvendi i Kosovës të diskutojë dhe të thotë fjalën e vet për këtë zhvillim jo të zakonshëm, meqë deri sot debati për këtë çështje është bërë në mënyrë sporadike dhe kryesisht nëpër studio televizive dhe konferenca shtypi.

Ne kemi obligim të shfaqim qëndrimet tona dhe të marrim informacionet e nevojshme në lidhje me këtë ngjarje.

Por, edhe pse ka kaluar gati një javë, asnjë prej nesh nuk kemi asnjë raport e asnjë informacion zyrtar për arsyet, rrjedhën dhe efektet e këtij veprimi.

Rrjedhimisht edhe qëndrimet tona janë të varura nga kjo mungesë e informatave, por edhe nga deklaratimet e deritashme të liderëve dhe të bartësve institucionalë.

Gjithsesi unë besoj se të gjithë mund të pajtohemi se sot, më shumë se çfarëdo tjetër, ajo që na duhet është qartësia në lidhje me veprimet që kanë ndodhur. Dhe kur flas për qartësi, mendoj në atë që shkon përtej informatave dhe copëzave të informative që janë servuar deri tash në publik, sidoqoftë asnjëri nuk mund të jemi indiferent ndaj mënyrës se si është zhvilluar aksioni.

Secili prej nesh është ndier keq në kuptimin njerëzor me deportimin e shpejtë që ka ndodhur dhe me situatën e familjarëve të personave të depërtuar.

Republika e Kosovës dhe Kushtetuta e saj në thelbin e vet ka përcaktuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe dinjitetit të njerëzve dhe në këtë drejtim cenimi i të njëjtave nuk mund të kalojë pa një përgjegjësi të adresuar saktësisht.

Po ashtu, shumë shqetësues mbetet fakti i mosfunksionimit të hierarkisë institucionale dhe informimit vertikal në lidhje me veprimin.

Unë besoj se organet e sigurisë kanë autonominë e nevojshme të veprimit të tyre, por për çështjet që kanë peshë dhe potencial për reperkusione politike, është e qartë se bartësit më të lartë institucionalë duhet të jenë të informuar dhe të konsultuar.

A ka pasur një moskomunikim adekuat apo një moskomunikim total në këtë drejtim, besoj se duhet të njoftohemi saktësisht ditët në vijim.

Dhe sa i përket çështjes së dezignimit të personave të deportuar si subjekte që e cenojnë sigurinë nacionale në Kosovë, mendoj që duhet të kemi qartësi të plotë. Nëse ka informacione konfidenciale që nuk mund të bëhen publike, atëherë së paku udhëheqësit institucionalë duhet të jenë të informuar hollësisht për këtë çështje, sepse nuk është e drejtë që kjo t'u lihet vetëm spekulimeve si dhe shumë elementeve të tjera në lidhje me veprimet e javës së kaluar.

Qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës, i shprehur edhe në ditët e kaluara, është se për ne shteti ligjor është mbi të gjitha dhe se nuk mbështesim veprime arbitrare që nuk janë në pajtim me ligjin. Të gjithë banorët e vendit tonë duhet të kenë të drejta dhe liri të garantuara, duke përfshirë edhe procese juridike që ua mundësojnë atyre mbrojtjen dhe përfaqësimin e drejtë.

Në këtë kuadër, kërkojmë nga Qeveria që ta njoftojë Kuvendin se a janë respektuar procedurat legale dhe të drejtat e shtetasve turq të deportuar në plotni.

Nëse kjo gjë nuk ka ndodhur, duam të dimë se cilat janë masat që do të merren nga institucionet përgjegjëse dhe përtej kësaj, ne kërkojmë përgjegjësi edhe për pasojat eventuale që mund t'i kemi në rrafshin ndërkombëtar.

Ne kemi pasur zhvillime pasuese edhe në marrëdhëniet tona bilaterale me Republikën e Turqisë, shtet i cili me të drejtë konsiderohet shtet mik i Republikës së Kosovës dhe si i tillë është vlerësuar në të gjitha qëndrimet publike të të gjitha subjekteve politike ditët e fundit.

Pa dyshim, ne duhet të ruajmë raportet tona me Turqinë si shtet sovran që vendos vetë për veten dhe që nuk bën asnjëherë kompromis me orientimin e vet properëndimor dhe evropian.



Ky orientim duhet të jetë edhe udhërrëfyes i shtetit tonë, në marrëdhëniet e veta ndërkombëtare me të gjitha shtetet pa përjashtim.

Sot në këtë seancë më e lehta është që të shfaqen qëndrime radikale kundër liderëve institucionalë, kundër presidentit, kundër kryetarit të Kuvendit, kundër kryeministrit e kështu me radhë, por çka mund të arrihet me këtë.

Ndoshta dikush mund ta shohë si moment për të sulmua Qeverinë dhe për të fituar ndonjë poen politik si parti politike, por e vërteta është se neve na duhet si shtet një qartësi për ngjarjen e javës së kaluar.

Na duhet edhe për parandaluar veprime të ngjashme në të ardhmen, të cilat unë uroj që kurrë më të mos ndodhin, së paku në formën si ka ndodhur ky rast.

Përndryshe, nëse vërtet qëllimi i ftuesve të seancës ka qenë që ne të informohemi dhe të diskutojmë në detaje për të pasur qartësi për këtë situatë, atëherë më e lehta ka qenë që të thirret një seancë e mbyllur konfidenciale, që të thirreshin të gjithë bartësit e institucioneve relevante për t'i njoftuar deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës me të gjitha informatat që posedojnë, në mënyrë që edhe ne me të vërtetë ta kemi të qartë arsyen edhe të aksionit, edhe reperkusionet, edhe përgjegjësitë, edhe urdhërdhënësit, dhe gjithçka mbetet ende e paqartë sot e kësaj dite. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

**GLAUK KONJUFCA:** Javën e kaluar më së shumti jam gëzuar që kryeministri ka televizor në shtëpi, për shkak që e ka kuptuar se çka po ndodh përmes televizorit në shtëpi. Të mos e kishte pasur televizorin, ende nuk do ta kishte ditur edhe sot e kësaj dite se çka i ka ndodhur në shtetin e vet dhe vazhdon ta quajë veten kryeministër.

Por shumë më kollaj do të kishte qenë po ta kishte vizituar Hashim Thaçin e ai do t'i kishte treguar fill e për pe se çka ka ndodhur javën e kaluar në Kosovë.

Arrestimi dhe deportimi i gjashtë shtetasve turq me leje qëndrimi në Kosovë ka shpërfaqur edhe në koncept, edhe në praktikë, të gjitha defektet e pushtetit tonë në Kosovë.

Dua t'i theksoj disa që janë thelbësore.

E para, dikush u bë shkaktar në Kosovë që shteti ynë të renditet në mesin e atyre pak shteteve në botë, të cilat i shkelin konventat më të njohura ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Pas këtyre praktikave, një shtet i tillë nuk mund të thotë që është në Evropë, pra nuk i takon Evropës. Këto janë konsekuencat më të rënda për Kosovën në aspektin ndërkombëtar.

Aspekti i dytë është aspekti i brendshëm kushtetues. Faktikisht u shkel Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sepse në aspektin e të drejtave të njeriut Kushtetuta jonë mbahet si një Kushtetutë goxha e avancuar dhe i ka drejtpërdrejt të përfshira edhe të aplikueshme në Kosovë, të themi Deklaratën universale për të drejtat e njeriut dhe Konventën evropiane të të drejtave të njeriut.

U shkel Kushtetuta po ashtu, sepse vdiq struktura kushtetuese institucionale në Republikën e Kosovës.

Edhe kryeministri, që është udhëheqës i Qeverisë, edhe kryetari i Parlamentit, që e drejton organin më të lartë legjislativ, apo e përfaqëson, më mirë të thuhet, edhe presidenti, të tre dolën dhe e dënuan aktin që ndodhi javën e kaluar.

Unë mendoj që prej këtyre treve njëri po gënjen, dhe unë mendoj që ai i cili nuk është duke e thënë të vërtetën është presidenti Hashim Thaçi.

Po mundohem t'i jap disa fakte.

Presidenti Thaçi dhe Erdogani, drejtuesi i Turqisë, kanë ndërtuar një raport joligjor me njëri-tjetrin që mbështetet mbi konceptin e favorit, e kryerjes së favoreve ndaj njëri-tjetrit.

Ju kujtohet se si Erdogani vinte në mbështetje të fushatës elektorale të Hashim Thaçit dhe ky ia shpërblente me privatizime të ndryshme, për shembull, me privatizimin e aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës si dhe me një privatizim tërësisht kriminal të distribucionit të energjisë elektrike, e kam llafin për distribucionin e KEDS-it.

Dhe tash, Hashim Thaçi po ia kthen këto favore në mënyrën më të keqe për shtetin e Kosovës, pra përmes shfrytëzimit të fuqisë së tij jashtë ligjit, e kam llafin, përtej Kushtetutës, përmes rrjetit kriminal të pushtetit që e ka ndërtuar, arreston e depërton njerëz dhe i dërgon drejtpërdrejt te Erdogani, ia lëshon në dorë gjashtë persona, të cilët ai i konsideron terroristë, dhe i kërkon për t'i ndëshkuar.

Çka tregon kjo? Kjo tregon që ne këtu në Kosovë kemi udhëheqës që janë të pajisur me kompetenca kushtetuese dhe me pushtet institucional, por që po i përdorin këto kompetenca dhe

këto mundësi që ua garantojnë institucionet dhe Kushtetuta për të kryer favore personale, madje duke i shkelur edhe konventat ndërkombëtare edhe rendin e brendshëm kushtetues të shtetit tonë.

Çfarë shembulli po jep Kosova në raportet bilaterale? Kosova po jep shembullin e vasalitetit, në vend që ta japë shembullin e partneritetit. Vasalitet është kur sovranitetin ia dorëzon, apo një pjesë të sovranitetit ia dorëzon një shteti tjetër. Këtë ndjenjë unë e pata personalisht javën e kaluar, kur shteti ynë faktikisht u kthye në një shtojcë të shtetit të Turqisë. Ne u kthyem në një asistues, në një lloj lehtësuesi të një shteti tjetër.

Pra, kjo nuk është mënyra qysh ndërtohen raportet e mira ndërshtetërore dhe nëse duam t'i quajmë miqësore ato. Nuk ka miqësi aty ku nuk ka respekt të ndërsjellë për sovranitetin shtetëror mes shteteve.

Tash fatkeqësia është që Kosova aktualisht me këtë veprim është bërë më autoritare se Turqia e Erdogani. Pse? Se unë e mora vetëm për kureshtje, edhe e lexova ligjin që e ka Turqia për deportim dhe për ekstradim. Besoni ose jo, Erdogani nuk guxon ta shkelë atë ligjin e vet, që e ka në Turqi, e neve na ka kërkuar ta shkelim këtë ligjin tonë që e kemi në Republikën e Kosovës edhe ia ka arritur kësaj, kjo duhet me na shqetësojë shumë.

Atë që ai nuk guxon ta bëjë atje, në shtetin e vet, guxon ta bëjë në Republikën e Kosovës dhe gjejnë njerëz brenda shtetit për t'ia arritur këto qëllime. Si reaktion ndaj mosinformimit të tij, si kryeministër i Kosovës, e pamë që Ramush Haradinaj shkarkoi dy persona të rëndësishëm në shtetin tonë, ministrin e Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, si dhe drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, zotin Driton Gashin. Por, kjo veç sa hapi probleme të reja në shtetin tonë, nuk e ka zgjidhur problemin. Diçka çka më ka penguar mua shumë ka të bëjë me faktin që për t'u shkarkuar Flamur Sefaj u desh të mblidhej Këshilli i AKR-së, merreni me mend!

Unë e shtroj një pyetje këtu: çka do të kishte ndodhur me këtë shkarkim, nëse Këshilli i AKR-së kishte thënë: “Jo, s'po duam ta shkarkojmë”. Ku është kryeministri? Ku është Kushtetuta? Ku janë ligjet? Ku janë rregullat e shkruara? Kjo është shumë shqetësuese, sepse tregon që te ne pushteti nuk është i brendashkruar me Kushtetutë, po është njëfarë lloj mozaiku i pashallëqeve që secila parti politike aty i ka pashallëqet e veta, ministrinë e veta dhe nuk varet prej kryeministrit kjo punë, varet prej partisë politike a pajtohet a jo! Shiheni ku e kemi Kosovën, në çfarë niveli!

Kjo tregon që gjithçka është arbitrare në shtetin e Kosovës dhe kurrë nuk funksionon me Kushtetutë dhe me rregulla. E lexova edhe një herë Kushtetutën, me qëllim, te Agjencia e Inteligjencës së Kosovës. Aty në nenin 129, pika 4, thotë: “Çdo informacion që e ka presidenti, e ka automatikisht edhe kryeministri”. Nëse s'e ka, kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e Kushtetutës. Edhe nëse Driton Gashi nuk e ka informuar Ramush Haradinaj, ashtu si e ka informuar Hashim

Thaçin, Driton Gashi e ka paska shkelur Kushtetutën, nenin 129 të Kushtetutës dhe ai menjëherë duhet të ecë prej shtëpisë, duhet të shkojë në shpi. Pavarësisht a është mik i presidentit, a e ka vendosur aty presidenti, apo jo. Dhe, nëse Ramush Haradinaj nuk mund ta shtyjë përpara këtë çështje, shkarkimin e Driton Gashit, atëherë unë nuk e di pse është drejtues i Qeverisë. Duhet ndërruar emrin kryeministrit, sidomos atë pjesën e parë të fjalës “krye”, duhet t’ia ndërrojmë!

Kjo që po ndodh në Kosovë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: A do ta përfundosh edhe një minutë? Përfundoje diskutimin!

GLAUK KONJUFCA: Veç desha të them që përveç këtyre dy shkarkimeve, unë mendoj që procesi do të përmbillet krejt nëse Kuvendi do të inicioje një shkarkim të presidentit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Nga Grupi i të Pavarurve, kush e ka kërkuar fjalën? Dardan Molliqaj!

DARDAN MOLLIQAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ajo që sot është e qartë tërësisht, për dallim prej deklarimeve të para të javës së kaluar sa i përket problemit të deportimit të shtetasve turq nga Republika e Kosovës, është që Hashim Thaçi publikisht në konferencë për media e ka pranuar që ka qenë në dijeni, madje ka qenë dakord me këtë deportim të këtyre shtetasve. Pra, pyetjen që e kemi bërë atë ditë na është përgjigjur publikisht presidenti i Republikës së Kosovës dhe për mua është qartësuar që personi i cili e ka ditur, por edhe që ka qenë dakord me këtë çështje, është zoti Thaçi dhe sigurisht që ne nuk kemi nevojë më të bëjmë pyetje se kush e ka ditur e kush s’e ka ditur dhe kush e ka marrë vendimin, për shkak se ai publikisht ka deklaruar që e ka marrë këtë vendim.

Dhe, ajo që unë kam parë dhe kam përcjellë me interes pastaj është aspekti ligjor, është duke u diskutuar edhe sot këtu, edhe në media që a ka qenë në aspektin ligjor korrekte ose jo? Me aq sa kam parë unë, kemi të bëjmë me depërtim, jo ekstradim. Dhe, po ashtu kemi të bëjmë me deportim të shtetasve të huaj. Janë dy momente, është momenti i parë kur ka shkelje të ndryshme dhe ku të huajt, të cilit i vjen nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës kërkesa për deportim, ai ka të drejtë ankese. Por, është edhe një moment i dytë që kurrkush s’po e thotë, e që po më duket që në të janë thirrur presidenti dhe Agjencia, s’po flas për motivet, po flas për procedurat tash, është se kur rrezikohet siguria kombëtare, nuk ka asnjë lloj procedure dhe asnjë të drejtë të ankesës, sipas Ligjit për të huajt.

Pra, unë nuk jam fort i bindur që kemi të bëjmë me shkeljen e të drejtave të njeriut, qysh po thuhet këtu, ose shkelje të ligjeve. Unë kam një problem më të madh se këtë, edhe ajo është që unë besoj që zoti Thaçi, si një njeri dinak në politikë, nuk ka bërë ndonjë shkelje, e ka përdorur ligjin e Kosovës, nuk e di a ka fakte për atë që e ka përdorur, pra pyetja vjen tash a e kanë rrezikuar këta gjashtë shtetas turq sigurinë kombëtare të Kosovës? Për këtë nuk kemi përgjigje, po ai në këtë nen është thirrur, por unë mendoj që motivet janë problematike. Një problem politik dhe historik mes dy rrymave në Turqi, në njërën anë Erdoganët dhe në anën tjetër Gylenistët, është shndërruar në një arenë beteje edhe në Kosovë. Dhe, kemi një njeri që nuk përton dhe s'ka përtuar kurrë në të kaluarën t'i shërbejë kujtdo prej cilit përfiton. Pra, Hashim Thaçi, sipas bindjes sonë, i ka shërbyer në këtë rast Erdoganit për deportimin e këtyre shtetasve, duke u thirrur në një nen që e cenonë sigurinë kombëtare të shtetit të Kosovës.

Po ashtu, ne nuk kemi informata as si Kuvend, e po besoj as si institucione të tjera, por në media po qarkullojnë informata që këta shtetas turq kanë pasur miliona qarkullime në llogaritë e tyre bankare. Pra, është folur për 60 milionë euro qarkullim bankar të njërit nga të akuzuarit, qindramijëra për të tjerët. Ku janë shkuar ato para? Për çka janë përdorur ato para? Unë jam krejt i bindur që Hashim Thaçi i ka bërë favor Erdoganit dhe problemin që e kam këtu është që po e fut Kosovën në një betejë të padrejtë, prej perspektivës tonë, dhe në interesa të dy grupeve në shtetin e Turqisë për interesa të tij personale. Se cilat do të jenë interesat e tij personale, do t'i marrim vesh më vonë, ose ndonjë favor që e ka marrë në të kaluarën, ose ndonjë favor që do ta marrë në të ardhmen. Dhe, ky është problemi pse Thaçi e përdor shtetin e Kosovës dhe e fut në betejat, të cilat nuk i takojnë.

Debati, po ashtu sipas meje është shtruar në mënyrë jo të drejtë dhe jo të duhur sot në Kosovë. Kur po them sot, prej ditës që ka ndodhur e deri më sot. Nëse reagon zëshëm, je gylenist, nëse nuk reagon, je me Erdoganin dhe ne shprehim qëndrimin e grupit tonë që ne nuk jemi as me Erdoganin, por s'jemi as me gylenistët. Po aq sa kemi kritika për mënyrën e qeverisjes dhe të drejtimit të shtetit nga Erdogani, kemi po ashtu shumë kritika për mënyrën e organizimit të organizatës së Fito Gylenit. Dhe, është e padrejtë që sot, edhe Kosova si shtet, edhe ne si deputetë, edhe secili qytetar i Republikës, të vendoset se a je me njërin ose a je me tjetrin, sepse kjo nuk është betejë e Kosovës, sepse ata nuk dallojnë sa i përket çështjes së Kosovës. As njëri, as tjetri nuk është më dashamir se tjetri për Kosovën. Pse ne duhet të bëhemi tifozë të njërit ose të tjetrit? Pse ne duhet t'i shërbejmë njërit ose tjetrit? Siç e dini, edhe presidenti Erdogan, edhe Gyleni kanë reaguar për këtë. Njëri duke e falënderuar presidentin e Republikës së Kosovës që e ka bërë deportimin atje, dhe tjetri duke na krahasuar me vendet e tjera, të cilat kanë bërë veprime të tilla.

Ne refuzojmë në mënyrë kategorike që t'i shërbejmë këtij problemi, i cili s'është problem i shqiptarëve, s'është problem i Kosovës dhe s'ka të bëjë asgjë me ne. Sigurisht që mënyra qysh është prezantuar në media, mënyra qysh është diskutuar ky, ka ngritur shumë dilema dhe ka

krijuar shumë paqartësi sa u përket zhvillimeve politike ku jemi. Por të mos harrojmë se ky Kuvend e ka zgjedhur Hashim Thaçin president. Dhe, nuk kam bash qejf në hipokrizi, se edhe kur e kemi zgjedhur Thaçin president, po them Kuvendi, jo unë, e kemi ditur kush është Hashim Thaçi.

Pra, është lehtë sot t'i bihet në qafë Qeverisë, por edhe një qeveri e kaluar e ka zgjedhur Hashim Thaçin president për të mbetur në Qeveri. Në anën tjetër, po kërkojmë zgjedhje, shumë mirë. Kjo Qeveri s'është dashur të zgjidhet hiq, s'është dashur të konsolidohet hiq, duhet të shkojë, po kritika është që kjo Qeveri është varur nga Lista serbe dhe ne po duam tash ta rrëzojmë Qeverinë me votat e Listës serbe. Le të jemi të sinqertë, të themi, po, po duam ta rrëzojmë me Listën serbe, s'ka hiq problem kjo punë. Por, të mos bëhemi thua që s'ka histori në këtë problem. Hashim Thaçi nuk është president i Republikës së Kosovës me votat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Hashim Thaçi është president me votat e deputetëve të Republikës së Kosovës, të këtij Kuvendi. Dhe, është mirë që sot ka ndërruar qëndrim, shumë dakord, shumë mirë, më mirë është sot që jemi kundër presidentit Thaçi, se të vazhdojmë ta mbështesim. Por, duhet ta pranojmë që ia keni bërë një dëm këtij vendi duke e zgjedhur këtë njeri president.

Nuk është që na ka befasuar kurrë Hashim Thaçi, kushdo që befasohet prej Hashim Thaçit, problemi është ai që befasohet, nuk është më Hashimi. Dhe, në këtë kuptim, përgjegjësinë që duhet kërkuar është pashmangshëm te presidenti Thaçi. Unë nuk e di a është me Rregullore ajo që e propozoi shefi i Grupit të PDK-së, që të thirren përfaqësuesit e lartë të shtetit në një seancë të mbyllur, nuk e di a lejohet, por, realisht Hashim Thaçi duhet të vijë këtu, Agjencia Kosovare e Inteligjencës duhet të informojë a ka ekzistuar rreziku kombëtar që janë deportuar këta njerëz. Nëse është e argumentueshme, është muhabet ose diskutim tjetër. Nëse s'është, atëherë është keqpërdorim i pushtetit që e ka bërë zoti Thaçi dhe të tjerët. Nuk kisha dashur kurrë që të jem në lëkurën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, të jem kryeministër edhe të dal e të them "nuk e di". Në fakt, kjo kallëzon që veç kryeministër s'je, nuk kisha dashur kurrë të jem në lëkurën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, i cili po ashtu u desh t'i kallëzojë krejt popullit që nuk e di këtë punë, por të vërteta. E vërtetë, të cilën e kemi ndërtuar ndër vite dhe e vërtetë e cila duhet të luftohet e të ndryshohet.

Veprimet e Qeverisë së Kosovës kanë qenë edhe të pakta, edhe të mangëta. Më duket që Qeveria e Kosovës nuk e ka guximin të ballafaqohet qysh duhet me këtë problem, sepse duhet të ballafaqohet me Hashim Thaçin. E, pres që ndoshta bashkohet më vonë kryeministri i Republikës në këtë seancë ose dikush nga Qeveria, të tregojë pse nuk po e qartëson më shumë pozicionin e saj karshi këtij problemi, ose përndryshe është bashkëpunëtor në heshtje i këtij problemi që u shkaktua nga presidenti Thaçi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Rasti i kidnapimit dhe deportimit të gjashtë shtetasve të Republikës së Turqisë jo vetëm opinionin e Kosovës, por besoj edhe më gjerë e ka tronditur, sepse kemi të bëjmë me një veprim antiligjor dhe antikushtetues që dëmton veprimin institucional të Kosovës dhe imazhin e saj.

Përgjegjësia e zinxhirit komandues dhe llogaridhënia në nivelet institucionale po vërehet që ka munguar, sepse vartësit nuk informojnë shefat e tyre, të cilëve u obligohen në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës në fuqi. Me këto veprime, normalisht që kanë dëmtuar interesat e Kosovës, marrëdhëniet e Kosovës me Turqinë dhe po ashtu, edhe me vendet e tjera, të cilat vërtet mendojnë se kanë kontribuar dhe kanë investuar në Kosovë që të ketë rend dhe ligj, të ketë rregull, të ketë institucione funksionale dhe Kosova të veprojë si shtet i pavarur.

Ne në Kuvend ende s'kemi një informatë të plotë, të saktë, me elementet, të cilat do të mundnin deputetët të kenë një pasqyrë të plotë të veprimeve të javës së kaluar. Dihen veprimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Kosovës në rastin e parë, për shkak të përgjegjësisë ka shkarkuar dy nga krerët e institucioneve, të cilat kanë qenë të ndërlidhur me rastin, siç është shkarkimi i ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të AKI-së. Por, nuk është e mjaftueshme kjo për të pasur një pasqyrë të vërtetë të asaj çka ka ndodhur dhe njëkohësisht të dihet se kemi të bëjmë me institucione, të cilat në hallkat e caktuara nuk kanë funksionuar ashtu si duhet dhe në të ardhmen duhet të ndryshohet kjo mënyrë e veprimit.

Njëkohësisht dua të them se është ky rast që duhet t'i bëjmë me dije, të gjithë ata që marrin përgjegjësi institucionale e publike, që të veprojnë sipas ligjit dhe Kushtetutës në fuqi, sepse çdo veprim tjetër e dëmton interesin e Kosovës. Njëkohësisht dua të them se marrëdhëniet mes Kosovës dhe Turqisë, ashtu siç kanë qenë të mira në të kaluarën, do të vazhdojnë të jenë edhe në të ardhmen, sepse është interes i dy popujve, i dy shteteve që të bashkëpunojnë, të ndihmohen mes vete dhe normalisht të kenë raporte të mira të zhvillimit të këtyre marrëdhënieve. Njëkohësisht po e them edhe atë që është thelbësore për Kosovën, që nuk ka shmangie nga orientimi euro-atlantik i këtij vendi, sepse kemi të bëjmë me investime të mëdha që janë bërë qoftë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë nga Bashkimi Evropian dhe të gjitha shtetet mike që kanë investuar në Kosovë.

Dhe, përfundimisht mendoj se Kuvendi duhet të kërkojë nga Qeveria një informatë të plotë, në mënyrë që vërtet të kemi për çka të debatojmë, sepse sot mund të debatojmë me një informatë të përgjysmuar, me debate, të cilat janë zhvilluar deri më tani, me paragjykime, por po ashtu edhe me opinione të ndryshme. Prandaj, informata zyrtare dhe e plotë e Qeverisë do të mundësonte që të kemi një debat të vërtetë, të sinqertë dhe, po ashtu, të bëhen rekomandime, të cilat e

ndihmojnë Kuvendin që të veprojë sipas rezolutës, e cila mund të dalë nga ky Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë,

Media,

Preokupimi kryesor publik i javës që shkoi ishte fati i gjashtë qytetarëve me origjinë nga Turqia, të cilët kishin leje qëndrimi të rregullt në Kosovë, të lëshuara nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës.

Shumica e personaliteteve publike që morën qëndrim ndaj kësaj çështjeje përdorën fjalën “deportim” ose “ekstradim”, për të emëruar vendimin e fshehtë të disa njerëzve me funksione shtetërore të Kosovës, që gjashtë shtetas turq me leje qëndrimi të ligjshëm në Kosovë t’i dorëzohen hetuesisë së Turqisë. Deportimi si aksion i ndërmarrë nga një pushtet politik, është një veprim i hapur për të zhvendosur me dhunë një popullsi të caktuar civile apo një individ të padëshiruar nga një vend në një vend tjetër, apo për të dëbuar tërësisht nga shteti.

Deportimi i hebrenjve në kampet e përqendrimit me pasoja miliona njerëz të vrarë, ishte njolla më e rëndë që njerëzimi përjetoi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pas ndëshkimeve që iu dhanë strukturave naziste për gjenocidin e krijuar ndaj hebrenjve, rrallëkush ka menduar se vetëm pesë dekada më vonë, në zemër të Evropës, Serbia do të kryejë deportimin e një populli të tërë nga Kosova në bazë të politikës së saj gjenocidale ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Falë ndërhyrjes së shteteve demokratike perëndimore, u pamundësua realizimi i plotë i planit gjenocidal të Serbisë. Pa u zgjatur shumë në rastet e shumta të depërtimeve të ndryshme, po theksoj se në rastin e vendimit për gjashtë shtetasit turq nuk kemi të bëjmë me një deportim klasik, sepse nuk kemi të bëjmë me një veprim të hapur në funksion të shkatërrimit të civilëve në fjalë, vetëm për shkak të përkatësisë së tyre etnike, apo fetare. Përkundrazi, fjala është për një aksion të fshehtë, përmes të cilit hetuesisë së Turqisë iu dorëzuan gjashtë shtetasit me leje qëndrimi në Kosovë. Ekzistimi i një kërkesë zyrtare nga ana e pushtetit të Turqisë, për këta persona, nuk e arsyeton përdorimin e termit juridik “ekstradim”. Ekstradimi është fundi i një procedure juridike, përmes të cilit një shtet i caktuar ia dorëzon personin e kërkuar një shteti tjetër, me të cilin paraprakisht kanë marrëveshje për ekstradim, mirëpo në raste të tilla, marrëveshja bilaterale për një shtet që ka përqafuar vlerat demokratike nuk mund të jetë në kundërshtim me konventat ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.



Para se të ekstradohet një person i kërkuar, institucionet e drejtësisë së shtetit që kanë pranuar kërkesën e ekstradimit duhet të shqyrtojnë në një proces gjyqësor kërkesën e ekstradimit, argumentet përcjellëse të dosjes, me të cilën ngarkohet personi i kërkuar, e kështu me radhë. Personi i kërkuar që të ekstradohet në një shtet të caktuar ka të drejtë të sjellë avokatin e vet dhe, në rast të mungesës së mjeteve për një gjë të tillë, atëherë shteti që shqyrton kërkesën e ekstradimit e ka për obligim t'ia sigurojë mbrojtjen juridike. Në fund të procedurës për ekstradim, institucionet e drejtësisë së vendit që shqyrton kërkesën për ekstradim të një personi duhet të jenë të sigurta që motivet e ekstradimit të mos jenë politike dhe shteti drejt të cilit ekstradohet personi i kërkuar të mos jetë shtet që vepron në kundërshtim me Konventën ndërkombëtare kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera, ose trajtimeve mizore, çnjerëzore dhe degraduese.

Me një fjalë, edhe sikur të gjitha procedurat juridike të ishin kryer si duhet, fakti që Turqia, shtet i cili ka miratuar Konventën ndërkombëtare në vitin 1988, duke vendosur rezervat e veta, për ata që nuk e dinë, një shtet i cili këtë konventë e nënshkruan me rezervat e veta, ai e suspendon sa herë të dojë, sa herë të vlerësojë se interesi nacional i atij shteti kërkon që të suspendohet Konventa për të drejtat e njeriut, apo të mos zbatohet në rastet, siç quhet, të “sigurisë nacionale”. Duke pasur parasysh këtë, Kosova do të duhej të na bënte të mendonim shumë mirë para se të ekstradonim dikë në këtë shtet, duhej të ishim të sigurt që hetuesia e tyre nuk përdor akte të dhunës fizike dhe psikike, me qëllim që ta detyrojnë personin të pranojë veprën për të cilën ngarkohet, neni 1 i Konventës Kundër Torturës.

Të nderuar kolegë,

Në rastin e gjashtë shtetasve turq nuk kemi të bëjmë me deportim, as ekstradim, këtu kemi të bëjmë me rrëmbim, janë rrëmbyer gjashtë njerëz dhe janë dorëzuar në hetuesinë e një shteti, për të cilën organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut sjellin fakte alarmuese të shkeljeve të rënda. Po jua rikujtoj se në ditën e parë kur ishin rrëmbyer gjashtë personat në fjalë, mediat publikuan deklaratat e familjarëve të këtyre personave. Ajo që më preku në ato deklarata të tyre ishte se familjarët mbanin shpresë që ata do të jenë në burgjet e Kosovës. Është tejet e rëndë kur familjarët shpresojnë se të dashurit e tyre janë në burg, jo në liri, por në burg të një shteti të huaj dhe jo në burgjet e vendit nga vijnë. Por, fakti se siç raportojnë organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pas përpjekjeve për grusht shtet në Turqi, gjatë procesit të hetuesisë janë mbytur qindra njerëz, na bën të kuptojmë pse familjarët e gjashtë shtetasve turq do të preferonin burgjet e Kosovës, e jo të vendit të tyre.

Është e tmerrshme që 110 profesorë, arsimtarë, mjekë, inxhinierë dhe intelektualë të profileve të ndryshme kanë vdekur gjatë procesit të hetuesisë në Turqi. Zyrtarisht thuhet se kanë bërë vetëvrasje, ose kanë vdekur natyrshëm, askush më mirë se populli shqiptar, sidomos ai i Kosovës, nuk mund ta dijë se për çfarë vetëvrasjesh apo vdekjesh të natyrshme bëhet fjalë.

Të nderuar kolegë,

Njerëzit e institucioneve të Kosovës, në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, i kanë rrëmbyer gjashtë shtetas turq me banim të ligjshëm në Kosovë dhe pa asnjë procedurë gjyqësore ia kanë dorëzuar hetuesisë së një shteti, që kanë bërë shkelje të rënda të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Me këtë veprim, këta persona të papërgjegjshëm e kanë bërë shtetin e Kosovës përgjegjës për mosrespektimin e konventave ndërkombëtare, parimet themelore të të cilave janë të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Tani si asnjëherë më parë u dëshmuua se dikush është vënë mbi shtetin dhe e aplikon mënyrën autokratike të pushtetit, me të vetmin dallim se këtë formë pushteti është duke e aplikuar fshehurazi, me shitjen e lirisë së njerëzve dhe nuk ka guxim t'i shpallë publikisht ambiciet e veta absolutiste. Për t'i dhënë përmasa cinike këtij pazarllëku me lirinë e njerëzve, dëgjohet se në të ardhmen nuk do të përsëriten veprime të tilla. Pa marrë parasysh a do të ndodhin apo nuk do të ndodhin ngjarje të tilla në të ardhmen, rrëmbimi i gjashtë shtetasve turq me banim të ligjshëm në Kosovë dhe dorëzimi i tyre ku rrezikohet integriteti fizik dhe psikik është krim, për të cilin duhet të japin llogari të gjithë ata që kanë qenë të implikuar në këtë ndërmarrje.

Jemi në një moment shumë të rëndësishëm, ku përgjegjësia është vendimtare. Rrëmbimi i gjashtë njerëzve është veprimi më i rëndë që është kryer që nga themelimi i shtetit të pavarur të Kosovës dhe shumë i dëmshëm për ardhmërinë euroatlantike të vendit. Si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe si deputetë të Kuvendit të Kosovës, e kemi për obligim që të hedhim dritë mbi këtë akt të shëmtuar dhe të kërkojmë që të dalin para përgjegjësisë të gjithë ata që urdhëruan dhe e ekzekutuan një vendim të tillë antikushtetues. Vetëm duke i nxjerrë para përgjegjësisë njerëzit që e kryen këtë krim, ne do ta zvogëlojmë dëmin e madh, që ky veprim i ka sjellë Kosovës.

Deputetët e Kosovës duhet të veprojnë urgjentisht për ta informuar Bashkimin Evropian dhe institucionet demokratike në botë se rrëmbimi dhe dorëzimi i tyre me banim të rregullt në Kosovë pa asnjë procedurë gjyqësore është bërë privatisht nga individë të caktuar, të cilët do të japin llogari. Vetëm në këtë mënyrë mund ta zvogëlojmë identifikimin e Kosovës si shtet me këtë akt të pafalshëm.

Për fund, po u drejtohem atyre në Kuvend dhe jashtë Kuvendit të Kosovës që i arsyetojnë veprimet antikushtetuese për hir të miqësisë me Turqinë. Miqësia me këtë shtet nuk dëshmohet duke u bërë bashkëpjesëmarrës në luftën e tyre të brendshme për pushtet. Përkundrazi, kjo mënyrë veprimi na bën pjesë të qerimit të hesapeve të brendshme të këtij vendi dhe na vë në bankën e gjykimit historik për këtë periudhë që po e kalon populli i Turqisë. Ju garantoj se njerëzit që e kryen këtë akt, që rrënon prestigjin e brishtë të shtetit tonë në sytë e botës demokratike, nuk e çajnë kokën për krijimin e raporteve miqësore me Turqinë. Ata e shohin vetëm interesin e vet dhe asgjë më shumë.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, pa marrë parasysh se të cilës përkatësi etnike janë, e kanë për obligim që të mos lejojnë që aktet kriminale për përfitime individuale t'i vihen shtetit të Kosovës në barrë dhe t'i dëmtojnë qytetarët e saj. Ata që bënë pazarllëqe me lirinë e njerëzve duhet të ballafaqohen me drejtësinë e shtetit të Kosovës. Vetëm kështu mund t'i dëshmojmë angazhimet tona për funksionimin e shtetit në përputhje me vlerat demokratike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Igor Simiq, në emër të Listës serbe.

IGOR SIMIĆ: Hvala, predsedavajući!

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

Današnja tema ne bi bila u ovoj Skupštini da nismo imali događaje prošlog ponedeljka u severnoj Mitrovici, kada je prema običnim građanima koji žive na Kosovu, legalnim i legitimnim predstavnicima Srpskog naroda, vašim kolegama, izvršeno brutalno nasilje. Jer ono što moramo svi da znamo ljudska prava su pogažena i u ponedeljak, i u sredu, i tu nema razlike. Vladavina prava podrazumeva da svi građani imaju jednak pristup pravu i pravdi, bez obzira na njihovu nacionalnu pripadnost.

Poštovane kolege,

Zid ćutanja koji se stvorio o događaju u severnoj Mitrovici od ponedeljka neće sakriti da je nad, ponoviću, običnim narodom, koji nije pružio nikakav otpor, koji se povinovao zahtevima onih policajaca nad legalnim i legitimnim predstavnicima, vršeno je institucionalno nasilje. Nas nije tukla grupa huligana na stadionu, nas su tukli policajci. Nažalost, oni policajci koji su platu primili iz Kosovskog budžeta zato što su za taj budžet glasali i poslanici Srpske liste. Zahvalili su nam se na najbolji način.

Ono što moram da kažem jeste da ovakve stvari kada se krši ljudsko pravo bilo koga od nas povlači seriju drugih događaja. Ako se ne stane na kraj prvom takvom događaju, normalno da usledi i ovaj drugi. Zahvalio bih se onim kolegama koji kada imamo pauzu i kada sretnem moje kolege iz Poslaničke grupe Lista srpska izražavaju svoje nezadovoljstvo i protivljenje onom što smo doživeli u severnoj Mitrovici. Ja ih pozivam da to isto urade i za govornicom. Da su to uradili kada je trebalo, možda danas ne bih raspravljali o ovoj temi.

Ono što moram ta kažem jeste da svako od nas političkih predstavnika naših građana nosi odgovornost kada je u ovoj Skupštini. Samim tim, mi smo svoju odgovornost i pokazali toga dana, kada nismo pružili nikakav povod za sve ono što nam se desilo. Zašto? Ne zato što smo bili uplašeni, već zato što smo razmišljali o budućnosti svih nas, i želeli da sačuvamo mir. Tako da ta prisebnost koju smo pokazali treba da krasi svakog od političkih predstavnika, bilo koje nacionalnosti da je i bilo koju političku grupu da predstavlja.

Ja se iskreno nadam i u ime Poslaničke grupe Lista srpska nadamo se da se ovakvi događaji više nikada nikome neće ponoviti, ali sa druge strane i dalje očekujemo da se odgovorni za protivpravno brutalno nasilje nad običnim narodom u Mitrovici 26. marta kazne. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Damka, në emër të Grupit “6+”.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht, në cilësinë e përfaqësuesit të zgjedhur të komunitetit turk ju shpreh shqetësimin dhe brengat tona lidhur me zhvillimet e fundit në raport me shtetin mik të Turqisë pas depërtimit të gjashtë personave të nivelit udhëheqës të organizatës terroriste, FETO.

Për opinionin e gjerë në Kosovë është e qartë se përfaqësuesit e komunitetit turk vazhdimisht kanë qenë konstruktivë, si në proceset e shtetndërtimit, ashtu edhe në raportet me krijimin e harmonisë politike në vend. Është shumë me rëndësi për procesin e shtetndërtimit dhe konsolidimit të Republikës së Kosovës vazhdimi i marrëdhënieve shumë të mira me shtetin mik, me Republikën e Turqisë. Por, fatkeqësisht, marrëdhëniet tona mund të kenë pasoja shumë negative për shkak të përpjekjes së vazhdueshme të një pjese të opinionbërësve të Kosovës për t’i shfajësuar elementet e ndërlidhura me organizatën terroriste, FETO.

Para se të kaloj në përpjekjet e vazhdueshme për njollosjen e figurës së presidentit të Republikës së Turqisë, por po ashtu përpjekjet mosmirënjohëse për të krijuar perceptime të gabuara për Republikën e Turqisë, dëshiroj të paraqes disa informacione rreth rrjetit kriminel, i cili në opinionin e Kosovës identifikohet me termin “gülenistët”.

Shumica e medieve në Kosovë organizatën në fjalë e cilësojnë si “lëvizja e hyzmetit”, ose “lëvizja e shërbimit”, dhe përpiqen t’ia japin një karakter të pafajshëm organizatës terroriste në fjalë. Organizata FETO është formuar para 50 vjetësh nga imami Fetollah Gylen, por në vitet e ‘90-ta është shfaqur si një aktor me përpjekje për të ndikuar në proceset në Republikën e Turqisë. Strukturat në fjalë paraqiten gjoja me një koncept bashkëkohor, por në thellësi gjithnjë e ka pasur qëllimin final, atë të profetizimit të një personi dhe shkatërrimin e sistemit laik të shtetit.

Udhëheqësi i organizatës në fjalë edhe në ligjëratat fetare të tij vazhdimisht i ka udhëzuar pasuesit se si duhet depërtuar në çdo celulë të një shteti me një qëllim final, atë të marrjes në kontroll dhe reformimin e një sistemi me karakter fetar - një person që nëpërmjet elementeve të ndryshme të sigurisë, të drejtësisë, të arsimit, si dhe në fushat tjera ka bërë përpjekje për marrjen në kontroll të të gjitha institucioneve të Republikës së Turqisë.

Të nderuar deputetë,

Në Turqi është identifikuar që organizata në fjalë me vite ka vjedhur testet e provimeve shtetërore dhe nëpërmjet rrjetit të vet ka siguruar sistemin e pasuesve të vet në aparatit shtetëror. Nëpërmjet sistemit të njerëzve të vet ka bërë përpjekje për ta marrë nën kontroll aparatit shtetëror. Lidhur me këtë janë me qindra rrëfime të të burgosurve nga radhët e organizatës kriminele në fjalë.

Para dhjetë vjetësh, 732 akademikë, oficerë, gazetarë, politikanë janë dënuar në proceset e montuara nga prokurorët dhe gjyqtarët e organizatës FETO. Organizata famëkeqe më 15 korrik 2016 ka bërë tentim puçi, duke përdorur armët, aeroplanët, helikopterët e Forcave të Armatosura Turke. Në këtë tragjedi e kanë humbur jetën 248 qytetarë të pafajshëm turq, ndërsa 2 196 persona janë plagosur. Të pandehurit e këtij procesi kanë rrëfyer përfshirjen e FETO-s në tentim-puç dhe marrjes së urdhrat nga kryeterroristi Fetollah Gylen. Gjatë hulumtimeve të pas tentim-puçit u kuptua se organizata kishte për qëllim rrëzimin e Qeverisë dhe themelimin e një republike fundamentale islamike dhe kthimin e Gylenit në Turqi si kryeimam dhe udhëheqës shpirtëror e ligjor i Turqisë.

Mund të jemi kritikë ndaj politikave të pushtetit aktual në Turqi, por ju lutem, analizojeni qasjen e të gjitha subjekteve politike turke karshi FETO-s. Përkundër kritikave ndaj qasjes së pushtetit në luftën kundër organizatës FETO, të gjitha subjektet politike në Turqi, ato parlamentare dhe joparlamentare, FETO-n e konsiderojnë njërën prej çështjeve kryesore të shtetit të Republikës së Turqisë. Duke e marrë parasysh këtë fakt, sugjeroj që të gjitha organet shtetërore të Republikës së Kosovës me vëmendje të veçantë të qasen dhe t'i analizojnë çështjet lidhur me organizatën në fjalë. Prandaj, animi kah FETO nuk nënkupton vetëm kundërshtim të pushtetit në Turqi, por kundërshtim të Turqisë si shtet në shoqëri.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të përmend edhe disa fakte rreth veprimeve të organizatës në fjalë në Kosovë. Një pjesë e personave të deportuar nga Kosova kanë vepruar në nmaskën e mësimdhënësit, por në anën tjetër janë marrë me veprime tjera ilegale. Hulumtoni mirë se për çka akuzohet mjeku i deportuar, hulumtoni se si ka ndikuar mjeku i deportuar në procese gjyqësore nëpërmjet hartimit të raporteve të rrejshme për të pandehurit e procesit Ergen-Ekon. Gjithashtu, ju lutem, kërkoni hulumtimin e gjerë të qarkullimit vjetor prej 60 milionë eurove të së ashtuquajturës shkollës e “hyzmetit”. Ku derdhen ato mjete?

Krahasojeni buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës me këtë buxhet. Sipas raportit të AKI-së, janë edhe disa fakte tjera, si financimi i medieve kosovare, rekrutimi i informatorëve në Ministrinë e Brendshme, në Policinë e Kosovës dhe në FSK, identifikimi i zyrtarëve të Policisë së Kosovës që merren me sigurimin e ambasadave në Kosovë, e tjera, e tjera... Këto pohime janë publikuar në mediet e Republikës së Kosovës.

Dua të theksoj se raporti i AKI-së, të cilën e cilësoj si shumë të paanshëm, por duke e bazuar edhe në deklaratën e Presidentit, nënkuptohet që organizata terroriste FETO, jo vetëm për Turqinë, por edhe për Kosovën paraqet një element kërcënues për sigurinë e vendit.

Të nderuar deputetë,

Nuk kemi kompetencë, as detyrë të vlerësimit për mënyrën e deportimit të gjashtë shtetasve të Republikës së Turqisë në Turqi, por për një gjë jam shumë i sigurt, që udhëheqësit e shtetit të ri të Kosovës me qasjen e tyre në ngjarjet e tilla me vetëdije apo pa vetëdije e dëshmojnë paaftësinë e tyre si në koordinim të brendshëm, ashtu edhe në menaxhimin e krizës me një shtet mik, siç është Republika e Turqisë. Ne deputetët e komunitetit turk të Kosovës, përkundër fyerjeve që i kemi hasur kohëve të fundit ndaj Republikës së Turqisë, do të vazhdojmë të jemi konstruktivë, si në proceset e brendshme në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Republikës së Turqisë, qoftë në pozitë, qoftë në opozitë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të Qeverisë. Po ia jap fjalën njëherë zotit Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë.

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Ngjarjet e javës së shkuar janë bërë temë diskutimi në rrafshë dhe dimensione të ndryshme, për të cilat po ashtu janë marrë veprime dhe vendime nga institucionet.

Mbi të gjitha, me të drejtë është shtruar nevoja që në rend të parë qytetarët e Kosovës, pra shoqëria jonë ta kuptojë saktë rolin dhe mandatin e gjithsecilit prej nesh që jemi titullarë të institucioneve dhe që ndërlidhet me veprimtarinë tonë institucionale me rast, siç është ky largimi nga Kosova i gjashtë shtetasve turq, pra në vendin e tyre të origjinës.

Si ministër i Drejtësisë dëshiroj t'ua sqaroj të gjithë qytetarëve dhe juve, deputetë të nderuar, mbi supozimin e ndërlidhjes së mandatit tim dhe kompetencave të mia si ministër me rastin në fjalë.

Para se të vazhdoj tutje, dëshiroj ta bëj të qartë po ashtu, se kjo paraqitje nuk lidhet me gjykimet personale që mund të dalin në horizont nga ata që i komentojnë këto zhvillime, por lidhet me përgjegjësitë e mia ligjore dhe kushtetuese, para të cilave kam qenë dhe jam gjithmonë i gatshëm të flas hapur. Fillimisht, dëshiroj të sqaroj se edhe në rrafshin personal, edhe në atë institucional, unë besoj dhe veproj në harmoni me ligjet në fuqi, në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për të cilat, ndërmjet tjerash, ka bërë ndarje strikte të pushteteve dhe përgjegjësi për bartësit e tyre.

Në këtë drejtim dua të konfirmoj se jo vetëm në këtë rast, por në asnjë rast tjetër, as në rrafshin personal, aq më pak në rrafshin institucional, nuk kam pasur dhe nuk kam pretendime që t'i ngatërroj kompetencat e mia institucionale me ato që i bartin organet e pavarura të sundimit të ligjit, apo organet që merren me çështjen e sigurisë së Republikës së Kosovës.

Në raport me temën që është shtruar për debat, më lejoni të sqaroj se nuk kam asnjë përgjegjësi të drejtpërdrejtë apo indirekte, ose çfarëdo përgjegjësie tjetër individuale, prandaj nuk dëshiroj të argumentoj tutje në këtë drejtim. Kushdo që pretendon ta dijë një fakt ndryshe prej asaj, jo hamendësime, jo shpifje, por për fakte, jam shumë i gatshëm të ballafaqohem në çfarëdo instance. E dyta, në krejt këtë debat, që është zhvilluar, unë nuk kam kompetencë për të vlerësuar se janë zbatuar ose jo procedurat e parapara me ligj, pasi vendimi dhe procedurat u janë referuar institucioneve tjera dhe ligjeve përkatëse të institucioneve. E treta, do të dal edhe aty ku po dëshiron, në komentimin e kësaj ngjarjeje ka pasur edhe devijime, me ose pa qëllim, të interpretimin të terminologjisë juridike, ku është përmendur “ekstradimi”.

Të nderuar deputetë,

Me këtë rast, më lejoni të ju njoftoj se ekstradimi është i paraparë me Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe autoriteti final për ekstradim është një person, është ministri i Drejtësisë, pra është kompetencë pas vendimit të gjykatës. Në këtë rast, nuk ka pasur vendim gjykate, as autorizim nga unë si ministër, prandaj këtu nuk kemi të bëjmë në asnjë rrethanë me ekstradim dhe me përgjegjësitë që e përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë, atë të kërkesave për ekstradim nga Republika e Turqisë dhe ndërlidhjes eventuale me këto gjashtë raste, që tashmë u janë dorëzuar autoriteteve turke.

Të nderuar deputetë,

Po, është e vërtetë që Republika e Turqisë nëpërmjet organeve të saj të Drejtësisë ka bërë kërkesë për ekstradim për disa shtetas turq, që kanë qëndruar në Republikën e Kosovës. Ministria e Drejtësisë ka pranuar nga Turqia kërkesa për ekstradim për shtatë persona. Më lejoni të sqaroj që Republika e Kosovës në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale bashkëpunon me shtetet tjera, ose mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara dhe të ratifikuara në Kuvend, ose mbi bazën e reciprocitetit.

Ne kemi marrëveshje të nënshkruar dhe të ratifikuar në Kuvend me shtetet, si: Zvicra, Gjermania, Italia, Shqipëria, Maqedonia, Belgjika, si dhe zbatojmë parimin e reciprocitetit, siç janë Mali i Zi, Danimarka, Kanadaja, Norvegjia, Turqia dhe disa tjera. Republika e Turqisë, të nderuar deputetë, ende nuk e ka ratifikuar në Kuvendin e saj marrëveshjen për ekstradim, që është nënshkruar në vitin 2011, nëse s'gaboj.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, një shtet kërkues e dorëzon në Ministrinë e Drejtësisë një kërkesë formale për ekstradim apo transferim të personave të dënuar me dokumente përcjellëse.

Në rast se dokumentet e bashkëngjitura nuk janë të kompletuara sipas kërkesave të ligjit, kërkesa nga Ministria e Drejtësisë kthehet prapa. Pra, është Prokuroria Themelore ajo që e shqyrton përmbajtjen e dokumenteve dhe vendos nëse ka bazë për ta shtruar çështjen në gjykatën kompetente, ku bëhet shqyrtimi i provave dhe merret vendimi për ekstradim, ose jo. Në fund, gjykata vendos për ekstradim, atëherë sillet vendimi për nënshkrim te ministri i Drejtësisë dhe është në dorën e ministrit nëse vendos për ekstradim, ose jo, pavarësisht vendimit të gjykatës nëse gjykata është në favor të ekstradimit.

Më lejoni të ju njoftoj se prej kur e kam marrë detyrën më 9 shtator 2017 janë zhvilluar procedura konform ligjit dhe kanë ndodhur gjithsej 47 ekstradime, prej të cilave 15 nga Kosova për vendet tjera, 31 nga vendet tjera në Kosovë dhe me leje të veçantë transiti nga Mali i Zi nëpërmjet Kosovës në Maqedoni është transferuar një person.

Të nderuar të pranishëm,

I përmenda 47 raste. Të ju them të drejtën, as edhe një herë të vetme nuk e kam informuar as Kryeministrin, as Presidentin, as kryetarin e Kuvendit, asnjë institucion tjetër, kur e kam nënshkruar ekstradimin e këtyre personave. Normalisht, kam pasur interferime të ndryshme kohë pas kohe nga njerëz dhe individë të ndryshëm që ndoshta është mirë të shikohet ky, ose ai, të mos ekstradohet në Kosovë, ose nga Kosova të mos ekstradohet nga jashtë vendit. Mirëpo, në përputhje me kompetencat e mia, them se të gjitha ekstradimet që i kam nënshkruar, këto 47 që janë, janë pra në përputhje dhe në linjë të njëjtë me vendimin e gjykatave, pavarësisht se kam pasur mundësinë ta kundërshtoj një gjë të tillë.

Më lejoni të shkoj edhe një hap më tutje dhe ta jap edhe një informatë në kuptimin e transparencës dhe gatishmërisë sime të plotë për ta ushtruar detyrën, përgjegjësinë dhe llogaridhënien. Statusi aktual i kërkesave për ekstradim të Turqisë, që besoj se është në interesin tuaj për të kuptuar dhe është si vijon:

Më 11 tetor 2017 është përcjellë nga Ministria e Drejtësisë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë kërkesa për ekstradim të një shtetasi turk, i cili është shqyrtuar nga gjykata dhe e ka hedhur poshtë këtë kërkesë.

Më 5 dhjetor 2017, Interpoli Turk ka kërkuar arrestimin e një personi në Kosovë, të cilën kërkesë Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar e ka kthyer prapa për mosplotësimin e kushteve sipas ligjit. Pas plotësimit të kushteve ligjore, më 3 janar 2018, Ministria e Drejtësisë së Turqisë e ka kërkuar masën e arrestit të përkohshëm për personin në fjalë, kërkesë të cilën, sipas ligjit, është dashur ta kalojmë për trajtim paraprak te Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Më 26 janar, Ministria e Drejtësisë së Turqisë ka bërë kërkesë për arrestim të përkohshëm të një shtetasi tjetër turk, kërkesë e cila është obligim ligjor, i është përcjellë Prokurorisë Themelore në



Prishtinë për shqyrtim nga unë. Ndërsa, më 5 janar, Ministria e Drejtësisë e Turqisë ka bërë kërkesë tjetër për një shtetas turk, i dënuar në Turqi për vepër penale, kërkesë të cilën po ashtu e kam dërguar për shqyrtim në Prokurorinë Themelore.

Më 13 shkurt, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar e ka dorëzuar në Prokurori një dosje tjetër për një rast, sipas kërkesës së Ministrisë së Turqisë, i cili është në procedurë shqyrtimi dhe më 16 shkurt një tjetër kërkesë është dorëzuar në Prokurori për shqyrtim, pra si kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Turqisë. Ndërsa, më 22 shkurt është përcjellë kërkesa e fundit për shqyrtim nga Ministria te Prokuroria Themelore.

Nga këto 47 raste që i përmenda, asnjë nuk është ekstraduar nga këta persona që ka kërkuar Prokuroria e shtetit Turk dhe Ministria e Drejtësisë.

Të nderuar deputetë,

Sa u përket deportimeve që kanë ndodhur, ne sot nuk e kemi të pranishëm ministrin e Brendshëm që të diskutojë, mirëpo për informatën tuaj, unë do të ju informoj, që në vitin 2017 nga Republika e Kosovës janë deportuar 344 persona. Për këta 344 persona, përveç organeve përgjegjëse, nuk është në dijeni as Presidenti, as Kryeministri, as ministri i Drejtësisë, as persona tjerë, sepse është përgjegjësi e Policisë, është përgjegjësi e Ministrisë së Punëve të Brendshme për qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës. Pra, 344 persona janë deportuar nga Republika e Kosovës pa vendim gjykate.

*(Reagime nga salla)*

Urdhëro!

Unë po flas për të dhënat që i kemi, ndërsa besoj se do të vijë edhe kryeministri e të na sqarojë për informatat që i ka nga Ministria e Punëve të Brendshme. Unë vetëm po jap informacione, ta bëjmë dallimin ndërmjet deportimit, ekstradimit dhe transferimit të personave. Po, pikërisht këtë thashë, nga këto janë 344 raste, që janë pa vendim të gjykatës dhe janë të deportuara jashtë territorit të Republikës së Kosovës, shtetas të ndryshëm. Ndërsa, çdo deportim, çdo transferim, çdo dëbim i personave ndodh në bashkëpunim ndërmjet dy shteteve.

Edhe sa u përket çështjeve të mjeteve, transportit siç ka ndodhur këtu që përmendet çështja e avionit, unë s'kam dalë ta mbroj askënd, mirëpo ne si institucione të Kosovës nuk kemi mundësi që kur t'i transferojmë personat nga vendet tjera në Kosovë të organizojmë transport privat, qoftë aeroplan, qoftë çfarëdo tjetër dhe i dërgojmë policët tanë me linja të rregullta ajrore, ku i përcjellin këta që vijnë në Republikën e Kosovës, qoftë për vuajtje dënimi, qoftë për gjykim. Kjo është çështje që e rregullon secili shtet, veç e veç, nëse e sjell me një aeroplan privat, apo e dërgon me linjë të rregullt.

E kemi rastin e Baki Sadikut, në vitin 2013 është ekstraduar në Republikën e Sllovakisë, ku pas këtij vendimi Sllovakia na pati premtuar që edhe do ta njohë Republikën e Kosovës kur të ekstradohet, mirëpo jo që nuk ndodhi, po ra edhe Qeveria në Sllovaki, se personi kishte qenë shumë i fuqishëm. Pra ky rast ka ndodhur pikërisht me një avion privat çarter, është ekstraduar nga Republika e Kosovës në Republikën e Sllovakisë për veprat ku është akuzuar për dënim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Jagxhillar e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Më lejoni të parashtroj disa pikëpamje nga këndvështrimi im, si ministër i Administratës Publike dhe si kryetar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës.

Mendoj se çdo debat është i rëndësishëm, dhe më i rëndësishëm është që çdo debat të zhvillohet duke u bazuar në fakte dhe argumente.

Në këtë aspekt, do të ishte mirë të dëgjohen edhe faktet relevante.

Në çdo shtet roli i inteligjencës është crucial, besimi i zyrtarëve dhe i qytetarëve duhet të jetë i palëkundur. Procedurat duhet të jenë të qarta, komunikimi midis institucioneve duhet të jenë të qarta, rezultatet duhet të jenë në dobi të interesave të shtetit.

Kështu që duhet të prezantohen dokumentet faktike sa u përket elementeve të operacionit.

Nga ana tjetër, në qoftë se janë pretendimet e portaleve të ndryshme dhe të evazionit fiskal prej 60 milionësh dhe aktivitete rrënuese të administratës shtetërore, atëherë AKI-ja ka vepruar në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën.

Në këtë aspekt, duhet të presim hetime dhe vërtetim i fakteve që pastaj të vlerësojmë kush ka gabuar ose ka vepruar drejt.

Sa i përket komunikimit ndërinstitucional në Kosovë, edhe kjo të hetohet, në qoftë se nuk është rregulluar në mënyrë ligjore, atëherë të bëhet.

Pastaj të vlerësohet elementi i lejes së qëndrimit, shtrohet pyetje sa njerëz janë larguar prej Kosovës pa leje qëndrimi dhe në këto raste, a është vepruar si në këtë rast dhe në përputhje me ligjin.

Dëshiroj t'ju informoj se Ministria e Administratës Publike tani e disa vjet sipas kërkesës së AKI-së dhe Policisë ka realizuar pezullimin e mbi 20 OJQ-ve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, për çështje për të cilat unë në detaje nuk i di, as zyrtarët e mi nuk e dinë, sepse zbatojmë Rregulloren në fuqi dhe vlerësimin e rrezikshmërisë të këtyre OJQ-ve për stabilitetin e shtetit të Kosovës, vlerësim i cili bëhet nga AKI-ja.

Kështu që mendoj të analizojmë të gjitha faktet dhe pastaj të japim vlerësime. Mendoj që shteti i Kosovës është partneri i shtetit të Turqisë dhe anasjelltas, duhet të mbajmë raporte të mira, të falënderojmë shtetin turk për përkrahjen pa rezervë për Kosovën.

Në këtë aspekt, sa më shpejt duhet të kemi fakte dhe të vërtetën për të vazhduar dhe besojmë në një gjykim të drejtë edhe në Turqi për këta qytetarë të Turqisë.

Si kryetar i partisë dhe ish-deputet, mendoj se duhet të bashkëpunojmë me shtete dhe të veprojmë sipas marrëdhënieve bilaterale dhe ndërkombëtare. Këto marrëdhënie nuk duhet të vihen në pikëpyetje për shkak të lëvizjeve qytetare apo fetare, si në këtë rast.

Ne si komunitet turk jemi për marrëdhënie të mira me Republikën e Turqisë.

Në këtë rast, e përkrahim Turqinë, presidentin Erdogan dhe falënderojmë Turqinë dhe presidentin për një përkrahje pa rezervë në këto 16 vjetët e fundit, pa dallim për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të gjitha qeverive të Kosovës, pra prej vitit 2002 kur ka ardhur në pushtet.

I ftoj të gjithë qytetarët e Kosovës dhe deputetët që të kuptojnë Turqinë si një mik të vërtetë të Kosovës.

Mendojmë se koha do të tregojë të vërtetën, kush ka vepruar drejt dhe në interesin e Kosovës.

Ndërsa si ministër dhe deputetë të KDP-së, edhe deputetë të KDTP-së jemi të përkushtuar për Kosovën evropiane, për komunitetin turk në Kosovë dhe marrëdhëniet mes Turqisë dhe Kosovës.

Në rastin e cenimit eventual të një prej këtyre parimeve, ne jemi të gatshëm të marrim edhe vendime politike për t'i mbrojtur këto parime përmes kundërshtimit demokratik dhe politik.

Ne mendojmë se krahasimi i presidentit të një shteti me një lider ose një lëvizje nuk është në rregull, kështu që ne jemi për bashkëpunimin institucional dhe me njerëz të zgjedhur të shtetit të Republikës së Turqisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ministri i Drejtësisë na e lehtësoi debatin me interpretimin e përgjegjësiave ligjore në mes të ekstradimit dhe depërtimit, me një fjalë, pasqyroj puçin institucional të këtij rasti, për të cilën sot po debatojmë.

Deportimit i gjashtë shtetasve turq më 29.3.2018, prej të cilëve pesë mësimdhënës dhe zyrtarë të një institucioni arsimor privat në Kosovë dhe një kardiologu, të cilët tash e sa vjet jetonin e punonin në Kosovë, kuptohet me leje qëndrim të rregullt dhe ngjarjet paraprake në veri të vendit janë tregues i qartë i gjendjes së krijuar të një destabilizimi të brendshëm nga pasojat e preferencës së voluntarizmit dhe elitizmit, duke fijuar ndasi të skajshme dhe më të keqen mosbesim tek institucionet e Republikës së Kosovës.

Teoritë konspirative hasin te politikanët me prirje diktatoriale, ku tipat e tillë thuhet se nuk mund të mbijetojnë pa to. Duke jetuar dhe vepruar në një sistem të cilën ata vetë e ushqejnë me këto teori, u futet frika se një ditë mund të bëhen viktimë e tij. Krijojnë paranoja të skajshme me armiq të përbetuar, pa dallime te koncepti shoqëror e social dhe me një etje të ulët për pushtet dhe lavdi.

Një treshe që sot janë bartës të udhëheqjes institucioneve dhe egoja e tyre për lavdi, qoftë edhe e rrejshme, është interesim primar i tyre. Ndërsa këto i paguajnë shtrenjtë qytetarët e vendit, kjo lavdi po sjell degradim të jetës institucionale, izolim dhe prishje të raporteve me vendet mike si dhe largim nga bota perëndimore.

Të nderuar qytetarë të vendit,

Këto ngjarje përkthehen si përmbysje e rendit kushtetues me metodat antiligjore, në kundërshtim me të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut për kapje të pushtetit. E kjo kapje po bëhet nga ata që janë duke marrë pjesë në institucionet shtetërore me forcë apo duke kërcënuar me forcë mbajtjen e pushtetit në çdo mënyrë.

Në vitin 1799, saktë para 219 vjetëve, në Francë ndodhi grusht shteti i ndërmarrë nga tre konsuj, Doskja, Siseja dhe Bonaparta. Këta tre konsuj arritën qëllimin së pari duke krijuar vakum të pushtetit ekzekutiv, pastaj pasoi rrëzimi i pushtetit legjislativ. Pa dashur të fyej historinë e lavdishme franceze, metoda e grusht shtetit në rrëzimin e Qeverisë së kaluar Mustafa janë shumë të ngjashme. Vetëm se në Kosovë kjo është ndërmarrë nga tre klonë të oborreve politike.

Njëri ka më shumë fantazi se logjikë, tjetri mendjemadhësi më shumë se trimëri dhe i fundit më shumë dëshirë se inteligjencë.

Një treshe e njohur për nga sjellja dhe mentaliteti i luftës kundër kundërshtarëve që mendojnë ndryshe, i sjellje primitive ndaj kujtdo që u pengon të jenë pushtetarë të këtij vendi, me paraqitje e dukje civilizuese, por në esencë krejt njëjtë, në stil të diktatorëve, vetëm me dallim të fuqisë dhe vogëlsisë së tyre.

Iniciativa skandaloze për zhbërjen e Gjykatës Speciale, për transformimin e njëanshëm të FSK-së në ushtri, të intervenimit të Policisë në arrestimin e Gjuriqit në veri, me mbështetje të kriminelëve Radojçiq e Veselinoviq dhe ekstradimin e gjenistëve në Turqi, s'është asgjë tjetër pos mesazh manipulues, ku konkludohet që krizat që krijohen, vetëm ne i zgjidhim! Në teorinë e grusht shtetit të njohur si formula Bajera, për mbrojtjen e shtetit e nevojshme është njohuria e aftësisë për pushtimin e saj.

Përpjekjet e Lidhjes Demokratike të Kosovës në mbrojtjen e lirisë dhe demokracisë, përkatësisht Republikës parlamentare, i bëjnë edhe më të vështira, sepse jemi në përballje me dy kundërshtarë. Kampin që pushtetin e mbanë pas grusht shtetit duke përdorur metoda klasike dhe grupacioni tjetër që nëpërmjet protestave të dhunshme atakon shtetin, me porosi të qartë si të Leninit, se nuk ka liri ku ka shtet.

Kosova nuk e ka luksin të veprjë ndaj këtyre ngjarjeve, rrethanave që degradojnë shtetin. Me tempin derisa nuk është tepër vonë, është gjithmonë herët.

Kolegë deputetë,

T'i kthehem edhe një herë rastit se si dhe pse ka ndodhur deportimi i gjashtë shtetasve turq.

Cili është informimi institucional edhe sot kur po debatojmë dhe cili është tentimi që kjo ikje nga kjo përgjegjësi të vazhdojë.

Më 27.3.2018 është mbajtur takimi i Këshillit Nacional për Siguri, në krye me kryeministrin dhe, paramendoni, dy ditë më pas ndodhin arrestimet, të cilat vetëm se kishin filluar procedurat e deportimit, dëbimit, kidnapimit, arrestimit apo, sido që të quhen, rrethana këto ende të panjohura dhe ajo çka është më skandaloze, pretendohet apo thuhet, se janë të panjohura edhe për vetë kryeministrin dhe aktorët e tjerë shtetërorë.

Pamjet që janë parë gjatë arrestimit tregojnë dyshimin e bazuar të përdorimit të tillë të forcës apo mënyrës së ndalimit, edhe pse edhe sot janë ngritur dyshime se a ishin të gjithë policë të Policisë së Kosovës apo edhe të tjerë të implikuar në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Deklaratat se deportimi është bërë si pasojë e anulimit të lejeqëndrimeve, duke u bazuar në një raport të AKI-së, me të cilën personat konsideroheshin si kërcënim për sigurinë kombëtare të

Republikës së Kosovës, janë dyshuese dhe nuk përkojnë me bazën ligjore dhe juridike të Republikës së Kosovës.

Ata thuhet se janë arrestuar nga Policia, por fare nuk janë dorëzuar në stacionin policor.

Të njëjtit ishin drejtuar në mënyrë direkte për në aeroportin e Prishtinës, ku u ishin dorëzuar autoriteteve të inteligjencës turke, të cilët fluturonin me avion privat që kishin marrë leje të veçantë për të fluturuar nga Ministria e Infrastrukturës, gjë e cila e bën pjesë përgjegjëse në këtë skemën e këtij skandali nën ombrellën e Hashim Thaçit, Ramush Haradinajt e deri te ata që ranë në kurthin e këtij urdhri skandaloz, për mua shumë korrptiv. Kur e them korrptiv, bazohem në atë çka ka ndodhur me privatizimet, ku në këto shkolla janë shkolluar fëmijët e pushtetarëve dhe ajo çka është e njohur, është se shteti turk ka vënë çmim kushdo që e dorëzon dhe përndjek të ashtuquajtur anëtarët e organizatës FETO.

Çka thotë baza ligjore për raste të tilla? Ligji për huajt, neni 6, refuzimi apo revokimi i leje qëndrimit për rrethana të sigurisë shtetërore.

E drejta e ankesës që bazohet po të njëjtën ligj, neni 101.

Në rastin konkret, fare nuk është mundësuar ushtrimi i të drejtës së tyre të ankesës. Një e drejtë e tillë është mohuar në tërësi, kjo bie ndesh edhe me Kushtetutën e Kosovës, në nenin 32 të saj, e cila ka paraparë se çdo person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat ose interesat të tij a të saj, në mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.

Në Ligjin për të huaj, neni 99, procedurat e zbatimit të urdhër dëbimit.

Kjo dispozitë sqaron mënyrën e dëbimit të personit nga Republika e Kosovës, përkatësisht faktin se vetë personi duhet t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit apo që eventualisht t'i jepen si hua nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në rastin konkret, personat janë dorëzuar tek inteligjenca turke brenda aeroportit të Prishtinës, prandaj edhe nuk bëhet fjalë për dëbimin apo deportimin e tyre si persona të rrezikshëm, por kemi të bëjmë ekskluzivisht me dorëzimin e tyre te një shtet tjetër.

Kodi i Procedurës Penale, neni 10,13 itt, ka paraparë parimet thelbësore me rastin e arrestimit të personit të caktuar. Asnjëra nga këto dispozita ligjore nuk është zbatuar nga Policia e Kosovës me rastin e arrestimit të tyre dhe të njëjtëve për asnjë moment nuk u është mundësuar kontakti me familjarë dhe avokatin e tyre.

Për këto shkelje personat përgjegjës nga Policia e Kosovës duhet të japin përgjegjësi.

Ligji për AKI-në, neni 25, shpërndarje e informacionit. AKI-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 të Ligjit për AKI-në, pasi që nuk ka njoftuar fare Prokurorinë e Shtetit për gjoja vepra penale të cilat shtetasi turq dyshohet se i kanë krye në Kosovë, përkundër se ka pasur obligim për të vepruar në këtë mënyrë. Ende mbeten të paqarta të gjitha këto që i potencova.

Si ka mundësi që brenda 20 ditësh të ndryshojë statusi i rrezikshmërisë kombëtare lidhur me personat e caktuar? Si ka mundësi që të njëjtëve pas 20 ditësh t'u ndryshohet statusi i rrezikshmërisë për sigurinë kombëtare në Republikën e Kosovës?

Pse nuk u njoftua Prokuroria e Shtetit nëse kishte dyshime se personat e deportuar po kryenin vepra penale, atë çka e vërtetoi edhe vetë ministri i Drejtësisë.

Pse u dorëzuan në duart e inteligjencës turke brenda aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës, e nuk u veprua në përputhje me nenin 99 të Ligjit për të huaj për procedura të dëbimit.

A nuk ishte dëbimi për shkak të cenimit të rrezikshmërisë kombëtare të Kosovës, apo e gjithë kjo ishte për të kamufluar qëllimin e vërtetë të dorëzimit të këtyre shtetasve në duart të Qeverisë turke.

Pse shtetasit nuk u depërtuan në Shqipëri, njëri kishte nënshtetësi të Shqipërisë, a dëshmon kjo qëllimin për të dorëzuar shtetasit turq aty ku ishte destinimi.

Përse u mohua e drejta e ankesës, kur kjo e drejtë është e garantuar edhe me Kushtetutë.

Pse u shkel Kodi i Procedurës Penale për ofrimin e ndihmës juridike nga ana e avokatit dhe njoftimi i familjarëve me rastin e arrestimit.

Këto dhe shumë çështje të tjera mbesin të qartësohen me përgjegjësi në ditët në vijim, apo ndryshe thënë, shumë prej tyre tani janë të qarta për persona përgjegjës, të cilët duhet të bartin pasojat e veprimeve të tyre të kundërligjshme.

Lidhja Demokratike e Kosovës mendon që në shoqëri demokratike destabilizimi politik hiqet vetëm me rënien e Qeverisë, duke organizuar zgjedhje të rregullta apo të parakohshme, me të cilat zgjidhet Qeveria e ra, në respektim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, me zhvillim ekonomik dhe rend e ligj, me integrim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! A ta ka përmendur emrin, jo! Zoti Adem Mikollovci e ka fjalën. A e përmendi “Vetëvendosjen”? Mirë, replikë zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Desha të them kështu.

E para, duhet ta marrin ata përgjegjësinë që e kanë zgjedhur Hashim Thaçin president. Nëse ankohen për Hashim Thaçin, më së pari duhet këqyrur në pasqyrë, ai që ia ka dhënë votën, unë e kisha lutur administratë të na e shtypë atë votimin e famshëm të 26 shkurtit 2016. Secili që ia ka dhënë votën Hashim Thaçit, edhe në nivel të partive politike, nuk ka të drejtë të ankohen më në Hashim Thaçin, as ta akuzojnë “Vetëvendosjen”, as të tjerët. Se kur ju i jepnit votat si LDK Hashim Thaçit, “Vetëvendosjen” e çonit në burg!

Ju PDK-në po e vlerësoni vetëm a është në pushtet LDK-ja me ta, a nuk është. PDK-ja qenka e keqe kur nuk është bashkë me ne në pushtet, a qenka e mirë kur jemi bashkë në pushtet. Kjo ishte faktikisht logjika e Armend Zemajt. Kjo shumë naive, bile për mos të mos thënë qesharake.

E dyta, sa për atë grusht shtetin, kjo është skandaloze. Nuk po e di qysh ata profesorët e vet ia kanë dhënë kaluese në Fakultetin Juridik. T’i thuhet grusht shtet rënies së Qeverisë në Parlament, me 61 vota, unë veç këtë po e dëgjoj. Ajo është krejt në rregull, krejt në përputhje me rregullat, 61 vota të deputetëve në Parlament, çka është e paligjshme këtu? E ky vajton për atë rrëzim të Qeverisë atëherë, para dy vjetëve! Domethënë, kjo është skandaloze, të vajtosh për një rrëzim të ligjshëm të qeverisë, për mua është shumë e dyshimtë në aspektin intelektual, është e mjerueshme!

KRYETARI: Zoti Zemaj, kundër-replikë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Thënë të drejtën, bash po më pëlqen në cilat pjesë e paska gjetur vetën Glauku nëse fol edhe në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe ajo çka e dokumenton dhe e faktin fjalimin tim për analogjinë e rrëzimit të atij pushteti me ngjarje të tanishme, janë edhe takimet e sotshme në Tiranën socialiste dhe kjo e dokumenton faktin dhe mbizotëron edhe arsyen e ngjarjeve të ardhshme që do të prodhojnë kjo kastë dhe kjo logjikë politike.

Kështu që unë Glaukut edhe “Vetëvendosjes” i dëshiroj që t’i përputhin në vazhdimësi, në konsistencë analogjitetë, po të mos e përkrahin të keqen.

Kështu që, edhe një herë është shumë e vërtetë ajo çka e thashë, analogjinë që e përdora...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Përrjashtim bëj, zoti Adem Mikullovcit e ka fjalën.



ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk po e shoh të arsyeshme të flas në këtë situatë, kur është puna e tillë. Seanca e sodit mua po më përngjan në një shfaqje kur mungojnë personazhet kryesore, pa personazhe kryesore, nuk ka shfaqje.

Unë kam pritur që sot në seancë, duke marrë parasysh turpin që i është bërë Kosovës, shtetit tonë, do të jenë të pranishëm edhe kryeministri, edhe kryetari i Kuvendit, edhe kryetari i shtetit, zoti Hashim Thaçi. Ata po mungojnë dhe tash këtu radhazi do të dalim e do të numërojmë se si është shkelur Kushtetuta, do të ankohe mi, do të vajtojmë e s' do të arrijmë asgjë.

Propozoj që të mos humbim kohë duke treguar se çfarë turpi i është bërë Kosovës, por duke mbështetur diskutimin e Glauk Konjufcës dhe propozimet e Avdullah Hotit, ta përpilojmë një kërkesë, një rezolutë dhe t'ia dorëzojmë Qeverisë me afat të caktuar, e mos të humbim kohë kot.

Diskutimin që e pata përgatitur, e kam pasur ndërmend t'ia them zotit Ramush Haradinajt, po ai po më mungon dhe e them ndoshta herën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Do ta lë për fund atë çka e kam për të thënë ndoshta në përputhje me diskutimin e fundit, por po filloj nga diçka që mua nuk më duket aspak në rregull, që në Parlamentin e Kosovës të përdoren terminologji të ndryshme, të cilat nuk janë as në përputhje me natyrën e këtij Parlamenti, por nuk jemi diçka në rregull.

Tash cilësimi 'terrorist' i qytetarëve të cilët kanë qenë deri dje këtu, nuk m'u duk normal, se tash asnjë argument nuk u tha se çfarë 'terroristësh' kanë qenë doktorët, çfarë 'terroristësh' kanë qenë mësuesit, por mbi të gjitha këto cilësime nuk kanë ndodhur nga asnjë shtet evropian deri më sot që ne t'i bëjmë kështu. Pra, ne po i paraprimë për diçka të keqe Evropës, sepse jemi vendi i vetëm në Evropë që kemi ekstradime të tilla, e tash po dalim edhe një hap tjetër, jemi i vetmi vend në Evropë që një organizatë po e quajmë 'terroriste', ku asnjë nga shtetet e Bashkimit Evropian nuk e ka bërë një gjë të tillë, e as aleatët e partneri ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përderisa për ata nuk janë terroristë, ne nuk do të duhej të ngutëshim.

Këtë nuk po e them që unë jam dhe ne duhet të jemi avokat të Gylenit, por nuk duhet të jemi as xhandarë të Erdoganit.

Po kthehem në temë.

Tash dilemat e ditës së parë të rrëmbimit të shtetasve turq u hoqën, sepse dolën njerëzit, të cilët e morën përsipër se kush e ka bërë, kush e ka urdhëruar, madje përveç tjerash, po vazhdojnë të marrin edhe merita edhe ata njerëz të cilët e kanë marrë këtë përgjegjësi janë presidenti i Republikës dhe institucionet përkatëse, në këtë rast, respektive, AKI-ja dhe Policia e Kosovës.

Tash e kuptuam kush janë ata të cilët dhanë urdhër dhe të cilët e bënë gjithë këtë rrëmbim dhe deportim të shpejtë dhe shumë urgjent të gjashtë shtetasve turq, të cilët po qëndronin në Kosovë në institucione shkollore.

Por akoma nuk u bë e ditur se çfarë i kemi pasur borxh dhe kush i ka borxh dikujt që të bëjë veprime të tilla.

Në fakt, është e vërtetë që Thaçi ka shumë borxhe, për shkak se ka bërë shumë pazare.

Por, mos harroni se Thaçi edhe lanë borxhe me koka njerëzish nganjëherë dhe mos u çuditni, nëse në të kaluarën e ka bërë këtë, mos u çuditni edhe nëse në të ardhmen e bën një gjë të tillë, sepse tashmë ai shquhet për këtë.

Por, shkarkimi i ministrit ose thënë vetëm shkarkimi i një ministri, tregon edhe paaftësinë e Qeverisë së Kosovës, sepse deri më tash çka ndodhi, u shkarkua një ministër. U shkarkua një ministër, i cili tha unë zbatova një urdhër ose gabova ose s'gabova, i cili edhe për mua është brenda asaj çfarë ka ndodhur. Por shkarkimi i vetëm i tij tregon paaftësinë e Qeverisë së Kosovës, se kjo Qeveri e Kosovës përveç dëshirave, nuk ka mundësi t'i shkarkojë ata që në fakt në të vërtetë e morën përsipër rrëmbimin dhe deportimin e gjashtë shtetasve turq në Turqi.

Kështu që nëse do të duhej të ndodhnin shkarkimet, Parlamenti i Kosovës mund ta fillojë qysh tani, të fillojë shkarkimin e atij që e mori përsipër, atë që e ka ngarkuar, pra të fillojë shkarkimin e presidentit dhe shkarkimi i presidentit do të duhej të ishte detyra e parë e këtij Parlamenti, dhe tek e fundit, kurrkush nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, nëse nuk e bën Parlamenti. Kështu që nëse keni kaçik t'i hyni punës së shkarkimeve, hajde të fillojmë prej atij që e mori përsipër, nëse nuk e keni bërë deri tash shkarkimin edhe të atyre që e kanë bërë ekzekutimin e këtij urdhri, siç është kryeshefi i AKI-së dhe kryeshefi i Policisë së Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Shteti atë ditë u pa që ka rënë. Ka rënë shteti, sepse është ngritur mafia politike dhe kurrë s'ka për t'u ngritur shteti derisa nuk bie mafia politike, sepse mafia politike, siç e kemi thënë në këtë Parlament dhe në këtë foltore, e ka kapur majat në këtë rast majën e shtetit dhe majat e institucioneve më vitale, siç është edhe ajo e Policisë, edhe e AKI-së, dhe të tjera.

Deputetë,

E kemi borxh që qytetarëve të Kosovës t'ua themi disa gjëra ashtu siç ne ia themi njëri-tjetrit kur rrimë. E kemi borxh që para qytetarëve të jemi transparentë. E kemi borxh t'u tregojmë që ky shtet tashmë nuk po funksionon dhe mekanizmat e tij më vitalë janë jashtë funksionit. Madje, këtë nuk e themi vetëm ne opozita, këtë e thonë edhe ata të cilët janë sot në shtet. E më së shumti e kanë thënë atë ditë kur në të vërtetë rrëmbimi dhe deportimi i shtetasve të huaj, në këtë rast i shtetasve turq, tregoi edhe një herë që kredibiliteti i këtij shteti tashmë ka rënë. Përveçse është shkaktuar dëm i madh në kredibilitetin e shtetit, është shkaktuar edhe dëm i madh ndaj moralit qytetar dhe njerëzor të këtij vendi, sepse paaftësia e qytetarëve për të vepruar, paaftësia e qytetarëve për të reaguar nuk ka mbetur e kufizuar vetëm në atë çfarë qytetarët kanë mundësi ta bëjnë, por po prezantohet edhe në këtë Kuvend. Përderisa ky Kuvend nuk e shkarkon shkaktarin kryesor, atëherë ne si të paaftë të zgjedhurit e tyre e manifestojmë një paaftësi edhe qytetare në Kosovë.

Kështu që ajo çfarë ndodhi atë ditë, ka ndodhur keq. Nuk duhet as të përsëritet, as të ndodhë më, sepse, tek e fundit, nuk ia kemi borxh askujt, e aq më tepër nuk ia kemi borxh asnjë shteti i cili i ka problemet e veta të brendshme, dhe nuk ia kemi për borxh ne që problemet e Turqisë të transferohen në Kosovë. Le t'i zgjidhin problemet ata vetë.

Kurse, sa i përket cilësimit të Tiranës, si Tirana socialiste, Armend shpresoj të mos e kesh pasur të fokusuar ashtu siç tingëlloi. Tirana nuk është socialiste, as nuk do të duhej të quhet e tillë, Shqipëria nuk është socialiste, as nuk do të duhej të quhet e tillë. Shqipëria është një vend demokratik, një republikë parlamentare, e cila socializmin e ka kaluar qysh në vitin 1990, madje me probleme, me dhimbje shumë të mëdha. Kështu që nuk do të duhej dhe nuk pajtohem që Tirana, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, të cilësohej si "Tirana socialiste".

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faton, veç një sekondë se ia ka përmendur emrin zotit Zemaj, dëshiron replikë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Nuk po dua që të përcillet debati në replika, sepse s'jemi aktorë të saj. Unë iu referova asaj që e thonë vetë pushtetarët në Shqipëri, në pushtetin aktual, sepse të gjithë e dimë se socializmi ka rënë dhe atë ka rënë edhe me ata që e kanë iniciuar edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri, dhe jemi krenarë të gjithë për atë.

Po, unë iu referova vetë kryeministrit aktual, i cili e quan Tirana socialiste, ndërsa akoma s'po mund ta kuptoj pse disa njerëz, kur deputetët e ndryshëm i referohen terminologjisë, çfarëdo qoftë ajo, e gjejnë veten brenda saj.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Selimi!

REXHEP SELIMI: Në fakt, unë nuk e gjej veten brenda Tiranës socialiste, normalisht që e gjej veten brenda asaj që e kemi të përbashkët unë dhe ju, brenda shqiptarizmit dhe, tek e fundit, Shqipërisë t'i referohet si "Tirana socialiste", unë e shpreh edhe një herë, thashë shpresoj që të mos ju kesh referuar ashtu siç tingëlloi. Tek e fundit, për dijeninë e të gjithëve, Shqipëria e ka kaluar socializmin qysh në të '90-tën, e ka kaluar me dhimbje të mëdha dhe sot Tirana është edhe demokratike, edhe e demokratëve, edhe e socialistëve, edhe e republikanëve, edhe të gjithëve, prandaj është e padrejtë që të bëhet një cilësim i tillë, e aq më tepër kur bëhet fjalë për kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, e dihet kush është kuptimi i Republikës së Shqipërisë për të gjithë shqiptarët, edhe për shqiptarët e Kosovës. Kaq, kisha unë jo diçka më shumë. Mos ma merr për të keq, as kundër teje, por ne duhet të jemi të kujdesshëm kur flasim dhe bëjmë cilësime të tilla, aq më tepër kur kryeqytetin shqiptar e veshim me diçka që është ideologjike, e që në të vërtetë nuk qëndron.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Faton, e ke fjalën!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar qytetarë,

Kabinet qeveritar,

Sot, në cilësinë e deputetit, në cilësinë e qytetarit shqiptar të Republikës së Kosovës, dua t'u drejtohem para së gjithash familjarëve të deportuarve.

Të dashur familjarë të qytetarëve turq të deportuar nga vendi im për në Turqi,

Më lejoni që krejt në fillim të shpreh se dhimbjen që keni ju për burrat, për baballarët që ua morën pabesisht nga një grup politikanësh të vendit tim dhe jua dërguan në Stamboll, e ndjej thellë në shpirt dhe e ndaj së bashku me ju. Jam i sigurt që secili prej jush edhe në këto momente kur unë po flas është duke menduar nëse i afërmi i tyre, burri, babai, është duke u torturuar në ndonjërin prej qelive të Stambollit, në qoftë se ka për të dalë ndonjëherë nga burgu dhe në qoftë se ju keni për t'i vizituar ndonjëherë ata, sepse ata janë të akuzuar për terrorizëm.

Për të gjitha këto ndjej keqardhje dhe turpërohem për aktin barbar të atyre që kanë gisht dhe qëndrojnë pas kësaj pune. Në emër të mijëra shqiptarëve të Kosovës dhe besoj që me këtë rast po flas me gojën e shumicës, ju kërkoj falje për aktin e shëmtuar çnjerëzor të politikanëve të përfshirë në këtë pabesi dhe përkulem para dhimbjeve që jua krijuan ata juve, familjarëve tuaj në

Kosovë dhe familjarëve të tjerë në Turqi. E dëgjova me vëmendje fjalimin e zotit Damka, do të them që më vjen jashtëzakonisht mirë që asnjë prej deputetëve që folën deri më tani nuk harruan t'i përmendin raportet e mira që i kemi me Turqinë. Në këtë vazhdë, unë do t'i them edhe zotit Damka, por edhe pjesëtarëve tjerë të minoritetit turk që jetojnë këtu në Kosovë që unë nuk e di se çfarë janë veprat e atyre që u deportuan në Turqi.

Nuk e di nëse kjo organizatë është apo nuk është terroriste, sepse Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk e prezantoi asnjë fakt deri më tani lidhur me veprimtarinë e tyre në Kosovë. Ajo që unë e di është që drejtuesi i kësaj organizate jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe deri më sot nuk është larguar nga ai vend. E di që kërkesa të tilla ka pasur edhe në vendet tjera evropiane dhe asnjë prej tyre nuk është kthyer në Turqi. Në këtë kuptim, unë dua të them që kur flas për dhimbjen, e ndaj këtë dhimbje me familjarët, e shikoj këtë çështje nga aspekti njerëzor, e shikoj këtë çështje edhe nga aspekti i asaj që këtyre që u deportuan në Turqi nuk iu dha asnjë mundësi ligjore për ta mbrojtur veten, për të treguar nëse janë apo nuk janë terroristë, por brenda një aksioni, i cili u zhvillua brenda dy orësh, ata u kapën, u larguan dhe u kthyen në vendin e tyre. Sikur Qeveria zvicerane ta kishte pasur parasysh rrezikun e brendshëm dhe kërkesat e Serbisë për ta dorëzuar në Serbi zotin Thaçi, atëherë sot zoti Thaçi do të ishte në burg. Sikur Republika e Francës t'u përgjigjej kërkesave të Serbisë për ta ekstraduar atë në Serbi, kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, nuk do të ishte në mesin tonë.

Populli shqiptar, pas sundimit 500-vjeçar otoman, së bashku me popullin turk ka arritur të krijojë ura të reja miqësie, të cilat ne edhe si Qeveri, edhe si Kuvend, edhe si popull jemi të interesuar t'i mbajmë të tilla dhe t'i forcojmë. Turqia u bë strehë e mijëra të përndjekurve pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë sundimit serb në Kosovë dhe gjatë luftës me Serbinë për pavarësinë e Kosovës. Këtë e vlerësojmë dhe nuk e harrojmë. Më vjen shumë keq që një grup politikanësh nga Kosova u përzie në punët e brendshme të Turqisë dhe mbajti anë. Sado që ne do të dëshironim që si vend me pavarësi të brishtë, e besa edhe me politikanë të brishtë, të mbanim qëndrim neutral ndaj pushteteve në Turqi. Por, edhe Qeveria turke e bëri të njëjtën gjë duke e kërcënuar kryeministrin e vendit tonë dhe në njëfarë mënyre duke e vënë në pikëpyetje sovranitetin e këtij vendi.

Të dyja palët, sikur harruan për një moment se qeveritë shkojnë e vijnë, por ajo që mbetet duhet të jetë miqësia e pastër dhe reciproke ndërmjet dy popujve. Por, ajo që mbetet në gjithë këtë histori janë dhimbjet e të goditurve dhe familjeve të tyre, është shija e keqe dhe përpjekja nga të dyja anët për interesa ndoshta personale, ndoshta partiake, që të hedhin gurë mbi miqësinë ndërmjet dy popujve.

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kidnapimi i gjashtë qytetarëve turq dhe deportimi i tyre në Turqi bie në kundërshtim me të drejtat fundamentale të njeriut, bie në kundërshtim me Kushtetutën e vendit tonë, bie në kundërshtim me Ligjin për azil dhe Ligjin për të huaj.

Asnjë vend normal, asnjë vend demokratik, nuk e kthen në vendin e tij dikë i cili ndiqet për arsye politike. Këtë rast e tregon më së miri se sa i brishtë është sundimi i ligjit dhe cilat janë përmasat e kapjes së shtetit nga individë dhe struktura që e anashkalojnë dhe e shkelin me të dyja këmbët sistemin e drejtësisë në Kosovë. Vetëm ministri i Drejtësisë, i cili tash në këto momente nuk është këtu, foli për shumë raste të ekstradimit, duke u arsyetuar se edhe në rastet e tjera nuk janë përfillur vendimet e gjykatave. Pra, vetë fakti që ai e pranon që nuk ka pasur fare vendim gjyqësor, tregon që kjo është një shkelje elementare e të drejtave të njeriut.

Kosova është kthyer në një vend të frikshëm për qytetarët e saj, në këtë vend dhe me këtë praktikë të zbatimit të ligjit, secili qytetar i Kosovës është i pasigurt, secili qytetar i Kosovës mund të bëhet viktimë e një shteti të kapur nga individë e grupe interesi që shkelin, respektivisht që e interpretojnë ligjin ashtu siç u konvenon atyre. Shpresoj dhe uroj që sot shumica parlamentare do të hapë rrugë për t'i vënë para përgjegjësisë të gjithë ata që shkelën ligjet e vendit tonë, që i keqinterpretuan ato apo që i përdorën për interesa personale, që na bënë të turpërohem para botës humane dhe që tani e kthyen edhe procesin e liberalizimit të vizave në fillimet e tij.

Sot ky Kuvend duhet të kërkojë transparencë totale për gjithë procesin e kidnapimit të qytetarëve turq në Kosovë dhe përgjegjësi politike e penale për të gjithë ata që e kanë shkelur ligjin. Kjo jo vetëm për shkak të qytetarëve të ekstraduar, por edhe për shkak të sundimit të ligjit në Kosovë. Shteti duhet të ofrojë siguri, shteti duhet t'u garantojë të drejta qytetarëve, shteti duhet t'i mbrojë ata, përndryshe nuk është shtet. Ne, pas gjithë atyre që kemi përjetuar nën pushtetin serb, e meritojmë të jemi qytetarë me të drejta, qytetarë me mbrojtje ligjore. Aty ku cenohet liria e individit, nuk garantohet, nuk sigurohet, shteti e ka humbur funksionin e tij dhe nuk është në shërbim të qytetarit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë se këtë seancë po e mbajmë meqenëse është interpelancë pa praninë e kryeministrit, por edhe të ministrave tjerë, por kërkesat nganjëherë po ikin dhe janë jashtë procedurave dhe përmbajtjes në atë çka ne jemi të thirrur se po lidhem nganjëherë në atë fjalorin popullor që e përdor Milaim Zeka, “kemi mbetur pre e tupanxinjve”.

Një tupanxhi kishte shkuar një herë e i kishte rënë tupanit shumë, një plak i ishte afruar dhe i kishte thënë “çka ka në këtë tupan?”. E çelin tupanin, del i thatë, thotë “shumë zhurmë po bëka”. Prandaj, të mos e luajmë rolin e tupanxhiut për të bërë zhurmë, sepse e dimë mirë historikun e zhvillimit të vendit tonë nga kemi rënë. Personalisht në qeveritë kur nuk i ka drejtuar zoti Haradinaj kemi parë policë të vrarë të Kosovës, kemi parë policë të shtrirë dhe të arrestuar prej

Policisë së Serbisë. Kemi parë dhe është akuzuar shteti edhe për vrasje të individëve e të njerëzve, dhe i kanë marrë si politikë. Gjithçka kemi parë. Kemi parë persona të arrestuar vitin e kaluar në Komunën e Klinës që i ka arrestuar FBI dhe asnjë s'kemi guxuar të ndihemi, e as ta çelim gojën hiç. Veç çeleni gojën, do të thotë ne e dimë kush e mbikëqyrë sigurinë tonë territoriale. Kemi NATO këtu, kemi KFOR këtu, kemi KFOR turk, kemi inteligjencë turke, i kemi dhënë kompanitë publike më të mëdhatë në Kosovë që ata i menaxhojnë. Asnjë nuk folët se si ndihen qytetarët turq në Kosovë, ata që jetojnë këtu janë të Kosovës. Ata kanë kërkesa, janë legjitime. Dëgjova këtu që Presidenti turk quhet "diktator". Kush ia vendos atij diktaturën? Ne?! Duhet të kemi shumë kujdes në deklaratimet se kemi përgjegjësinë më të lartë, jemi të përzgjedhurit e këtij populli. Duhet të kemi kujdes në nivelin tonë diplomatik se nga po shkojmë. Duhet të kemi kujdes në historikun tonë dhe në ndihmën që na është bërë. Duhet të kemi kujdes në atë çka kemi pranuar të na depërtojë brenda.

Keni lënë shoqata, e shoqata humanitare e jo humanitare, ushtarake, politike, sa që njerëzit tanë janë infiltruar brenda këtyre organizatave dhe sot punojnë për ta. Ne e dimë që shteti ynë i ka dhjetë vjet. Mekanizmat e sigurisë ende i kemi të brishtë. Kjo bota e përparuar dhe perëndimore na i trajnon dhe na i trajton çdo ditë. E dimë kur është themeluar AKI-ja. E dimë çfarë mekanizmash të Policisë kemi. I dimë task-forcat që i ka bërë presidentët rend me rend. E dimë bashkëpunimin e AKI-së me ato task-forca, me dijen dhe pa dijen e Ministrisë së Drejtësisë, apo të mekanizmave tjerë. Është shumë lojë e keqe që dikush nga këtu çon lajme dhe i drejtohet Erdoganit, edhe ai sot e ka një fushatë zgjedhore atje sikur e bëjmë edhe ne dhe i drejtohet kryeministrit Haradinaj ndoshta edhe me kërcënime.

Është shtet i madh Turqia, por ne jemi këtu në Kosovë, ne e dimë orientimin tonë. Sot ka pasur takim me Putinin, Putinin e ka ftuar sot presidenti Trump. Duhet të kemi kujdes se jemi duke folur për një aleat brenda NATO-s. Ta ulim zërin, të punojmë si duhet për t'i trajtuar çështjet tona elementare dhe me kujdesin më të madh, sepse është duke na penguar rruga jonë drejt integritetit. Ne që ta kryejmë kushtin e liberalizimit u çuam të gjithë se deshëm ta pengojmë atë proces. Duhet të kemi shumë kujdes. Dëgjova këtu njerëz që thanë se Hashim Thaçin ju po e bëni padron dhe babë të Kosovës, edhe jeni kah e bëni zotëri të të gjithë neve. Ne të gjithë kemi subjekte politike.

Dëgjova se për pazare politike jep dhe të mos ju duket e dyshimtë se në të kaluarën ka dhënë koka njerëzish. Është akuza më e rëndë që e kam dëgjuar prej njerëzve deri tash për një president, ose për një zyrtar, ose një zyrtar që i drejtohet dikujt. Kallëzim penal, zotërinj, tregonani edhe neve! Të mos flasim vetë për njëri-tjetrin edhe duke i gjuajt gishtat kah njëri-tjetri. Qeveritë në Kosovë kanë për të shkuar dhe kanë për të ardhur. E kam thënë që kurrkush s'e ka me tapi këtë vend, edhe atë e bën demokracia jonë, sado e brishtë që është. Të punojmë në interesin tonë të përgjithshëm, t'i ndihmojmë këto procese për të dalë prej këtyre kauzave apo teorive konspirative, se të gjithë po i dini. Unë s'po e di qysh po i dini të gjitha, e nuk po i nxirrni

në sipërfaqe. Është e keqe ajo çka ka ndodhur me ata qytetarë turq. Të gjithë e dimë për shkak se nuk e kanë trajtuar një segment të drejtësisë, por bashkëpunimi ndërshtetëror ekziston, qytetarët turq që jetojnë në Kosovë, që janë pjesë e popullit tonë ata duhet të ndihen të sigurt me ne. Hetim deri në fund, është e drejtë interpelanca dhe kërkesa për rezolutë që t'i shkohet hetim deri në fund, por jo hetim publik se unë e kam parë rastin këtu njerëzit duke dashur e ditur aq shumë për teori konspirative kanë dalë dhe e kanë bërë publik buxhetin e mekanizmave tanë të sigurisë.

Këtu thoshte qysh me kaq buxhet? Kujt je duke i kallëzuar sa buxhet i ke ndarë mekanizmit tënd? Duke dashur të dimë shumë, po e teprojnë. Në qoftë se ne jemi të vënë në funksion për ta dashur këtë republikë, duhet t'i drejtohem konkretisht me dashuri republikës. Asnjë nuk jeni në gjendje sot për të bërë diçka më shumë, por kujdesuni, bashkëpunoni dhe ta nxjerrim vendin dhe të shkojmë drejt integritetit kah jemi të drejtuar. Keqardhja duhet të vazhdojë. Unë mendoj se duhet të kthehem në diskutime, e jo në akuza, në diskutime të ndërsjella, sepse kemi shumë zbrastër ligjore, edhe të marrëveshjet ndërkombëtare, se s'kemi mundur t'i përfundojmë ato, se ne kemi pasur raste të kemi marrëveshje shumë të këqija këtu, por është dashur të trajtojmë shumë brumë për të ardhur deri te një përfundim, por jemi shtet i ri. Edhe bota perëndimore na kupton, edhe BE-ja na kupton, edhe janë duke na ndihmuar shumë, por është në vullnetin tonë a dëshirojmë që të integrohemi dhe të jemi e këtyre mekanizmave, apo jo.

Ne pa shkuar s'kemi qare, sepse është obligim edhe i kryeministrit Haradinaj, yni si Aleancë, edhe i qytetarëve të Kosovës, por varet në vullnetin tonë nëse duam të vonohemi, apo jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës,

Sot po debatohet një çështje shumë e rëndësishme që ka ndodhur në Republikën tonë, por niveli i seriozitetit në këtë debat për mua është shqetësues, sepse mungesa e aktorëve të institucioneve kryesore e plogështon edhe debatin dhe ia humb seriozitetin kësaj çështjeje. Mendoj se deportimi joligjor dhe johuman që u është bërë qytetarëve turq është ataku më i madh që i ka ndodhur Republikës së Kosovës që nga paslufta. Jo vetëm atak ligjor dhe mbi Kushtetutën e vendit, por thjesht me këtë veprim janë prekur edhe gjërat elementare që respektohen në botën demokratike dhe nuk janë respektuar konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Debati i sotëm, por edhe debatet që kanë ndodhur ditëve të fundit për këtë zhvillim, mendoj se nuk duhet kuptuar se ata që japin mendime dhe qëndrime, dhe kërkojnë përgjegjësi janë të pozicionuar për njërën palë, ose tjetrën palë në shtetin e Turqisë. Unë mendoj se ky debat është në vazhden e asaj që është mungesë e funksionimit të hallkave të një zinxhiri që e përbëjnë



sigurinë e vendit dhe kjo mungesë është evidente edhe për faktin se publikisht kryeministri e ka pranuar se s'ka qenë i informuar dhe në momentin kur kryeministri nuk është i informuar nënkuptohet se diçka nuk është në rregull me hallkat e sigurisë së shtetit.

Veprimi në këtë formë sesi ka ndodhur, mendoj se e ka një mesazh jo të mirë për shtetin e Kosovës në raport me botën demokratike, veçanërisht në periudhën në të cilën gjendet Kosova me ambiciet e saj për integritet. Unë mendoj se familja e madhe evropiane dhe bota perëndimore nuk i pranon veprimet e institucioneve të sigurisë në këtë formë si kanë ndodhur dhe mendoj se duhet të japin llogari përgjegjësit e këtyre veprimeve joligjore dhe jokushtetuese edhe për një arsye. Në rast se ne mendojmë se kjo çështje mund të harrohet për 3-4 ditë, e kemi gabim. Po e ripërsëris, ataku më i madh që i ka ndodhur për 19 vjet Kosovës është ky veprim. Ka pasur edhe veprime tjera të papërgjegjshme, mirëpo në periudhën që Kosova ka për synim për t'u integruar, shkeljet e të drejtave të njeriut nga institucionet e shtetit, pavarësisht ku i ndodhin, e prezantojnë një pasqyrë jo të mirë për shtetin tonë.

Se dikush duhet të japë përgjegjësi se edhe adresa e përgjegjësit tashmë është publike, kjo më s'do koment. Mirëpo unë mendoj se rezoluta është vetëm tejkalim i situatës dhe në këtë rast, pavarësisht se në pikën e dytë të propozuar nga zoti Hoti në rezolutë rreth Komisionit Hetimor, unë mendoj se Komisioni Hetimor Parlamentar duhet të formohet nga ky Kuvend, një komision i përbërë prej përfaqësuesve të të gjitha subjekteve parlamentare, i udhëhequr nga opozita dhe të hulumtojë dhe të hetojë se ku kanë ndodhur defektet, të cilat e kanë dëmtuar imazhin e Kosovës në aspektin e sigurisë, dhe personat përgjegjës, si dhe ata që i kanë shkelur ligjet dhe konventat ndërkombëtare të fillojnë të përgjigjen para organeve të drejtësisë. Nëse ne si shtet nuk e bëjmë një veprim të kësaj natyre, ta kemi të qartë se ne thjesht jemi duke humbur kohë në ato pretendimet e arsyeshme të qytetarëve për një shtet demokratik ligjor dhe të integruar në Evropë.

Është momenti i fundit që njerëzve të papërgjegjshëm në institucione t'u jepet një përgjigje nga organet e drejtësisë dhe me qëllim që këto shkelje, këto veprime të papërgjegjshme të mos përsëriten. Në anën tjetër, në rast se kalohet edhe kjo siç dikush ka dëshirë, unë jam shumë i bindur se ne do të bëjmë vendnumërim edhe për dekada të tëra lidhur me veprimet e njerëzve të papërgjegjshëm në institucione, lidhur me marrëveshjet, lidhur me kontratat dhe bizneset e tyre individuale dhe shoqëria jonë dhe përfaqësuesit e kësaj shoqërie, siç është Kuvendi, do të merren me këto probleme, duke i lënë problemet jetike të qytetarëve të Kosovës në rend të dytë dhe vetë fakti që ditëve të fundit, ose muajin e fundit kemi pasur disa debate më shumë se të ashpra në Parlament, të ndarë në dy taborë, për marrëveshje të papërgjegjshme të presidentit të shtetit dhe këto gjëra me gjasë do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, çështjet jetike, me të drejtë qytetarët presin nga ky Parlament i zgjedhur do t'i kapë pluhuri dhe do t'i kapë harresa.

Kështu që e mbështes idenë e Komisionit Hetimor Parlamentar me përfaqësues të të gjitha partive politike dhe për një periudhë të caktuar ai komision të dalë para Kuvendit për përgjegjësit

kryesorë të shkeljeve të rënda që kanë bërë në këtë rast dhe natyrisht, në bazë të atyre shkeljeve edhe të shkojnë para përgjegjësisë juridike dhe penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik e ka fjalën.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Sayın bakanlar, değerli milletvekilleri,

Mevkidaşımın yaptığı açıklamalara ek olarak değinmek istediğim konular var. Kosova'nın odaklanması gereken en önemli konulardan biri, dost ülkeleriyle ilişkilerinin tehlikeye atmaktan kaçınmasıdır. Son günlerde medyaya yansıyan Türkiye aleyhine yazılara ve saldırılara, Türkiye Cumhurbaşkanına etilen hakaretleri hayretle izliyoruz. Türkiye Cumhuriyetinin dost dediği ülkemiz Kosova'ya yaptıklarının birkaçını saymak gerekirse, savaşa stres ve sonraki destekleri, bağımsızlığını ilk tanıyan ülkeler arasında olması, yatırımcıların ticari ve ekonomi desteği, Kosova tanınması için lobicilik yapması, sağlık bakanlıklarının arasında yapılan anlaşma ile yılda 100 hasta iken kardeşlik dungu ve ilişkilerinden iki-üç katına çıkarıldı. Bütün konuşulanlar arasında bilinen tek şey var ki Kosovanın 1999 savaşından önce, savaş zamanı ve sonrasındaki destekleri sayarken, Türkiye Cumhuriyeti'nde Kosova söz konusu olunca, iktidarda, muhalefette her zaman tek ses olmuştur.

Özellikle Sırbistanla Kosova arasındaki müzakerelerin yapılmasında, Türkiye Cumhuriyeti'nin katkısını müzakere yapanlar bilir. Unutmayalım Türkiyenin önümüzdeki günlerde yine Kosova'nın lehine çalışmaları olacaktır. Türkiyeye göç etmiş, orada yaşayan Arnavut asıllı Türk vatandaşlarının çocuklarına Arnavutça ders olarak öğretilmesi, kardeşliğin bir göstergesidir daha. Bundandır bu kardeşlik, dostluğun da güçlü bir şekilde devam edeceğine ve şimdiye kadar olduğu gibi şimdiden sonraki dönemlerde de Türkiye Cumhuriyeti'nin ülkemiz Kosova'ya desteğinin tam olacağını bir daha teyit ederim.

Konuşmalar yapılırken Türk milletvekilleriye diye konuyla ilgili hassasiyet belirtmeye gelen çoğunluktaki milletvekillerinin yanımıza gelerek destek sunmaları memnun edici bir şey. Ancak Türkiye'nin Kosova'ya sunduğu karşılıksız destekleri biraz daha fazla, çoğunluk topluluk milletvekillerinden duymak isterdik. Aralarında dile getirenlere teşekkür ederiz ve aynı zamanda herkese saygılar sunarız.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, mendova që e kam fjalën më vonë, se disa kolegë të mi janë paraqitur më herët, por gjithsesi faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë po e shoh shumë të parëndësishëm këtë debat, meqenëse kryeministri i vendit nuk është këtu dhe jemi duke diskutuar në mes vete, duke provuar t'i ndajmë këto shqetësime me popullin e Kosovës, por në fakt ai që ka mandat kushtetues që të kujdeset për sigurinë tonë individuale dhe kolektive në këtë shoqëri, ai ka vendosur të ikë diku, nuk e di ku është.

Normalisht që ashtu siç edhe u deklarua disa herë, që për dy rastet më të rëndësishme që ndodhën në Kosovë, ai s'ka informata fare. Ai i merr vesh nga lajmet, ai i merr vesh nga televizioni dhe, në fakt, kjo tregon për degradimin publik që qeverisja në Kosovë po përjeton. Tash ka këtu disa fjalime, qoftë të ministrit Jagxhillar, qoftë të disa përfaqësuesve të Partisë Turke, që të provojnë që këtë çështje ta lidhin në mes raportit të shtetit të Kosovës dhe shtetit të Republikës së Turqisë, unë mendoj se ky është gabim i madh. Nuk është Kosova kundër Republikës së Turqisë. Kosova është mirënjohëse ndaj kujtdo që e ka ndihmuar Kosovën, edhe në çlirim, edhe në shtetndërtim, por e kam thënë edhe në një rast tjetër, po e them edhe sot, Kosova nuk është çliruar nga dikush për t'u pushtuar nga dikush tjetër.

Ne kemi deklarata universale për të drejtat e njeriut, ne kemi dokumente të rëndësishme evropiane, ne kemi ligje të Kosovës, ne kemi Kushtetutë të Kosovës dhe si të tillë ne duhet t'i respektojmë ato. Unë e di që ka 30 vjet që Republika e Turqisë provon të hyjë në Bashkimin Evropian dhe nuk po arrin për shkak të disa vlerave që nuk po i përqafton. Nuk e dua këtë fat, që shteti im ta ketë të ngjashëm, që të kalojnë tri dekada dhe ne të mos i respektojmë kartat më të rëndësishme, që bota civile dhe e civilizuar i ka miratuar. Unë dëshiroj që shteti ynë, shteti im, të mos bëhet pjesë e vendeve ku dikush, kurdo dhe kurdo që vlerëson ai të futet në Kosovë, t'i japë leje Qeveria e Kosovës për të ateruar aeroplani në Kosovë, të kidnapohen në rrugë dhe të deportohen për një shtet tjetër. Ka procedura, ka rregulla edhe për organizatat terroriste, nëse ka vlerësime në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë që janë organizata të tilla, dhe më pas të respektohet ligji.

Unë kam përshtypjen sikur në Kosovë është vetëm një person që i di krejt gjërat që ndodhin në Kosovë, të tjerët ose janë në margjina, ose e dinë e edhe ata, por shtiren kinse nuk e dinë. Po u referohem vetëm disa deklaratave të presidentit Thaçi, i cili madje na tha se kishte pasur informata edhe ku ka fjetur Marko Gjuriqi një ditë para se të arrestohet, tha: "Ka fjetur në banesën e Milan Radoçiqit në veri". Tha: "Këto informata i kam unë". Pse nuk i ka pasur Ministria e Punëve të Brendshme këto informata? Pse s'kanë shkuar ta arrestojnë Marko Gjuriqin në banesë të Radoçiqit? Pse s'kanë shkuar ta arrestojnë të nesërmen në mëngjes? Por, u desh të bëhet skandal në një tubim publik, e më pas të arrestohet aty dhe të tërhiqet zvarrë edhe në qendër të Prishtinës. Tani, në deklaratën tjetër të presidentit të vendit, ai tha që ka informata edhe nga kush financohet Lëvizja "Vetëvendosje", "nga Turqia", "nga Irani", e kështu me radhë. Kush është ky person, në fakt? Kush e informon këtë person? Si është e mundur presidenti i vendit të ketë informata të tilla dhe të mos i deponojë në organet e ndjekjes në Kosovë.

Si është e mundur që pothuajse vizitorë të përditshëm presidenti i vendit t'i ketë Aleksandër Lumezin dhe Shpend Maxhunin? More, e kanë huqur adresën këta! Ka pushtete të ndara në Kosovë, ka pushtete të cilat Kushtetuta e Kosovës ia ka përcaktuar dhe i tregon vendin secilit kush ku e ka. Dhe, mos çuditëni pse Hashim Thaçi i di këto krejt. A e dini pse? Ish-shefin e AKI-së, Bashkim Smakën, ai e ka këshilltarin e parë për siguri. Shefi aktual i AKI-së ka qenë anëtar i Kryesisë së PDK-së në Prishtinë. PDK-ja e ka kapur edhe SHIK-un, edhe AKI-në, sepse këta janë. Mos çuditëni dhe nëse kryeministri i vendit një ditë përpara ndihet i fyer se pse presidenti s'po e njofton, bashkë me vezët ngjyra-ngjyra për Pashkët te zoti Pal, atëherë këta i dinë krejt. Këta i kanë organizuar këto, por po shtiren kinse nuk i kanë bërë. Prandaj, unë po them presidenti i vendit, unë po e shoh, me këtë qasje që ka vendosur, duke i anashkaluar krejt institucionet shtetërore dhe kompetencat kushtetuese, është shndërruar definitivisht në kërcënuesin më të madh të stabilitetit të Kosovës, të të tashmes dhe të perspektivës së këtij vendi. Mund të thoni çfarë të doni! Është gjuhë e diktatorëve kur thotë që: “unë i kam informatat”, “unë e di ku ka fjetur”, “kush ka qenë”... fillon e mbjell një ndjenjë të pasigurisë kolektive, që të thuet “veç ky e di, ky ka informata, ne të tjerët s'dimë”. As nuk di Driton Gashi, as nuk di Shpend Maxhuni dhe askush tjetër.

Mendoj që ne tash si klasë politike duhet të përgatitemi seriozisht që ta delegjitimojmë këtë president që e kemi. E di që ai kujdeset shumë që të mos e vë firmën kurrkund, që të mos mund ta referojmë ne në Gjykatën Kushtetuese, përndryshe ai sot do të duhej të ishte i shkarkuar. Ne s'mund sot për shkak se ai kurrkund nuk e vë firmën, ama çdo ditë shkojnë Lekë Lumezi dhe Shpend Maxhuni në zyrën e tij, në vend se të ndodhë e kundërta. Po, mediet po e japin këtë, i dimë të gjithë, e dini edhe ju. Dhe, tash unë po e shoh që... po i marr dy shembuj, më 22 dhjetor kur ju e sollët Gjykatën Speciale këtu, në fakt e rrezikuat një raport qenësor me Amerikën dhe Perëndimin. Tash, më 29 mars jeni duke na sjellë në një situatë goxha delikate, që të prishemi edhe me Republikën e Turqisë, sepse po na e quan kryeministrin “kukull”, sepse po thotë “ai është zgjedhur me telekomandë dhe shkon në shpi me telekomandë”, sepse po na thotë “ai është i turpëruar”, presidentin po e quan vëlla. Dëshët të na prishni me Amerikën dhe me Perëndimin, tash edhe me turqit! More, në shërbim të kujt jeni, more vëlla? Në funksion të kujt jeni ju? A s'po doni as me ata, as me këta, mos keni dikë tjetër, mos jeni duke e bërë lojën e dreqit këtu, me të cilën vërtet ky vend do të ketë pasojat më të mëdha.

Unë po ju them, kujdesuni se jemi në situatë të rëndë. Unë them, situata më e rëndë që kemi pasur nga paslufta në Kosovë, ku kurrkush nuk dihet, nesër mund shërbimi grek të vijë ta arrestojë dikë, edhe shërbimi hebrenj, edhe çfarëdo shërbimi... A jemi shtet, a çka jemi ne? Deri kur do të sillemi kështu, kinse s'po dimë asgjë? Po, dikush po di, sepse masandej po thotë “qysh jo, more, unë i kam ditur krejt”, po na tregon krejt. Edhe nëse dyshoni që presidenti Thaçi s'e ka ditur, dëgjojeni Erdoganin çka po thotë, “I falënderohem vëllait tim Hashim”. Ai po na tregon që krejt i di bashkë me të, madje po thotë “kjo është realizuar pas një bashkëpunimi të gjatë me institucionet e Kosovës, AKI-në, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme,

Ministrinë e Punëve të Brendshme. Këta thonë “S’dimë send!” Atëherë, nëse s’dini kapni valixhet dhe shkoni në shtëpi, ose nëse dini dhe jeni duke punuar kundër interesave të këtij vendi, prapë kapni valixhet e shkoni në shtëpi, se nuk jeni për të mirën e këtij vendi.

Unë po kërkoj të gjejmë formë nëpërmjet Komisionit Hetimor, që ta gjejmë një fakt të vetëm, ose së paku dëshmitarë sa më shumë kundër këtij presidenti, që ta gjejmë mënyrën se si ta deligjitmojmë dhe ta rrëzojmë nga pushteti, sepse Kushtetuta jonë është goxha e ngurtë për mundësinë për ta rrëzuar Presidentin. Ai ose duhet të bëjë krim të rëndë, ose duhet të shkelë rëndë Kushtetutën, ose duhet të jetë i paaftë. Për krejt këto ne s’mundemi, pa pasur fakte e argumente. Të gjithë e dimë që ai e di dhe është i përfshirë këtu, po s’po mund të ndërmarrim veprime. Prandaj, nëpërmjet Komisionit Hetimor ne mund të nxjerrim fakte të mjaftueshme, që më pas këtij personi t’i themi “Lësho rrugë, sepse ky vend meriton një qasje tjetër, njerëz tjerë dhe me perspektivë krejtësisht ndryshe”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të jesh në opozitë në këtë Parlament e ka megjithatë një të mirë, keni përparësi fjale gjithmonë. S’e di pse ndodh kjo, ndoshta ka krijuar Sheshi 21 simpati ndaj juve. Jo, nuk jeni, as nuk keni për të qenë asnjëherë, këtë dije.

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, në fakt, nuk kisha dashur të flas. S’do ta kisha besuar kurrë që në shtetin tonë do të ndodhte një akt i tillë, një ndërhyrje kaq flagrante në punët tona të brendshme dhe një papërgjegjësi e tillë politike dhe institucionale. Deportimi i gjashtë qytetarëve turq nga Kosova pa i respektuar procedurat e parapara ligjore dhe duke e anashkaluar Prokurorinë e Shtetit, thënë më së buti, është shkelje e të të drejtave të njeriut. Në një vend si Kosova, që ka vuajtur shumë nga mungesa e të të drejtave elementare dhe në shtetin që e sublimon qëllimin demokratik të të drejtave elementare të qytetarëve të dhunuar, të vrarë e të masakruar me dekada të tëra, janë shkelur nga po ky vend, nga po ky shtet, edhe e drejta pozitive, edhe aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Rasti me gjashtë qytetarët turq të referuar në medie si “gülenistë”, për mua si qytetar dhe si deputet i Parlamentit të Kosovës është sulmi më i rëndë mbi demokracinë tonë ende të brishtë, është atak, po e përsëris, është atak mbi aspiratat demokratike të Republikës së Kosovës dhe orientimit të saj europërendimor. Dje, ose pardje, nuk më kujtohet saktë, në medie e lexova dhe nuk di nëse është e saktë, që BE-ja ka lëshuar nëpërmejt zëdhënëses së saj një deklaratë për

Kosovën dhe për rastin e fundit, e cila e cilëson Kosovën si një vend ku dyshohet funksionimi i sundimit të ligjit, si dhe në një deklaratë tjetër, prapë po u referohem medieve, sepse nuk e di sa janë të sakta, nuk i kam parë vetë dhe nuk e di nga kush është kjo deklaratë, por e di që i drejtohet zonjës Mogerini dhe e cila deklaratë e vë në pikëpyetje nëse Kosova duhet të lejohet të futet në Bashkimin Evropian. Paramendoni çfarë dëmi i është bërë Kosovës me këtë veprim kohëve të fundit. Dhe, e gjithë kjo në kohën kur ne presim ta përmbushim kriterin e fundit për liberalizimin e vizave, ne presim ta përmbushim kriterin e fundit, që është korrupsioni dhe sundimi i ligjit, ka ndodhur kjo.

Shtete zvarranikë që i nënshtrohen egos autoritariste të presidentit të Turqisë, e kemi parë dhe mund të shohim vetëm në Azi dhe Afrikë, por jo në Evropë, e as në Amerikë. Ne si evropianë të rinj të përcaktuar për vlerat dhe parimet demokratike perëndimore me kidnapimin e profesorëve të Kolegjit “Mehmet Aki” e kemi rrezikuar rrugën tonë, të ardhmen tonë demokratike. Për mua s’ka rëndësi a është Erdogan, a është Gylen, apo kushdo tjetër që është atje. Për mua ka rëndësi shteti i Kosovës dhe marrëdhëniet e mira me Turqinë. Pra, nuk duhet të keqkuptohemi. Nuk duhet t’i përziejmë as këto gjëra. Kjo s’do të keqkuptohet dhe marrëdhëniet tona me Turqinë pa dyshim që kanë rëndësi të madhe për ne.

E kam thënë edhe në rrjetet sociale ditën kur ka ndodhur ky veprim, po e them edhe sot që për mua është e papranueshme, pra është e papranueshme që Kosova të veprojë në kundërshtim të plotë me politikën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Po ashtu, është e dënueshme dhe duhet të adresohet përgjegjësia për aksionin tinëzar që ka ndodhur. Nëse kjo nuk bëhet, atëherë deportimi i gjashtë qytetarëve turq bëhet sulm mbi shtetin tonë, mbi sovranitetin e shtetit tonë. Ndryshe s’mund të shpjegohet fakti që kryeministri i vendit cilësohet edhe si “komandant suprem”, i Policisë së Kosovës, por edhe i AKI-së nëpërmjet Këshillit të Sigurisë, të mos ketë qenë i informuar për këtë rast. Ndryshe, ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i AKI-së nuk do të duhej të kalonin vetëm me dorëheqje apo me lirim nga detyra. Një shkelje e tillë e ligjeve dhe parimeve kushtetuese të Kosovës është e dënueshme dhe ne duhet të jemi të pakompromis në mbrojtjen e tyre.

Cilat kanë qenë arsyet e vërteta për këtë rast? Si u realizua aksioni dhe kush ka dhënë urdhër? Dua të besoj se do të sqarohet në ditët në vijim nga hetimet që ka ndërmarrë Prokuroria, por pasojat që mund të prodhojë ky rast në raport me bashkësinë ndërkombëtare janë shqetësuese për mua dhe besoj për secilin prej nesh këtu. Siç ju pata ftuar, në fjalën time të parë këtu në Parlament, për unitet në çështjet madhore, në çështjet nacionale pa dallim pozitë dhe opozitë, shpresoj se debati lidhur me këtë rast t’i ndihmojë shtetit dhe institucioneve të saj, t’i ndihmojë Kosovës në forcimin dhe konsolidimin e saj demokratik, t’i ndihmojë zgjedhjes më të mirë duke evituar çfarëdo pasoje të mundshme.

Pra, përveç përgjegjësisë që ne duhet të adresojmë, ne duhet të jemi bashkë dhe të gjejmë një zgjidhje se si të mos cenohen marrëdhëniet tona të mira me aleatët tanë, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Evropa, por edhe Turqia.

Në përmbyllje të fjalës sime sot, duke pasur parasysh interesin e qytetarëve tanë dhe pritjen e tyre për liberalizimin e vizave, do të dëshiroja t'i bëj thirrje bashkësisë ndërkombëtare, t'u lutem zyrtarëve vendimmarrës në Bruksel që për shkak të disa politikanëve të papërgjegjshëm të mos ndëshkohen qytetarët e Kosovës. Qytetarët nuk kanë faj nëse ne s'jemi në nivel të detyrës. Faleminderit!

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufera Shinik.)*

KRYESUESJA: Fjalën e ka Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot gjatë diskutimit hasa në disa diskutime të kolegëve të mi që me të vërtetë më kanë shqetësuar shumë. Shqetësimi primar ishte se disa prej deputetëve të komunitetit turk këta të dëbuar i quajtën terroristë, pa na dhënë asnjë sqarim se çka kanë bërë këta që janë terroristë dhe në qoftë se kanë qenë terroristë, pse nuk u arrestuan dhe nuk u gjykuan këtu në vendin tonë, por u dëbuan.

Shqetësimi tjetër është prej disa deputetëve tjerë, kur thanë ne nuk duhet të diskutojmë, duhet ta ulim kokën, bile-bile as të mos flasim. Pajtohem plotësisht që duhet ulur kokën, por duhet ta ulin kokën ata që e kanë "bishtin e zënë me derë". Mos të flasim ata të cilët me të vërtetë janë duke punuar në drejtim të keq. Puna është e llojllojshme, por kjo punë që është bërë deri tash është bërë vetëm në dëm të Republikës së Kosovës.

Në këtë ngjarje janë shkelur pothuajse të gjitha ligjet e Kosovës. Së pari, nga Ligji për AKI-në është shkelur neni 2, që ka të bëjë me fushëveprimin e Agjencisë, pra me kërcënimin e sigurisë së shtetit. Ne nuk kemi kurrfarë dokumenti apo materiali se çka kanë kërcënuar këta pesë arsimtarë dhe ky mjek dhe është shkelur neni 2.1, që është shkelur në të gjitha nënpikat. Me këtë rast është shkelur edhe Ligji për klasifikimin e informacioneve, konkretisht neni 7, dhe për këtë kryeministri ka deklaruar që nuk ka asnjë lloj informacioni.

Në këtë rrëmbim, që po e quajmë "deportim", është shkelur edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe atë nga neni 1 deri te neni 15. E në anën tjetër, kur këta persona nuk kanë pasur të drejtë të shprehen në Gjykatë, apo ta kenë një proces gjykues, del që në tërësi Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është shkelur. Shkelje ka edhe neni 17 i Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështje penale, që ka të bëjë me klauzula jodiskriminuese.

Një shtet tjetër po pretendon që ata i kanë shkelur ligjet e atij vendi dhe përbëjnë rrezik. Në këto raste bëhet kërkesa për ekstradim me procedura të rregullta nga Ministria e Drejtësisë te sistemi gjyqësor. Një proces i tillë nuk ka ndodhur. Është shkelur neni 18, që ka të bëjë me kërkesat për ekstradim. Ka edhe shumë nene tjera të kësaj fushe dhe është për çudi se si nuk kemi asnjë deklaratë të ministrit të Drejtësisë, përpos ato deklarata sot që i dha dhe që nuk qëndrojnë asnjëra.

Hashim Thaçi ka hyrë në një rrugë shumë të rrezikshme e dukshëm të dëmshme për Kosovën, pavarësisht synimeve të tij haptazi për mbrojtjen e personalitetit të tij. Kjo po bën shkas cenimin e rëndë të shtetit tonë. A mund ta dimë kështu publikisht se çka i kemi borxh ne dhe çka i ka borxh Kosova Hashim Thaçit? Çka i kanë borxh qytetarët e këtij vendi këtij njeriu, që për çdo vit prodhon nga një skandal për secilën temë ku ai përzihet apo përfshihet? Në konferencën e fundit për medie, në vend se të japë llogari para popullit për çka ka ndodhur, u lëshua në shpifje dhe me fjalë që përbëjnë shkelje të rëndë kushtetuese, të Kodit Penal lidhur me Lëvizjen “Vetëvendosje”. Ky njeri duhet të ndalet, madje ky njeri as nuk është dashur të bëhet president. Falë disa deputetëve, të cilët e dinë shumë mirë kush e ka votuar dhe si i tillë ai ende po na shfaqet rrezik dhe po paraqet rrezik shumë të madh për Kosovën.

Nuk ka mbetur asgjë tjetër, përpos që ta vendosim përpara përgjegjësisë.

Më mirë ta vendosim ne, se sa ta minojë gjithë shtetësinë e Kosovës për ta shpëtuar kokën e vet.

Kosova nuk i ka asnjë borxh Hashim Thaçit, përkundrazi ai ka shumë borxh Kosovës.

Shumica e familjarëve të deportuarve përpara mediave kanë thënë se “Hashim Thaçi na e ka ngul thikën pas shpine”. Është më se e vërtetë, po jo vetëm atyre, Hashim Thaçi ua u ka ngulur thikën pas shpine shokëve dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të tij deri tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Haxhi Shala. Replikë Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Replikë kërkova sepse i ka përmendur deputetët turq lidhur me disa fakte, të cilët i kemi paraqitur si terroristë të Fetulla Gylenit. Shumë mirë e di Millaku se në tentim puçin brenda një dite janë vrarë 248 civilë turq në Turqi.

Janë 2 200 civilë të lënduar në këtë tentim puçi, në qoftë se nuk janë këta terroristë, kush janë terroristët? Cilët janë ata emra si terroristë, në qoftë se nuk janë këta?



Unë propozova edhe propozoj edhe një herë, le të lexojë raportin e AKI-së për këta gylenistët që ne i quajmë terroristë, çka kanë vepruar në Kosovë, të lutem, lexo këto raporte të AKI-së, mandej flasim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kundër-replikë, një minutë e keni.

DRITA MILLAKU: I nderuar deputet,

Ne si shtet nuk është dashur të përzihemi në këtë veprim dhe në qoftë se keni pasur informacione që këta kanë qenë me të vërtetë terroristë, atëherë është dashur që këto informacione t'ua drejtoni gjykatave, meqenëse po thirrremi gjithmonë që kemi një shtet institucional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim Zeka, me kartelën e deputetit Haxhi Shala.

MILAIM ZEKA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Personalisht mendoj që perceptimi se a janë këta njerëz të dëbuar terroristë, pavarësisht ndjenjave dhe pavarësisht mendimit ekstrem, respektin që kam për mendimin ekstrem liberal ndaj deputetëve turq që të etiketohen këta njerëz si terroristë, kjo është çështje perceptimi, sepse për dikë edhe Erdogani mund të jetë terrorist, edhe Erdogani mund të jetë diktator, por janë qytetarët e Turqisë ata që vendosin se kush është Erdogani.

Ajo që mua personalisht më shqetëson si deputet i Parlamentit të Kosovës është fakti i krijimit të pasigurisë në Kosovë. E natën kur janë kidnapuar këta njerëz, këta nuk janë arrestuar, po janë kidnapuar në mëngjes, mua personalisht më është krijuar për herë të parë në jetën time ndjenja 100% e pasigurisë që unë të jetoj në Kosovë.

Në qoftë se unë si deputet ndihem i pasigurt që të jetoj në Republikën e Kosovës, në qoftë se unë si deputet mendoj që shteti i Kosovës është 100% privat, është shtet i privatizuar, është shtet me pronë 100% private, ku aksionar i vetëm i këtij shteti është Hashim Thaçi.

Dhe në rastin konkret si gjysmaksionar është Bexhet Pacolli, ministri i Punëve të Jashtme. Asnjë person këtu, edhe LDK-ja, që i mëshon rreth e rrotull, sillen rreth dardhës së Ahmatit pa i mëshuar në shenjë goditjes.

Të gjithë e dinë se përgjegjësit kryesorë për kidnapimin, për rrëmbimin, për dëbimin e gjashtë qytetarëve turq janë Hashim Thaçi dhe Behxhet Pacolli.

As ministri i Punëve të Brendshme që ka qenë ministri më i mirë, Flamur Sefa, as ai segmenti privat i Hashim Thaçit, që është AKI-ja, as ministri i Drejtësisë, i shkreti që s'ka asnjë pikë gjynah, po që e ka ditur fortë mirë, as komandanti i Policisë, se këtyre njerëzve po u tha Hashimi

24 orë rrini në njërën këmbë, këta në njërën këmbë rrinë. Nuk janë këta përgjegjës: është Behxhet Pacolli, i cili pa qëllim e tha publikisht në televizor që urdhrin e ka dhënë shefi i AKI-së dhe në qoftë se ju jetoni në një shtet diktatorial, ky s'është fare shtet parlamentar, që ministri i Punëve të Brendshme dhe zëvendëskryeministri e thotë publikisht se urdhrin për rrëmbimin e këtyre njerëzve e ka dhënë drejtori i AKI-së, atëherë çka duam ne, çfarë përgjigje tjetër presim, ai vetë e zbuloi, vetë e tha.

Tjetra, unë jam i prirë të besoj, unë nuk kam paragjykime ndaj njerëzve. Më tha sot Driton Sejdiu se më duket më ke fotografuar një ditë në një kafe. I thashë të betohem që nuk të kam fotografua, por e di kush të ka fotografuar, po unë s'të kam fotografuar dhe më besoi. Edhe unë jam i prirë t'u besoj njerëzve.

Tani, unë jam i prirë të besoj 100% që kryeministri Ramush Haradinaj, mësa e kemi ditur ne, aq e ka dituria, as Kadri Veseli, por ju lutem, atë ditë kur ka dalë Kadri Veseli në këtë foltore dhe ka thënë me krejt shpirtin e vet që do të bënte të pamundurën të shkonte në aeroport privatisht e ta parandalonte dëbimin e tyre, për mua ka qenë akoma më shumë një dallgë e frikës. Kur kryetari i Parlamentit thotë të shkojë dhe ta ndalë aeroplanin, me çka? Me duar, me gjoks, me këmbë. Po, por me gjoks nuk ndalet aeroplani, ndalet përmes institucioneve, se ju me gjoks e keni bërë privat këtë. Ai vjen edhe më merr nesër edhe mua dhe më çon, edhe te ai, edhe te ai.

Sidomos këtë nuk e kam pritur prej të burgosurve politikë, nuk e kam pritur as prej Hashim Thaçit, as prej Agim Çekut, as prej asnjë personi tjetër që janë ndaluar së bashku me shefin e "Nismës" nëpër aeroportet e botës dhe janë kërkuar nga shteti terrorist i Serbisë.

Ne nuk kemi nevojë këtu të flasim për punën e bizneseve, sepse ne e dimë që Turqia ka aq fuqi sa me bardak të çajit e blen krejt Kosovën. E lëmë ne, por nuk bëhet biznes me të drejtat e njeriut, nuk bëhet biznes me fatin dhe jetën e njerëzve, nuk bëhet biznes duke tejkaluar gjykatat dhe Prokurorinë e Shtetit që është institucioni më i lartë i këtij vendi.

Kur një njeriu i qitet thesi në kokë dhe kidnapohet në mëngjes duke shkuar në shkollë, kur këtyre njerëzve sot u dalin nëpër gazeta konto numrat e bankave nga sa para i kanë deponuar këta nëpër banka, sa para kanë pasur nëpër banka, në çfarë shteti të sigurisë po jetojmë ne?

Prandaj, të nderuar deputetë,

Ne e dimë që krejt kjo është vepër e Hashim Thaçit dhe e Behgjet Pacollit.

Unë po e citoj këtu ish-ministrin e Punëve të Jashtme, Enver Hoxhën, mua personalisht më ka thënë se gjashtë nota verbale i ka pasur nga Qeveria turke për dëbimin e këtyre njerëzve dhe e ka refuzuar një gjë të tillë.

Erdhi Behgjet Pacolli, së bashku me Hashim Thaçin, e gatuan kulaçin dhe i çuan njerëzit midis ferrit.

Unë do t'ju kisha lutur diçka si kolegë, kur flasim është mirë nganjëherë të mbahen shënime. Unë mbaj shënime kur flasim kolegët e opozitës, pozitës, nganjëherë prej fjalimeve të tyre nxjerr konkluzione, bëj analiza.

Në këtë foltore kam folur para gjashtë muajve për AKI-në, në këtë foltore kam thënë që AKI-ja është agjenci private për t'i shantazhuar njerëzit dhe atëherë është dashur të merret seriozisht fjalimi im dhe të fillohej e të bëhej një hetim ndaj AKI-së. AKI-në është dashur ta hetojmë ne te rasti i Kumanovës. AKI-ja kur ka qenë në krye kushëriri im, Bashkim Smakaj, kam fakte, kam dokumente, kanë shkuar dhe iu kanë lutur personat e AKI-së njerëzve, të cilët kanë punuar në Shërbimin Sekret Serb, e kanë lutur Jonuz Loshin në Mitrovicë, e kanë lutë Lutfi Ajazin, i cili gjysma e deputetëve mendoni që ka vdekur në Gjermani, ai ka vdekur në Breg të Diellit dhe i kanë thënë: "A mundesh t'i veç me na i dhënë katër rreshta dëshmi edhe me thanë që Rexhep Selimi, Glauk Konjufca, Milaim Zeka kanë qenë bashkëpunëtorë të UDB-së". Këtë e ka bërë AKI-ja, t'i fusë njerëzit në regjistër për t'i shantazhuar!

Prandaj e kam quajtur unë AKI-në si 'drejtori e shantazhit', drejtori që i filmon, i incizon e i përgjon njerëzit kur flenë privatisht, edhe me gratë e veta. Prandaj, kam thënë të hetohen këta. Bira e fundit e kavallit është Driton Gashi me Shpend Maxhunin, me të gjithë të tjerët. Në qoftë se doni të bëni hetim parlamentar, ta hetojmë veprën penale, të cilën e ka bërë Hashim Thaçi me Behxhet Pacollin. Këta kanë bërë vepër penale, këta i kanë çuar njerëzit drejt vdekjes, këta i kanë shkelur të gjitha konventat njerëzore ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Unë po ju them diçka, aq shtrenjtë do të paguajnë këtë vepër turpi qytetarët e Kosovës që neve do të na luajë kapaku i kresë.

Prandaj, u bëj thirrje ambasadave të vendeve perëndimore, Bashkimit Evropian që të mos bëjnë ndëshkim kolektiv ndaj qytetarëve të Kosovës, po të orientohen te ndëshkimi individual dhe ky ndëshkim individual në radhë të parë duhet të shkojë te Hashim Thaçi dhe te Behgjet Pacolli. Kaq. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rasim Selmanaj.

**RASIM SELMANAJ:** Të nderuar kolegë deputetë,

Duke u nisur nga parimet dhe vlerat tona si qytetarë, mbi të cilat po ndërtojmë shtetin tonë, depërtimi, apo siç u tha këto ditë, kidnapimi i gjashtë qytetarëve turq është në kundërshtim me sistemin kushtetues dhe ligjor të vendit tonë. E përtej kësaj, është në kundërshtim edhe me traditën e shqiptarëve.

Qytetarët turq u larguan në rrethana të paqarta e me shumë të panjohura. Ky deportim ka ndodhur në kundërshtim me Ligjin për të huajt.

Neni 92 i këtij ligji, pika 1 thotë: “Republika e Kosovës nuk duhet të dëbojë ose të kthejë refugjatin në asnjë mënyrë në kufijtë e territoreve ku do të kërcënohet jeta apo liria e tij, për arsye të racës, revizionit, përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në ndonjë grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve të tij politike”.

Raportet e ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Human Right Watch dhe Amnesty International, e cilësojnë Turqinë, pra shtetin tonë mik, si vend ku ekziston përndjekja politike dhe tortura, të cilat i kemi përjetuar edhe ne si popull me dekada.

Për të mos folur shumë për Ligjin për të huajt, për shkeljet kushtetuese e për të drejtat e njeriut, mund të themi se ky dëbim i gjashtë qytetarëve turq është skandal i rëndë i atyre që e kanë shkaktuar, përveç nëse argumentohet se është rrezikuar siguria kombëtare.

Nëse argumentohet se është rrezikuar siguria kombëtare, atëherë jemi në rregull, sepse këtu s’ka pardon.

Përderisa kjo nuk vërtetohet, ky deportim është i papranueshëm dhe lë shije të keqe e gjithësesi imazh jo të mirë për Kosovën e me pasoja në rrugën tonë drejt integriteteve euro-atlantike.

Kosova dhe qytetarët e saj duhet ta dinë të vërtetën e këtij deportimi.

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Kolegë të nderuar,

Media,

Me të vërtetë e kam pritur me padurim që t’i përfundojmë si demarkacionin dhe disa probleme të tjera, që ne të fillojmë të diskutojmë në këtë Parlament për zhvillimin ekonomik, po vazhdimisht po ndodh diçka dhe nuk po ndodh.

Ngjarjet e fundit sigurisht që nuk na kanë pëlqyer të gjithëve, por ne si AKR besojmë shumë që ministri i AKR-së ka vepruar në bazë të ligjit, megjithatë bëj ftesë që ne ta themelojmë një grup parlamentar hetues që ta hetojë këtë çështje dhe të zbardhet kjo çështje që nga fillimi i këtij problemi deri në fund.

Të hetohet dhe të zbardhet ky rast, të hetohen të gjitha dikasteret përkatëse, duke marrë parasysh Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Infrastrukturës, AKI-në, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të gjitha dikasteret, ata persona të cilët kanë qenë të implikuar në këtë çështje dhe të vihet kjo çështje në pah se me të vërtetë a është shkelur ligji, apo është zbatuar ligji ashtu siç është.

Sigurisht që është bërë bujë e madhe. Unë besoj që shumëkujt nuk i ka pëlqyer edhe aksioni në veri, por unë mendoj që ka qenë një aksion dhe një veprim i duhur, në mënyrën më të mirë, por sigurisht që të gjithëve nuk u ka ardhur mirë.

Prandaj, kërkoj që kjo të hetohet në mënyrë të pavarur, të zbardhet dhe secili person që ka bërë shkeljen e ligjit, të japë llogari.

Ministri Sefaj ka dhënë dorëheqje në aspektin moral, për arsye se konsiderojmë edhe ne që nuk ka bërë shkelje të ligjit, po ai ka zbatuar ligjin.

Prandaj, shpresoj që të formohet ky grup, të hetohet deri në fund dhe ne t'i zgjidhim këto çështje dhe të dalim një herë e përgjithmonë prej kësaj kauze që çdo ditë po na ndodh diçka dhe e kemi me të vërtetë vështirë që ne të mendojmë për qytetarin e Kosovës, ta zhvillojmë vendin tonë, ta zhvillojmë çështjen ekonomike, e të mos merremi çdo ditë me çështje që nuk na ka hije, për arsye që u bë aq e madhe e ne nuk e dimë me të vërtetë qysh ka ndodhur.

Sigurisht që nuk iu ka gëzuar askush këtij procesi, përkundrazi, unë mendoj që kjo nuk është e mirë, por megjithatë ne duam një hulumtim të pavarur dhe të raportohet këtu në Parlament.

Sot është një debat i gjatë, po është pa thelb, për arse se ne nuk kemi informata, ne kërkojmë diçka, por me të vërtetë duhet bazuar në diçka për t'i kërkuar këto çështje.

Prandaj, sot, të jetë apo jo kryeministri, nuk ndërron asgjë, për arsye që nuk ka informata.

Ne kërkojmë që këto të hetohen një herë e përgjithmonë qysh duhet dhe të zbardhet komplet ky rast dhe të tregohet se a ka qenë i drejtë apo jo. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Abdixhiku e ka fjalën.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, kryesues!

Tash, t'ju them të drejtën, kjo pamja që përball kemi një ministër të minoritetit turk nuk po më pëlqen shumë, sepse kjo betejë s'është mes Parlamentit dhe minoritetit turk në Kosovë dhe më vjen keq që Qeveria e ka lënë vetë, e nuk është betejë as me Republikën e Turqisë, siç e bënë të qartë shumë parafolës.

Do të ishte mirë që së paku sot këtu kryeministri, me zëvendësit e tij, të jetë prezentë dhe ndoshta të na kërkojë falje se njëri prej ministrave të tij, ai i Drejtësisë, na i humbi 10 minuta të plota pa thënë asgjë, duke shpjeguar praktikën e ekstradimit, por duke mos mbajtur as fije përgjegjësie a shpjegimi për rastin e kidnapimit të qytetarëve rezidentë në Kosovë.

Unë mbështes debatin e sotëm jo veç si formë deklarative të deputetëve të këtij Parlamenti, por edhe si obligim moral i institucioneve të Kosovës përball familjeve turke që sot qëndrojnë në Kosovë të humbura. Ne përball njerëzve që u kemi garantuar siguri e mikpritje, kemi dështuar si shtet, ne sot duhet vetëm t'u kërkojmë falje të tillëve.

Edhe mbi të gjitha ky debat duhet të shërbejë edhe si siguri ndaj shumë familjeve të tjera kosovare që mund të jenë të shqetësuara për mënyrën e operimit të institucioneve tona, sepse këto institucione bartin në vete dhe prodhojnë pasiguri dhe besoj se secila familje kosovare është ndier e pasigurt në mënyrën se si Policia dhe Inteligjenca e Kosovës mund të kidnapojë dhe të deportojë individë në vend dhe një kidnapim i tillë mund t'i ndodhë secilit.

Tash unë besoj se ngjarja e kidnapimit dhe deportimit të gjashtë mësuesve, mjekëve turq ka shpërfaqur mënyrën më të dhimbshme të mundshme dy elemente të defektit të institucioneve të Kosovës.

E para, ka shpërfaqur kaosin institucional, në të cilin është Kosova dhe ka shpërfaqur çorientimin tonë shtetëror, rrënimin e vlerave kryesore, mbi të cilat është ndërtuar kjo Republikë.

Në njërin anë, kjo ngjarje ka treguar se Kosova ka shkelur në mënyrën më të rëndë të mundshme të drejtat elementare njerëzore.

Ka shkelur këto të drejta sepse ka kidnapuar nga rruga disa rezidentë me leje qëndrimi dhe nuk u ka dhënë të njëjtëve të drejtën e as të ankimit, por as gjykimin, sepse po dëgjoj sot këtu që të njëjtit qenkan kriminelë e paskan bërë shkelje evazive, por në qoftë se qëndrojnë akuza të tilla, ata do të duhej të ishin gjykuar në institucionet e Kosovës.

Për çdo krim që ndodh në territorin e Kosovës, do të duhej së pari të gjykohej këtu. Por një sjellje e tillë nuk përkon as me norma tona kushtetuese, por edhe më pak me traditën tonë nacionale, të cilës shpesh i referohemi këtu dhe me parimet që kjo shoqëri jona funksionon me Kushtetutë dhe jashtë saj.

Një shkelje e tillë ka një kosto politike për Kosovën, një shkelje e tillë i ka nxitur dy lloj reagimesh.

Të parët ishin institucionet me renome ndërkombëtare, të cilat e cilësonin operacionin shtetëror të Kosovës si shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe deklarime të tilla do të kemi në vazhdimësi dhe qëndrimet e tilla rrezikojnë seriozisht rrugën integruese të Kosovës, përfshirë edhe liberalizimin e vizave.

Dhe, të dytën, goditja më e madhe që i vjen Kosovës është nga deklarata zyrtare e djeshme e Bashkimit Evropian që trajtimin e rastit e shihnin si jashtë çdo parimi të familjes evropiane.

Dhe, kështu, Kosova me një operacion të tillë ka rreshtuar veten në krah të kundërt me shtetet demokratike perëndimore, ka vepruar si asnjë shtet tjetër i Bashkimit Evropian, pa fije nevoje.

Përveç shkeljes elementare të të drejtave të njeriut, rasti në fjalë ka shpërfaqur edhe një jofunksionalitet institucional në Kosovë.

Në fillim të kësaj Qeverie ne kemi argumentuar se një Qeveri me 22 partnerë qeverisës, e me disa qendra vendimmarrëse politike brenda saj, e ka të pamundur të funksionojë si një Qeveri unike, sepse kjo Qeveri, mos harroni, i ka 4-5 kryeministra në vete, secili më autonom dhe i pavarur se tjetri, ka një kryeministër me letra, po i ka edhe katër të tjerë për secilën partner të koalicionit.

Dhe, në fund, ka edhe një kryeministër në Presidencë që herë pas here, e së fundi shpesh merr vendime kryesisht kaotike e lëmshbërëse për Kosovën.

Dhe vazhden lëmsheve të krijuar në Kosovë, ky kryeministër në Presidencë, fjalën e kam për Hashim Thaçin, kishte armiqësuar pa pikë nevoje Qeverinë e vendit të vet me një aleat anëtar të NATO-s, siç është Republika e Turqisë. Pra, Republika e Turqisë mbetet aleat i Kosovës, është anëtar i NATO-s.

Për më tepër, përveç dëmit politik, i njëjti ka bërë shkelje të rënda kushtetuese duke koordinuar dhe urdhëruar kidnapimin e individëve rezidentë në Kosovë dhe këto shkelje kushtetuese besoj që ky Parlament duhet t'i adresojë sa më shpejt.

Dhe, jofunksionaliteti i Qeverisë u pa edhe me mosdijen e kryeministrit në letra, në detyrë, për ngjarjet si këto. Dhe, në qoftë se një kryeministër nuk është i informuar për rrjedhat bazike politike të inteligjencës, nuk është ky një rast i zakonshëm, bëhet fjalë për një përplasje politike të përmasa shumë më të gjera, atëherë ka dy shpjegime: ose nuk e pyet askush këtë kryeministër, ose nuk mund të ushtrojë detyrën e vet. Po për të dyja arsyet nuk mund të mbajë karrigen e kryeministrit, sepse po i kushtojnë Kosovës shumë.

E se ka shumë qendra vendimmarrëse në këtë qeveri, u pa edhe me mosaftësinë e shkarkimit të një ministrit. Pra, u kërkua lirimi i një ministri, më pas u desh të mbahej një mbledhje e një partie të caktuar për të dhënë dorëheqje, e plotësuar kërkesën për lirim, pra s'ka qenë asnjëherë as shkarkim. Dhe, kjo është gjendja kaotike për të cilën kemi folur qysh në fillim, siç ju kishim paralajmëruar në ditën e parë. Ju kishim paralajmëruar edhe për varësinë prej Beogradit, shihni, sot e keni Listën serbe, ju kemi paralajmëruar edhe për varësinë prej Hashim Thaçit dhe shihni kaosin në të cilën ju ka futur.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Ngjarjet si këto përcaktojnë fate shumë më të mëdha se sa një fat të qeverisë, i përcaktojnë fatet e vendeve, të shteteve, të regjioneve dhe janë ngjarje si këto që bëjnë rreshtime të rrezikshme të vendit tonë përball shtyllave fundamentale mbi të cilat është ndërtuar. Ne e kemi për obligim që në këtë Parlament të parandalojmë një rirreshtim të tillë të Kosovës. Ne nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë me skandale akrobatike, vendime kaotike, por duke gjetur rrugën e përbashkët rreth rregullimit të një dëmi të brendshëm, po e them edhe një herë, kjo është problematikë e brendshme e Kosovës dhe neve sot na duhet qartësi shtetërore për orientimin e palëkundur tonin drejt rrugëtimit evropian dhe shmangies nga influencat e jashtme që mund të rrezikojnë këtë rrugëtim.

Ne sot do të duhej të japim shembullin më të mirë të unitetit dhe rolin parlamentar tonin, duke mbështetur rezolutën që Lidhja Demokratike e Kosovës e ka prezantuar dhe nëpërmjet kësaj rezolute të japim jo vetëm qëndrim politik ndaj rreshtimit dhe orientimit të Kosovës, por edhe të marrim masa konkrete, siç është formimi i një komisioni hetimor, i cili më pas do të gjente fakte të rëndësishme për trajtimin e një problematike të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka ministri Jagxhillar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

Vërtet edhe unë, edhe të gjithë jemi këtu vetëm me këtë term. Unë jam si ministër i Administratës Publike që sa vjet dhe këto pesë vjet nuk kam pasur aq thirrje prej gazetarëve për këto çështje se sa jam dhjetë vjet për çështje të Administratës Publike, reformave në Administratën Publike dhe këto çështje dhe në këtë aspekt jam këtu që të jap përgjigje.

Nga ana tjetër, ne kemi krijuar marrëdhënie të mira me Republikën e Turqisë, por institucionale. Tash në shumicën e debateve kërkohet me një lëvizje, me një OJQ të krijojmë bashkëpunimin, të harrojmë shtetin. Jo, ashtu s'bën, nuk mundemi ashtu. Kështu që, këtu jemi edhe unë si ministër, sepse fundi i fundit përfaqësoj komunitetin turk, kam ardhur prej partisë politike, bashkë me deputetët jemi t'i mbrojmë këto marrëdhënie, të mos shkojmë jashtë kontesteve dhe të akuzojmë Republikën e Turqisë. Në këtë aspekt ne jemi të gatshëm dhe të marrim të gjitha vendimet, siç



kam thënë edhe demokratike, edhe politike, sepse fundi i fundit, jemi për një Kosovë evropiane, jemi këtu për komunitetin turk të Kosovës, por gjithashtu jemi edhe për marrëdhëniet e Kosovës dhe Turqisë, që janë prapë në dobi të Republikës së Kosovës.

Në qoftë se ka ndodhur ndonjë keqkuptim, ajo është çështje tjetër, por misioni është ky. Institucionet të veprojmë, të komunikojmë me shtetin dhe në krye të shtetit është sot presidenti Erdogan, dikush tjetër mund të jetë në një periudhë tjetër, por këto janë mënyrat dhe veprimi institucional. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, zoti Abdixhiku e keni fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit!

Unë edhe një herë po theksoj se ministrit do të duhej t'i dilnin në krah i gjithë Kabineti qeveritar, sepse edhe një herë, kjo nuk është përballje në mes të komuniteteve, edhe më pak në mes të dy republikave.

Kjo është çështje e brendshme e Kosovës, sepse si çështje e brendshme e Kosovës ne duhet të përkujdesemi që interesi i Kosovës, në radhë të parë, të vihet përball. Interesi i Kosovës i palëkundur është orientimi proevropian i Kosovës dhe orientimi proevropian i Kosovës nënkupton respektimin e plotë të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, kaq e thjeshtë është narracioni që duhet të ndjekë Kosova. Në këtë Parlament nuk po kërkohet bashkëpunimi me njërën palë ose palën tjetër të Republikës së Turqisë, nuk përzihemi ne në punët e brendshme të Turqisë, ne po mbrojmë interesin tonë nacional dhe interesi nacional është që të ruajmë këtë rrugëtim evropian dhe të ruajmë edhe aleatët tonë, siç është Republika e Turqisë.

Por, në piramidën e prioriteteve ne kërkojmë mbrojtjen e interesave nacionale të Kosovës, po them edhe një herë që është respektimi i të drejtave bazike të njeriut.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë,

Ne të gjithë jemi të shqetësuar për rastin që ndodhi ditët e kaluara, edhe si deputetë, edhe si qytetarë të Republikës së Kosovës. Ka diçka që mund të jetë për debat e që lidhet edhe me emocionet e së kaluarës, të tashmes, të marrëdhënieve tona me një shtet mik, por më shumë se kaq është shqetësimi i ligjit në këtë vend të ri, të brishtë, me institucione që ende lënë për të dëshiruar në sundimin e ligjit dhe me përvoja jo të mëdha.

Pa dyshim se ky shtet i ri përballet edhe me fenomene që ndodhin për herë të parë. Ky është një rast që nuk duhet të na thellojë, edhe ky debat nuk do të duhej të adresohet në njërin prej, duke u bazuar në agjendat tona politike, varësisht nga cila parti politike jemi, meqenëse është bërë debati pavarësisht që nuk kemi informacione të plota, është mirë të trajtohet në mënyrën më të mirë të mundshme, që t'i ndihmojë sqarimit sa më të mirë të këtij rasti që pajtohemi të gjithë, nuk i ka bërë nder ose hije të mirë vendit tonë. Ka edhe diçka që u tha, u përmend me ligjin, edhe nuk është mirë të thuhet vetëm një pjesë e ligjit. Unë i kam takuar kolegët e një komunitetit të politikanëve që jemi marrë me këtë ligj, kur është bërë për herë të parë edhe s'do mend që ligjet nuk i kemi shpikur ne, por janë marrë si model i ligjeve të BE-së.

Dhe, sot më shumë se sa ne deputetë, Qeveria do të ishte mirë t'i transmetonte ligjet edhe të jepte informacione më të plota. Sot një ministër ishte këtu, është mirë që ishte ai, është veç njëra prej agjencive të sundimit të ligjit, është fatkeqësi që sot s'e kemi ministrin e Brendshëm, i cili e ka pasur, edhe si Ministri e Brendshme ka për detyrë ta zbatojë këtë ligj, pra Ligjin për të huajt.

Ne nuk kemi faj tash pse kjo punë, kjo temë ka rënë me Turqinë, me të cilin kemi po them edhe një herë, marrëdhënie të mira dhe kemi pasur. Turqia ka pasur pashallarë, kryetarë e do të ketë edhe tutje kryetarë, jam i sigurt që turqit në Kosovë e qindra-mijëra shqiptarë në Turqi do të jenë garanci e mirë e ruajtjes së marrëdhënieve tona të mira. Por, ne më shumë se këto emocione, kemi emocione për të ardhmen tonë, të fëmijëve tonë dhe nuk guxojmë të bëjmë gabime. Por, sot ne ende nuk kemi informacione të bollshme. U tha që u shkel ligji, mund të thuhet, porse është një pikë e ligjit që thotë se dyshimi i bazuar se i huaji në vendin e origjinës apo në një vend tjetër do të dënohet me vdekje a do të ndëshkohet brutalisht, e tjerë, e tjerë, ky është shqetësimi për ne. Por, ligji ynë që është i pranuar ose i koordinuar me legjislacionin e BE-së, e ka edhe një nen tjetër, ku thuhet që përjashtimisht edhe kjo mund të bëhet nëse konsiderohet se të njëjtit kanë rrezikuar rendin dhe sigurinë publike, si dhe përbëjnë një kërcënim për sigurinë shtetërore, kombëtare.

Pra, ligji është kështu, por ne nuk e kemi ende, pra krejt kjo shpjegon se kemi të bëjmë me një dokument, deri tash konfidencial, i AKI-së, i cili paska konsideruar ose paska konstatuar që rrezikohet siguria kombëtare dhe i njëjti dokument ka mundësuar një urdhër të Ministria e Brendshme, e cila i ka dëbuar, pra edhe emërtimin "dëbim" e kemi në ligj. Pra, këta janë dëbuar në përputhje me ligjin tonë, e për shkak të një konstatimi që ne ende nuk e dimë se nuk i kemi informacionet. Ajo që unë po mendoj që duhet ta kemi, pavarësisht që u tha këtu botërisht që nuk ka pasur një koordinim, Qeveria nuk ka pasur, kryeministri nuk ka pasur njohuri, doli edhe kryetari i Kuvendit, është mirë që bile të paktën këtë hapin tjetër, qoftë Këshilli për Siguri Kombëtare, qoftë drejtuesit e institucioneve politike të sigurojnë, për sa është e mundshme nga këto dokumente konfidenciale, të na sigurojnë informacione shtesë, në mënyrë që ne dhe qytetarët e Kosovës ta kenë të qartë këtë pozicion, këtë veprim që është bërë nga institucionet tona dhe kjo mendoj që duhet të kërkohet.

Ne vetëm se po bëjmë debate politike, po shprehim hamendje, nuk kemi informacione të plota, madje edhe debati shkon herë me relacionin tonë me Turqinë, ose presidentin, ose një organizatë atje, për çka ne, në fakt, më shumë se sa krejt këto interesa, i kemi interesat e vendit tonë dhe të orientimit të vendit tonë kah Perëndimi.

Pra, ajo që mendoj që duhet të ndodhë së shpejti është që ne të kemi informacione më të mëdha, më të mira, më të shpejta, në mënyrë që të mos lejojmë divergjenca në shoqërinë tonë dhe aq më tepër të bëjmë dallime sikur që janë në një shtet tjetër, për shkak të një veprimi ose të një operacioni të shtetit tonë, aq më tepër këto dallime nuk duhet të ndodhin në Parlamentin tonë.

Pasi t'i kemi këto informata, mendoj që duhet të ketë hetime të plota për secilin, ne sot nuk i kemi informacionet e ministrit të Brendshëm, kemi dëgjuar lëvdata, ky ministër iu ka përgjigj Parlamentit gjithmonë, ka qenë një pasqyrë e mirë e një dikasteri, por përgjegjësitë qeveritare shkojnë përtej këtyre, një javë përpara e ka ditur ministri i Brendshëm. Një javë përpara e ka pasur një dokument në dorë për një operacion që do të ndodhë, ky dokument ka mbetur konfidencial, kjo shkon përtej një dokumenti të veçantë. Ne sot nuk kemi informacione që na tregojnë që ka pasur përtej atyre që tha ministri i Drejtësisë. Ka pasur dëbime edhe më herët. Lufta kundër terrorizmit pas 11 shtatorit ka krijuar aleancën më të fuqishme në botë të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për luftimin e terrorizmit. Por, a jemi këtu? A është ky operacion kështu? A kemi të bëjmë me një operacion të tillë? A ndonjë operacion tjetër, na duhen informacione, njerëzit kompetentë të sundimit të ligjit në vend duhet të na i japin, në mënyrë që ne të mos biem në lajthitje.

Pra, unë pres që ditët në vijim liderët, përgjegjësit e vendit të na i japin informacione, në mënyrë që qytetarët, edhe ne, të mos bëjmë ndarje që na duhen më së paku në këtë moment, në këtë kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me gjasë janë thënë shumë gjëra që edhe unë kam pasur ndërmend t'i përmend, po çështja siç duket është e njëjtë dhe dalëngadalë po i vjen fundi, domethënë krejt argumenteve dhe fakteve që i kemi ne.

Megjithatë, unë do të lidhem në 2-3 gjëra që ndoshta nuk u përmendën deri tani. Puna e parë që po del këtu, që po e shohim, nga ministri i Drejtësisë e kuptuam që nuk është fjala për ekstradim. Edhe fjala dëbim, siç duket, edhe nëse është fjala për dëbim, kemi të bëjmë me një veprim, dëbim të paligjshëm, së paku bazuar në krejt dokumentet mbi të cilat është ndërtuar shteti ynë. Natyrisht unë pajtohem me shumë kolegë këtu, pajtohem edhe me kërkesën e deputetëve për krijimin e një komisioni hetimor parlamentar, i cili nuk do të kishte asnjë pengesë, e siç duket,

pengesa mund të ketë derisa një numër i njerëzve ende janë në fuqi, edhe kanë fuqi ekzekutive, e ky komision parlamentar të mos linte asnjë person zyrtar, asnjë hallkë institucionale pa e hetuar, duke filluar nga shumë i përfoluri presidenti i Kosovës dhe duke shkuar deri te hallka e fundit, edhe hallka e fundit mund të jenë personat që e kanë kryer aktin dhe tash ende nuk u emërtua a është arrestim, a është ndalim, a është kidnapim, sepse ende nuk po dihet kush saktësisht e ka bërë këtë punë.

Unë pajtohem me shqetësimin e shumë kolegëve deputetë, se për herë të parë në vendin tim e kam ndier veten të pasigurt në çdo veprim apo në çdo lëvizje timen në vendin tim, sepse nuk e di çka do të ngjajë dhe kush do të japë përgjegjësi, apo çfarë përgjegjësie kanë organet e rendit, kur secili, njëri pas tjetrit, e heqin përgjegjësinë, duke thënë se ose nuk di, ose nuk është imja, ose është e dikujt tjetër. Nga krejt analiza që u është bërë ligjeve, tash po e them, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, përfolët shumë herë Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, a ka mundur, si ka mundur, cilat informata i ka. Po, një duhet ta kemi parasysh, neni 2, pika 5, thotë shprehimisht: “AKI respekton parimet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventës Ndërkombëtare, Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe parimeve të tjera relevante të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura ndërkombëtarisht”.

Do të thotë, sido që të ketë vepruar AKI-ja, nuk ka guxuar të dalë nga këto parime, të cilat i ka të theksuara shprehimisht në ligjin e vet. Edhe Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, në asnjë moment nuk del jashtë normave të përcaktuara në ligjet themelore dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për ndryshe, çdo ligj, çdo normë juridike në Republikën e Kosovës duhet të jetë e mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e këtu jo vetëm Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale, por është edhe Ligji për të huajt Nr. 04/L-219, edhe Ligji për AKI-në, edhe të gjitha ligjet e tjera që mund të përmenden, edhe Kodi Civil, edhe Kodi Penal e gjithçka tjetër.

Tash, duke i analizuar të gjitha këto norma juridike shihet qartë se ky veprim, për të cilin ende nuk po e dimë kush e ka kryer, kush e ka ekzekutuar në terren, ende nuk po e dimë, unë ende nuk kam dëgjuar ndonjë informatë a kanë qenë ata policë të Republikës së Kosovës, pjesëtarë të AKI-së, edhe pse nuk kanë detyra ekzekutive e kompetenca, a kanë qenë vërtet, si del në mjetet e informimit, pjesëtarë të Agjencisë së Inteligjencës turke? Këtë nuk e di askush, nuk e di askush ku janë dërguar ata njerëz, nga kush janë trajtuar dhe si kanë udhëtuar në Republikën e Turqisë?

Unë i kuptoj shqetësimet e kolegëve turq, po këtu nuk kemi të bëjmë me raportet Turqi-Kosovë, as me miqësinë, as me vëllazërinë, apo sido që ta quajmë, të njerëzve të Kosovës me njerëzit e Turqisë, sepse ne kemi edhe familjarë në Turqi, po kemi të bëjmë me veprime shtetërore, të institucioneve shtetërore që shkelin në mënyrë brutale të gjitha konventat e nënshkruara, po them të gjitha konventat e nënshkruara nga Republika e Turqisë dhe nga Republika e Kosovës. E dy

konventat kryesore që shkelen në këtë rast janë: një, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që gjendet si dokument themeltar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës dhe Konventa Kundër Torturës.

Meqenëse Republika e Turqisë është anëtare e Këshillit të Evropës, këto konventa i ka nënshkruar edhe Republika e Turqisë, dhe në asnjë moment nuk mund t'i ikë përgjegjësisë ligjore nëse vërtet Republika e Turqisë, përmes formave të ndryshme ka bërë që njerëzit me leje të qëndrimit, kushdo qofshin ata, të rregullt në Republikën e Kosovës, të trajtohen në atë mënyrë, sepse ne nuk e dimë a janë arrestuar, ndaluar, kidnapuar dhe nga kush saktësisht. Ne kemi edhe marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi ekstradimin, të cilën e ka ratifikuar Republika e Kosovës, po ende nuk e ka ratifikuar Republika e Turqisë, edhe në gjithë marrëveshjen askund nuk është, në asnjë moment nuk përmendet se veprimet e tilla janë të lejueshme. Përkundrazi, Kosova dhe Turqia kanë nënshkruar një marrëveshje, e cila përjashton ekstradimin për veprat, të cilat konsiderohen vepra penale në bazë të Ligjit ushtarak nëse thirren në kundërshtimin ushtarak të Republikës së Turqisë.

Po ashtu, ekstradimi nuk lejohet për vepra penale, për të cilën është paraqitur nga pala, konsiderohet si vepër penale politike ose vepër që është e ndërlidhur me vepër penale politike. Këtë e kanë nënshkruar të dy shtetet. Ne e kemi edhe Ligjin Nr. 06/ L-458 për mbrojtjen ndërkombëtare të të huajve në Turqi, që është edhe në këtë ligj, po ashtu në asnjë normë të këtij ligji nuk lejohet deportimi, largimi i njerëzve nga Republika e Turqisë pa vendime gjyqësore. Domethënë, nuk ka asnjë klauzolë të asnjë shteti, as të Republikës së Turqisë, as të Kosovës që lejon një veprim të tillë me personat që kanë leje qëndrimi në Republikën e Kosovës apo të Turqisë. Tash ne e kemi edhe një trajtim tjetër, thuhet se ka mundësi që ka ndonjë informatë AKI-ja. Ne duhet ta kemi parasysh, në Republikën e Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin kundër Italisë, në vitin 2008, ka vendosur shprehimisht, duke u thirrur në nenin 3, protokollin 7, të Konventës në nenin 1 se nuk është e lejueshme, absolutisht, në asnjë rrethanë kthimi, dëbimi, largimi apo ekstradimi i personave, të cilëve u rrezikohet jeta dhe rrezikohen që t'i nënshtrohen torturës apo trajtimit mizor edhe të padinjitetshëm nga organet e shtetit që e kërkuar atë. Ne kemi një shkelje ligjore që duhet të trajtohet sipas ligjeve në fuqi, sipas Kushtetutës. Unë edhe një herë bëj ftesë që Komisioni hetimor parlamentar të krijohet sa më parë që është e mundur nga të gjitha subjektet politike, nën udhëheqjen e opozitës dhe të trajtohen të gjithë personat dhe hallkat e hierarkisë shtetërore...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj. S'është! Atëherë, fjalën e ka Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se u thanë shumë gjëra lidhur me atë që u ka ndodhur qytetarëve me shtetësi turke që ishin në Kosovë dhe kishin leje qëndrimi të rregullt. Po shihet qartë se ajo çfarë ka ndodhur është një rrëmbim real, qytetarët janë rrëmbyer, vetëm na ka mbetur të shohim edhe skenat se si janë rrëmbyer, me thes në kokë, apo në çfarë mënyre.

Qartë shihet se janë shkelur të drejtat e njeriut dhe nuk janë përfillur ligjet e aplikueshme në vend, por ajo që mendoj se në këtë Parlament nuk duhet të bëhet temë, është se nuk duhet ta ngremë ne çështjen se çka përfaqësojnë ata qytetarë dhe nuk duhet të bëhemi pjesë e politikave dhe përplasjeve politike në Republikën e Turqisë. Por, ne duhet ta vëmë theksin e veçantë mbi rrugëtimin, ecjen e shtetit tonë. Jemi republikë demokratike, apo jemi republikë me institucione të cilat nuk e dimë kujt i përgjigjen, kujt i japin llogari dhe në dorë të kujt janë.

U ngrehën tema nga deputetët nga më të ndryshmet, e njëra që më bëri përshtypje është ajo se disa kolegë deputetë po shprehin rezervat e tyre apo mospajtimin pse kryeministri nuk ka qenë i informuar, nuk kanë pasur informacion zëvendëskryeministrat, Qeveria në përgjithësi, apo edhe kryetari i Kuvendit. Mendoj se për herë të parë e kemi parë një qëndrim dinjitoz, në këtë rast do të thosha, dhe real të kryeministrit, sepse vendi dhe qytetarët kanë nevojë ta dinë të vërtetën. E vërteta është kjo, se kryeministri nuk ka pasur informacion për atë se çfarë ka ndodhur dhe si ka ndodhur. Dhe, është mirë dhe duhet përshëndetur për qëndrimin e tij të qartë, real dhe të vërtetë.

Nuk duhet fshehur, më mirë është të jesh real dhe të thuash se nuk kemi ditur asgjë, sesa të bëhesh sikur po di për gjëra që nuk i ke në dorë, nuk je i informuar dhe nuk mund t'i menaxhosh. Po, komision hetimor duhet të ketë për dy arsye, për ta adresuar çështjen dhe për ta mbështetur Qeverinë duhet të ketë një komision parlamentar hetimor. Po shihet që Qeveria nuk po mund të përballet vetë me situata dhe me struktura, me eksponentë të sigurisë dhe të fushave të caktuara brenda institucioneve të vendit.

Kolegët deputetë nga LDK-ja e ngrehën një temë se gjithë mekanizmin institucional po e drejton Hashim Thaçi. Kanë harruar sikur këta janë ata që e kanë ndihmuar të vijë në pozitën e presidentit, duke menduar për kalkulime politike, që ta zhvendosin nga PDK-ja apo nga Qeveria dhe harruan se ia dhanë gjithë pushtetin në dorë. Po, të nderuar kolegë të LDK-së, ju jeni ata që ia keni dhënë, së bashku me ata që e kanë votuar presidentin, këtë fuqi.

Prandaj, mos u bëni sikur nuk jeni pjesë e fajit. Të gjithë kemi faj që kemi arritur deri në këtë gjendje dhe e kemi koncentruar gjithë shtetin në dorë të një njeriu. Ne mendojmë dhe e

mbështetim plotësisht hapin për ta formuar një komision parlamentar hetimor dhe për t'i mbështetur deri në fund vendimet e Qeverisë dhe të kryeministrit Haradinaj. Mendoj se Parlamenti në këtë rast duhet ta mbështesë fuqishëm qëndrimin dhe aktivitetin e kryeministrit Haradinaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju qeveritarë,

Është fatkeqësi që për shkak të aferave në vazhdimësi të strukturave shtetërore, ne si deputetë nuk po mund t'i përmbushim agjendat tona që i bien Kuvendit. Fatkeqësia më e madhe është që edhe pse në Kuvend ne po debatojmë për afera që zyrtarët shtetërorë po i bëjnë, Qeveria, Prokuroria dhe Gjyqësori po vendnumërojnë, nuk po ndërmarrin masa në kuadër të kompetencave dhe aferat gjithnjë po shtohen, gjithnjë po i dëmtojnë themelet e brishta të shtetësisë së Kosovës.

Fatkeqësisht, në amullinë e shkaktuar nga struktura shtetërore, nga afera e fundit e kidnapimit të shtetasve turq, dje e pashë këtu, ishte tërheqja e njohjes nga një shtet mik, Gurundi. Fatkeqësia më e madhe e jona si shtet në formim dhe konsolidim e sipër është fakti se këto afere, që po e rrënojnë imazhin e Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, kanë filluar të shndërrohen në rutinë. Ne kemi pasur raste të dëgjojmë personalitete të afërta me Qeverinë, që publikisht kanë fyer ambasadorë të shteteve të respektuara dhe zyrtarisht nga kryeministri e presidenti, as që kemi parë ndonjë reagim. Kemi pasur raste kur deputetët e këtij Parlamenti kanë fyer po ashtu personalitete mike dhe nuk kemi pasur reagime të nevojshme. Kemi pasur edhe raste kur qeveritarë, ministra e zëvendësministra, kur janë fërkuar apo kanë rënë ndesh me ligjin, i kemi pasur arsyetimet e kryeministrit se çështje të tilla janë çështje kanunore, që ai dëshiron t'i respektojë si të tilla.

Në fakt, e kemi një kryeministër i cili nuk ia di rendin as kanunit e as ligjit. Po t'ia dinte rendin, punët do të shkonin ndryshe. S'ka sesi të mos ndodhë skandali tjetër, ai i kidnapimit të mësuesve shtetas turq në pikë të ditës dhe pastaj të dëgjojmë presidentin e kryeministrin e këtij vendi, po ashtu edhe vetë kryeparlamentarin duke deklaruar se ne nuk kanë ditur asgjë.

Të nderuar qytetarë dhe ju të pranishëm,

Kjo është një deklaratë, e cila e frikëson çdo qytetar të Republikës së Kosovës. Kjo është deklaratë, e cila e frikëson çdo njeri që ia mësyn Kosovës, qoftë për investime, qoftë për forma tjera të veprimit. Prandaj, si e tillë natyrisht se e kërkon edhe përgjegjësinë e vet.

Shtetasit turq që ishin këtu kishin leje qëndrimi nga shteti i Kosovës në bazë të ligjeve që e rregullojnë qëndrimin e të huajve në shtetin tonë. Këta shtetas turq nuk ishin kriminelë të

rëndomtë, ishin profesorë. Nuk ka, të paktën, edhe një të dhënë nga organet zyrtare se ata kanë kryer ndonjë punë që flet për kriminalitetin që u vishet atyre. Ne deri tani e kemi vetëm një deklaram të presidentit, se AKI-ja i ka cilësuar si persona me rrezik për sigurinë nacionale të vendit dhe asgjë më shumë. Proceduralisht, kjo çështje është dashur të ndiqet ndryshe, nëse këta e paskan rrezikuar sigurinë nacionale, pasi Agjencia e Inteligjencës nuk ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit.

Zhytja në veprimtari që e rrezikojnë sigurinë nacionale është vepër penale dhe nëse vepra penale është bërë në Kosovë dhe kundër saj, këtyre personave gjyqi është dashur t'u bëhet po ashtu në Kosovë, nga drejtësia kosovare. Ajo që është më e shëmtuar në këtë aferë nga struktura shtetërore të Kosovës është fakti se këtyre personave nuk iu mundësua mbrojtja ligjore, nuk iu mundësua të komunikonin me përfaqësuesit ligjorë të tyre, nuk iu mundësua të dalin para gjykatës, të dëshmojnë pafajësinë e tyre për shkeljen e ligjeve, për të cilat pretendohet. Ky akt e skandalizon këtë çështje, sepse shkel me të dyja këmbë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, të cilat e rregullojnë materien e lirive dhe të të drejtave themelore të njeriut, ku dua ta vë theksin edhe gjatë fjalës sime.

Ky akt i shkel të gjitha konventat ndërkombëtare, që ne si shtet i kemi ratifikuar dhe inkorporuar në kuadër të ligjeve tona, e të cilat e rregullojnë materien e lirive dhe të të drejtave të njeriut. Lidhur me këtë, të nderuar deputetë, duke pasur parasysh ndjeshmërinë, kompleksitetin e rastit dhe konfuzionin e autoriteteve mbi linjën e përgjegjësisë, Avokati i Popullit ka vendosur të hapë rast "ex officio" për t'i hetuar në detaje veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike. Sidoqoftë, në këtë fazë, Institucioni i Avokatit të Popullit pohon se veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut të zbatueshme në sistemin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës.

Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe protokollet e saj saktësojnë qartë garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve, citoj Avokatin e Popullit. Në kuptim të nenit 3, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu si edhe parimi themelor i moskthimit sipas Konventës për Refugjatë, e vitit 1951, përgjegjësia bie tek autoritetet shtetërore kompetente lidhur me situatën e krijuar. Ky akt e vë në pikëpyetje perspektivën evropiane të Kosovës dhe të integriteteve euroatlantike, që është synim i vetë Republikës së Kosovës. Ky akt vë pikëpyetje të mëdha para shteteve që kanë pasur hamendje të bëjnë njohjen e shtetit të Kosovës dhe, gjithashtu, vë pikëpyetje të mëdha para shteteve që e kanë njohur Kosovën, për të marrë vendime të ngjashme, siç ishte ajo e Gurundit.

Ky akt nuk rezulton të jetë vetëm shkelje e procedurës, por është shumë më shumë, ky është një sabotim i Kosovës për konsolidim të shtetësisë brenda saj dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të saj me shtetet tjera. Ata që janë pjesë e këtij skenari, natyrisht se duhet t'i përgjigjen drejtësisë dhe duhet të dalin para gjyqit. Komisioni Hetimor që do të nxirret si përfundim, do të na thotë



më shumë për atë që duhet ditur të gjithë ne dhe qytetarët e Republikës. Duhet ditur kë e ka president ky vend, para se të publikohen konto-numrat dhe xhirrologaritë e njerëzve shtetas turq, duhet ta dinë shtetasit e Republikës së Kosovës sa janë të pasuruar autoritetet të cilat mendojnë dhe pretendojnë të udhëheqin me këtë vend. Duhet ditur qytetarët e Republikës kë e kanë po ashtu kryeministër dhe duhet ditur se derisa ata janë të tillë Kosova dhe Evropa janë larg njëra-tjetrës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ajo çfarë ka ndodhur më 29 mars është sulm ndaj sistemit kushtetues juridik nga vetë ata që duhet ta mbrojnë atë, si dhe interesave nacionale të vendit tonë.

Debati i sotëm është shumë mirë që po mbahet, por, sipas mendimit tim, është i vonshëm, posaçërisht kur ke parasysh faktin që përgjegjësit e institucioneve po refuzojnë të raportojnë para komisioneve funksionale të këtij Parlamenti, si për shembull drejtori i AKI-së para Komisionit për Mbikëqyrje të AKI-së, prandaj edhe na duhet Komisioni Hetimor.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se s'ka pasur shkelje ligjore, por vetëm thyerje të hierarkisë institucionale. Gabim, zoti kryeministër! Përveç thyerjes së hierarkisë, për të cilën edhe mund të pajtohem, ka pasur edhe shkelje të ligjit, si për shembull të nenit 6, pika 3, në Ligjin për të huajt, ku thuhet se i huaji, të cilit i revokohet leja e qëndrimit ka të drejtë ankese në gjykatën kompetente. Kjo e drejtë u është mohuar 6 shtetasve turq me qëndrim të rregullt në vendin tonë.

Rasti me gjashtë shtetasit turq nuk është dëbim apo deportim, siç po thuhet këtu, por është ekstradim i kundërligjshëm dhe asgjë më pak. Gjashtë shtetas turq me qëndrim ilegal në vendin tonë janë kidnapuar në mes të ditës dhe duarlidhur ilegalisht i janë dorëzuar një shërbimi sekret të huaj. Deportim do të ishte po qe se pas verifikimeve të nevojshme dhe të bazuara këtyre shtetasve do t'u revokohej leja e qëndrimit dhe pastaj do të urdhëroheshin ta lëshonin territorin e Kosovës apo do të dërgoheshin deri në pikën më të afërt kufitare, qoftë në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi apo edhe Serbi.

Por, jo! Ata arrestohen dhe duarlidhur i dorëzohen një shteti të huaj, i cili i përndjek ata. Nëse çfarë ka ndodhur është e ligjshme, atëherë çfarë na duhen ligjet që specifikojnë ekstradimin apo marrëveshjet bilaterale për ekstradim? Sipas kësaj, krejt çfarë duhet të bëhet është që në rastet e ngjashme, AKI-ja e shpall dikë të rrezikshëm, ia vëmë prangat dhe e dorëzojmë. Bile, mund edhe kerozinën t'ua paguajmë, pse seanca gjyqësore, pse avokatë, pse shpenzime, pse procedura, pse ligje...?

Janë apo jo fajtorë ata gjashtë shtetas turq në raport me ligjet në Turqi, kjo nuk është fare çështja. Pyetja e vërtetë është, a po i zbatojnë ligjet tona vetë institucionet tona, që duhet të jenë garant i ligjshmërisë. Marrëdhëniet e mira bilaterale me Turqinë janë jashtëzakonisht të rëndësishme, prandaj ne duhet t'i ruajmë ato. Por, kush po i rrezikon ato? Janë institucionet tona që shkelin ligjet tona dhe e bëjnë bashkëpjesëmarrës në këto ligje edhe vetë shtetin turk.

Tash, tek përgjegjësia, duke parë se prej hapit të parë deri në fund ka pasur shkelje ligjore, ne duhet hetuar: prej policit që e ka ndalur veturën, siç e kemi parë në disa incizime nëpër televizione, deri te drejtori i Policisë; prej ministrit të Punëve të Brendshme deri te kryeministri; prej zyrtarit të AKI-së deri te drejtori i AKI-së, edhe vetë presidenti i Kosovës, si autoriteti më i lartë i tyre. Dhe, jo vetëm dorëheqje e shkarkime, por ndjekje penale për ata që e kanë shkelur ligjin e sa më lart në hierarki, përgjegjësi më të madhe për ta.

Skandalet e njëpasnjëshme që kulmuan me këtë, për të cilin po debatojmë sot, po na sjellin në situatën kur partnerët tanë në bazë të së drejtës ndërkombëtare Kosova mund të cilësohet si shtet i papërgjegjshëm, pas së cilës ti nuk je as aktor, as faktor në marrëdhënie, qoftë bilaterale, po ashtu edhe ato multilaterale. E kur shkel kushtetutë, ligje e konventa ndërkombëtare është çështje kohe, kur ti e merr këtë cilësim, i cili është edhe sanksioni më i rëndë në marrëdhëniet ndërkombëtare, e të mos flasim për integritet në institucionet ndërkombëtare. Deri në skandalin e ardhshëm apo rënien e Qeverisë! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Kur po fliste nënkryetarja turke parëz, e pashë që gjysma e deputetëve nuk i vënin kufjet, se po dinin turqisht. Që i bie, shumë mirë, domethënë qytetarët turq nuk kanë nevojë asnjë shqetësim ta kenë në Kosovë. Përkundrazi, duhet të ndihen të lirë dhe të barabartë me të gjithë ne që jetojmë këtu.

Këtu tema kryesore është a janë shkelur procedurat, e duket që po. Veprimet janë marrë të menjëhershme, duke kërkuar lirim nga detyra të ministrit të Punëve të Brendshme dhe të shefit të AKI-së. Por, gjatë diskutimeve po shoh që shumë deputetë këtu paskan pasur informata, ose i kanë. Atëherë, pse u dashka ta krijojmë edhe një komision hetimor? E dëgjoja parëz Mialim Zekën, të gjitha po i dinte. Domethënë, të mos flasim për të tjerët.

I pashë disa deputetë këtu, u ka mbetur merak që s'kanë arritur të jenë deputetë në të kaluarën për ta votuar Hashim Thaçin, shumë u lagej goja kur ia përmendin emrin. Hajt, bre se të vjen rendi prapë, bën vaki mandatin tjetër, mos u ngutni!

Pajtohemi plotësisht për ta krijuar komisionin hetimor, është i domosdoshëm dhe vota jonë është për, por nëse i shikojmë, nuk qenka Avdullahu këtu, tri pikat e fundit dhe të parafundit, ato janë paragjyquese dhe mendoj se janë jo të rregullta njëra me tjetrën. Prandaj, do të kërkoja t'i harmonizoni këto dy pika dhe ta kemi një unitet të përbashkët kur i votojmë, sepse të gjithë pajtohemi që ka pasur një padrejtësi ndaj këtyre gjashtë qytetarëve turq, por ju si deputetë me siguri e dini. Nëse s'e dini, edhe një fakt po jua them, 312 qytetarë të shteteve të ndryshme janë deportuar në formën e njëjtë nga Republika e Kosovës. Kurrë kush nuk e ka çelur gojën. Prandaj, në rastin konkret, ne e dimë çfarë gjendje është në raport me Turqinë. Nuk ka asnjë tendencë askush për t'i prishur raportet me shtetin turk, përkundrazi kemi respekt, na ka njohur ndër shtetet e para, e ka ndihmuar Kosovën gjatë luftës, pas luftës vazhdon ta ndihmojë, e falënderojmë shumë.

Pse jemi të shqetësuar sot për fatin e tyre, çka do t'u ndodhë atyre qytetarëve, kështu mendoj unë. Prandaj, është mirë të shikohet me saktësi komisioni hetimor, kurdo që formohet, të shohë specifikisht nëse janë respektuar procedurat, në çfarë gjendje jemi. Është shumë e vërtetë që populli i Kosovës nuk e ndërron orientimin propecedimor, pavarësisht që dikush mund të ketë ide të ndryshme. Kosova është e përcaktuar, është e vendosur dhe s'ka fuqi që mund t'ia ndërrojë drejtimin, por të shohim çfarë procedurash janë shkelur, kush janë përgjegjësit dhe t'i nxjerrim para përgjegjësisë, se s'kemi çka filozofojmë shumë. Në fund të ditës, deputetët nuk janë hetues. Deputetët duhet të kërkojnë llogari prej institucioneve përkatëse. Secili përgjegjës i atij institucioni duhet të përgjigjet kur të vijë koha, në bazë të atyre të gjeturave që i sjell ky komision hetimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mungesa e kryeministrit dhe e kryetarit të Kuvendit sot këtu para nesh thotë se atë ditë kur ka ndodhur rasti janë arsyetuar se nuk kanë ditur asnjë gjë për këtë punë, ndërsa sot po i ikin debatit dhe përgjegjësisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo është vërtet shumë shqetësuese.

Ne, të zgjedhurit e popullit, pas këtij skandali të paparashikuar, vijmë këtu për t'i pyetur çka ka ndodhur dhe përveç asaj se ata kanë qenë organizatorët e gjithë kësaj ngjarjeje, ata sot nuk vijnë këtu që t'u përgjigjen shqetësimeve tona. Megjithatë, unë po u drejtohem qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe natyrisht kolegëve të mi deputetë.

Më 29 mars 2018, kushtetutshmëria dhe sovraniteti i Kosovës u dhunuan. Rasti i kidnapimit të gjashtë qytetarëve turq dhe trafikimit të tyre jashtë çdo norme ligjore demokratike, ndërkombëtare e vendore, është i papranueshëm dhe i sanksionuar me ligj. Ky është veprimi më i qartë për qytetarët e këtij vendi, se çfarë liderësh institucionalë ka momentalisht Kosova. Ju jeni

në gjendje ta bëni pazar Kosovën për lëkurën dhe pushtetin tuaj. Ju përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, presidenti, kryeministri dhe kryeparlamentari të nesërmen e kësaj ngjarjeje u deklaruat pa fije turpi se nuk dini asgjë për këtë aksion. Skandalozel!

Për t'i besuar deklaramit tuaj është dashur të pasojë dorëheqja e të treve. Një veprim të tillë nuk e bëtë, sepse gënjet, sepse për ju e rëndësishme është të jeni në pushtet, qoftë edhe kur e rrezikoni sovranitetin e vendit. Ky debat i sotëm në Parlamentin e Republikës së Kosovës duhet të ketë për qëllim që ju nëpërmjet pyetjeve tona t'i përgjigjeni këtij populli dhe të përfundoni para drejtësisë. Pse po e gënjeni popullin e Kosovës se ju nuk keni qenë të njoftuar, kur një javë para se të kidnapohen gjashtë qytetarë turq, Këshilli Kombëtar i Sigurimit të Kosovës e ka mbajtur takimin dhe është shqyrtuar kërkesa e AKI-së për tërheqjen e lejeqëndrimit të tyre, por Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk e ka aprovuar një kërkesë të tillë?

Ju e keni pasur porosinë edhe nga BE-ja që një hap i tillë të mos ndërmerret. Pse nuk i filluat procedurat e rregullta ligjore për dëbimin e tyre, pasi, sipas Hashim Thaçit, tash këta qytetarë turq paskan qenë të rrezikshëm për sigurinë e vendit tonë. Kush i solli këto shkolla turke në Kosovë? A janë shkolluar fëmijët tuaj nëpër këto shkolla të terroristëve dhe të rrezikut kombëtar për ne?

Shtrohet pyetja, kush nga ju, apo të tretë së bashku dhe për çfarë çmimi e bëtë këtë skandal? Nëse ju liderët e institucioneve tona nuk morët miliona për këtë veprim, atëherë pse nuk guxuat ta pranoni publikisht grushtshtetin që ndodhi nga Erdogani në Kosovë, i përgatitur dhe i ndihmuar nga Hashim Thaçi dhe me këtë rast shihet se kryeministri i vendit nuk pyetet, e as nuk njoftohet për asgjë në Kosovë.

Veprimi i kryeministrit për lirim nga detyra të drejtorit të AKI-së dhe ministrit të Punëve të Brendshme, e që, sipas analizave, ministri i Punëve të Brendshme e ka zbatuar ligjin, pse nuk u shkarkua edhe drejtori i Policisë, i cili është dashur të japë përgjegjësi se në bazë të cilit ligj Policia e Kosovës bashkëpunon dhe vepron në ekzekutim, në kapje të individëve bashkë me trupat e inteligjencës turke, apo çfarëdo shteti tjetër?

Në këtë skandal ka shumë gjëra për t'u hetuar, shkelje ligjore dhe kushtetuese, shkelje të normave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, korrupsioni dhe krimi i organizuar, orientimi ideologjik i Kosovës, orientimi kah Lindja apo Perëndimi, e të tjera... Po, kush jeni ju që guxoni ta vëni në pyetje qenien dhe sovranitetin e këtij vendi? Vetëm njerëzit faqezinj si ju mund ta ndajnë fëmijën nga prindërit për përfitimet tuaja personale. Ju nuk keni etikë morale, as politike. Ju nuk i respektoni as ligjet, e as traditat tona kombëtare. Ju i shkelni ato në mënyrën më bizare të mundshme. Shqiptarët nuk të presin në besë kështu si ju. Ne krenohemi si komb me virtytet tona, jemi kombi i vetëm që në Luftën e Dytë Botërore kemi strehuar hebrenj, jemi kombi më i persekutuar në Evropë, i shpërndarë në tërë botën nga dhuna ideologjike fashiste e Serbisë dhe ju

të tre personalisht, para luftës së fundit në Kosovë, ishit azil nëpër shtetet e Evropës. Edhe ju pas lufte disa herë u ndaluar nëpër shtetet demokratike me kërkesë të Serbisë për të ju ekstraduar në Serbi dhe asnjë shtet demokratik nuk e bëri një gjë të tillë, ndërsa ju e bëtë, sepse jeni të ligj.

Kosova nuk e ka emrin Hashim, Ramush e as Kadri. Kosova nuk ua ka asnjë borxh. Mjaft më e zhvatët dhe e turpëruat këtë vend e këtë popull. Ju duhet të largoheni nga politika, t'ia çlironi frymën këtij vendi, sepse na keni ngulfatur. Ju duhet të jepni përgjegjësi para drejtësisë, por jo nëpërmjet veglës suaj, Aleksandër Lumezi, ky kryeprokuror duhet t'i mbajë duart larg nga kjo çështje, ai nuk e gëzon besimin e popullit për të ofruar dëshmi për drejtësi.

Republika e Kosovës ka raporte miqësore e diplomatike me Turqinë dhe popullin turk. Neve nuk na intereson rendi shoqëror dhe nuk ndërhyjmë në punën e brendshme të Turqisë. Por lideri turk aktual, Erdogan, nëse do të respektojë dhe ta ndihmojë Kosovën, duhet të respektojë ligjet dhe Kushtetutën e këtij vendi.

Qytetarët e Republikës së Kosovës nuk janë as gylenistë as erdoganistë, ne e mbrojmë Republikën e Kosovës bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe askush nga zyrtarët e këtij vendi nuk mund të shkelë Kushtetutën duke i shërbyer kujto qoftë dhe çfarëdo interesi të tij personal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Liburn Aliu e ka fjalën!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Sot Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së e pati prapë një mbledhje, në të cilën priti që në atë mbledhje të vijë kryeshefi i AKI-së dhe të raportojë në lidhje me çështjen e kidnapimit, deportimit apo dëbimin e shtetasve turq dhe kjo është hera e tretë që Komisioni e ftoi kryeshefin e AKI-së dhe nuk pati përgjigje. Patëm, në fakt, përgjigje, refuzimin e ardhjes dhe raportimin para Komisionit.

Ky injorim është thjesht një shenjë që ata tregojnë që janë autoritet edhe mbi Kuvendin. Duhet të mos harrojmë që Republika e Kosovës është Republikë Parlamentare dhe është obligim i AKI-së që të vijë dhe të raportojë para komisionit.

Kjo, në fakt, është një shenjë që tregon për një injorim të përgjithshëm të të gjitha institucioneve karshi Parlamentit. Edhe sot këtu me këtë përbërje të Qeverisë, në këtë seancë, po e shohim të qartë injorimin që na e bën Qeveria.

Unë jam dakord që të krijojmë një Komision hetimor parlamentar, thjesht nuk besoj që ky komision do të japë informacionin pikërisht për faktin se Qeveria sot, bashkë me AKI-në e me të gjithë, hezitojnë të japin informacion për atë se çka ka ndodhur.

Por, sidoqoftë, mirë do të jetë që të krijohet ky komision, të krijohet që të kuptohet që Qeveria dhe këto agjenci e injorojnë plotësisht Parlamentin dhe para nesh janë jashtëzakonisht shumë dilema sot.

Të mos harrojmë që në ditën që u arrestuan apo u kidnapuan shtetasit turq, me mënyrën se si ka ndodhur kjo ka rënë shteti i Kosovës.

Duhet të mos harrojmë që mënyra e tillë e kidnapimit dhe trajtimi i tillë i shtetasve turq, në fakt e ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë marrëdhënien me Turqinë, në të cilën për shumë vjet është investuar dhe tash me një veprim shumë të thjeshtë dëmtohet kjo marrëdhënie.

E po ashtu edhe në raport me Bashkimin Evropian, ky veprim e dëmtoi marrëdhënien tonë me Bashkimin Evropian.

Prandaj, ne jemi shumë të vetëdijshëm që veprimi i tillë na dëmtoi jashtëzakonisht shumë dhe në këtë moment ne kemi një injorim të plotë nga Qeveria, e çka të presim tash, ta bëjë një komision, të bëjmë debate të tilla, të shohim se ai komision tash do të mbledhë sa informata dhe pastaj eventualisht të shohim se si do të veprohet.

Parimisht nëse flasim, të gjithë këtu japin kritika, japin kritika për atë se çka ka ndodhur, japin kritika ndaj Qeverisë, japin kritika ndaj presidentit, ndaj AKI-së e ndaj të gjithëve, po nëse do të flisnim parimisht, thjesht ky pushtet duhet të bie dhe të ndodhin zgjedhjet e parakohshme, duhet të delegjtitimohet edhe presidenti.

Gjithë atë informacion që ne po mendojmë se do ta kemi, unë hezitoj të besoj që do të kemi ndonjë informacion shumë më të thellë.

Seanca do të duhej të mbahej menjëherë pas ngjarjes të dëbimit të shtetasve turq dhe u shty për datën e sotme pikërisht për shkak të mungesës së informacionit dhe sot a kemi informacion, kemi diçka më tepër? Nuk kemi.

Pse sot e patëm ministrin e vetëm këtu që na foli, po flas se lidhet drejtpërdrejt me çështjen, ministri i Drejtësisë, i cili doli të na thotë që edhe ky nuk di asgjë sikur ata shumë të tjerë që nuk dinë asgjë.

Të thuash ‘nuk di asgjë’, nuk është shfajësim, nuk është që amnistohesh nga fakti që thua ‘unë nuk kam ditur asgjë për atë se çka ka ndodhur’. Secili këtu thotë unë nuk di asgjë, nuk e dimë, në fakt, a kanë ditur apo nuk kanë ditur?

Unë mendoj madje dhe besoj që kanë ditur, disa prej tyre e kanë injoruar atë çka kanë ditur se as që e kanë pasur idenë se çfarë pasoja do të ketë, e disa të tjerë e kanë ditur çfarë pasojash do të ketë, po nuk kanë reaguuar fare. Disa madje mund të kenë qenë drejtpërdrejt të përfshirë.

Në gjithë këtë situatë shteti ka rënë në një pikë, largohet nga Qeveria, shkarkohet nga Qeveria ai që ka qenë më së lehti të shkarkohet.

Pra, forca e Qeverisë këtu po shihet shumë qartë për shkak se shkarkohet vetëm ai që ka qenë lehtë të shkarkohet.

Nga ministri i Drejtësisë nuk u përmend fare që dy apo tre javë para se të ndodhë dëbimi kemi pasur prokurorin e shtetit të Turqisë këtu. A ka pasur kërkesë konkrete, ta dimë, në lidhje me këtë që ka ndodhur? A ka pasur ndonjë pretim nga zyrtarët tanë, a ka pasur ndonjë premtim nga ministrat tanë, dikush nga Qeveria kundrejt shtetit turk, që ta dimë, së paku. Ka pasur premtim dhe pastaj i gjithë ky reagim sot normal që sjell reagime edhe nga Turqia. Të na tregojnë a kanë premtuar që do t'i dërgojnë këta shtetas turq, ashtu siç e pamë që ndodhi.

Të gjitha këto na çojnë në një përfundim të thjeshtë.

Natyrisht, besoj që do të krijohet ai komision hetimor, sepse këtu të gjithë janë që të krijohet Komisioni hetimor. Që do të ketë ndonjë rezultat me informacione, nuk pres, por kjo do të jetë shumë e qartë, do ta bëj shumë të qartë këtu para të gjithëve që thjesht ky pushtet duhet të ndryshohet, kjo Qeveri duhet të bie, duhet të bie sepse u lodhëm duke na thënë 'nuk dimë gjë', 'nuk dimë për këtë', 'nuk dimë për atë'. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Shqipe Pantina e ka fjalën.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nga ju sot dëgjova vlerësime skajshmërisht të ndryshme lidhur me veprimtarinë, por edhe dëbimin e gjashtë qytetarëve turq që për mua ende mbeten punëtorë të arsimit apo mësues.

U tha se ata janë kidnapuar, janë përzërë, e kështu me radhë dhe atyre u janë shkelur të drejtat themelore të njeriut.

Unë jam tejet e shqetësuar kur të drejtat e njeriut shkelen dhe sidomos kur ato shkelen nga vendi im.

Por, unë jam shumë e shqetësuar dhe këtu po flas edhe si qytetare e këtij vendi, por edhe si deputete, nëse në vendim tim, në Kosovë, veprojnë organizata siç u përmendën këtu, terroriste.

Nuk po e shoh zotin Damka këtu, por i kam disa pyetje për të, shpresoj që ndoshta zoti Yagcilar mund të përgjigjet, sepse për mua fjala “terrorist”, organizatë terroriste, është jashtëzakonisht e rëndë dhe tejet shqetësuese.

Nëse kjo organizatë, anëtarë të së cilës paskan qenë këta gjashtë punëtorë të arsimit, është organizatë terroriste, kur është shpallur si e tillë dhe nga kush është shpallur?

Nëse është shpallur organizatë terroriste nga institucione dhe organizata relevante, atëherë si është e mundur që kjo organizatë vepron në Kosovë, vepron me leje të institucioneve tona.

Për më tepër, vepron në një sektor që jashtëzakonisht i ndjeshëm, vepron në sektorin e arsimit. Kjo organizatë, siç po thuhet terroriste, menaxhon me shkolla, ku shkojnë dhe edukohen fëmijët tanë.

Zoti Damka po ashtu iu referua një raportit të AKI-së, Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Si është e mundur që zoti Damka e ka një raport të tillë dhe ne nuk e kemi?

Nëse po ekzistua një raport i tillë, pse atë nuk e kanë të paktën anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe si i ra në dorë ai raport vetëm zotit Damka si deputet i këtij Kuvendi.

Pra, janë pyetjet cilat, jo vetëm ne si deputetë duhet t'i dimë, por mendoj se duhet t'i dinë edhe qytetarët e vendit.

Sa i përket rezolutës së propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, edhe pse u dhënë shumë vlerësime e cilësime të ndryshme këtu, unë mendoj se, po, akoma ka hapësirë dhe është më se e nevojshme që të krijohet një komision parlamentar.

Por e kam shumë problem pikën 4 të kësaj rezolute, kur thotë: “Kuvendi duhet të kërkojë respektimin e të drejtave të njeriut të atyre që i paskan bërë këto shkele”. Pse duhet Kuvendi të kërkojë diçka që tashmë është e garantuar me Kushtetutë.

A po thotë edhe kjo se ne jemi në dijeni se këto të drejta nuk respektohen dhe vetëm sot po e kërkojmë një gjë të tillë.

Pra, ka shumë pikëpyetje, por për mua shqetësimi më i madh mbetet cilësimi i një organizata, e cila në Kosovë vepron në fushën e arsimit si terroriste dhe nëse është ashtu, si është e mundur që nuk është ndërprerë edhe veprimtaria e këtyre shkollave, por vetëm janë dëbuar një numër, në këtë rast gjashtë, qoftë drejtuesit, qoftë mësuesit e këtyre shkollave.



Unë mendoj se zoti Damka na i ka borxh edhe neve këto përgjigje, por mbi të gjitha u ka borxh qytetarëve të shqetësuar të këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tashmë të gjithë e kemi të qartë që janë shkelur normat, janë shkelur procedurat, janë shkelur ligjet në rastin e deportimit të gjashtë shtetasve turq dhe unë realisht nuk e kam shumë të qartë, sepse shumë prej deputetëve në fjalimet e tyre domosdoshmërisht e përsërisin të njëjtën gjë.

Në fakt, ka një vendim të kryeministrit të Kosovës, ai e ka marrë një vendim që të shkarkojë ministrin e Brendshëm si dhe drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës, dhe unë besoj se kjo duhet respektuar dhe duhet vlerësuar, nuk ka qenë një vendim i lehtë dhe nuk ka qenë një vendim ose një praktikë e cila ka ndodhur shpesh me rastin e qeverive të mëparshme.

Ju kujtoj se ish-kryeministri i Kosovës e ka shkarkuar një ministër vetëm pas një presioni të jashtëzakonshëm publik dhe disa javë me vonesë.

Unë do të kërkoja prej kolegëve të partive politike, posaçërisht prej opozitës, që ta vlerësojnë këtë vendim të kryeministrit të vendit ose masat që i ka ndërmarrë.

Nëse po thoni që, për shembull, këto masa nuk janë të mjaftueshme, mund të diskutohet, por në çdo situatë unë besoj që kjo duhet të vlerësohet.

Tani, ne e kemi një propozim konkret të Lidhjes Demokratike të Kosovës, një propozim të atyre që e kanë thirrur këtë debat që i ka katër pika.

Pika e parë që njerëzit, drejtues të institucioneve që lidhen me ngjarjen drejtpërdrejt të raportojnë në komisionet parlamentare dhe kjo është krejtësisht në rregull.

Kemi një kërkesë që të krijohet një Komision hetimor dhe unë besoj që kjo është një kërkesë normale dhe besoj që shumica e deputetëve nuk kanë asnjë arsye të vetme që të mos i mbështesin këto dy pika.

Dhe, i kemi dy pika të fundit që paka shumë janë deskriptive dhe janë të nënkuptueshme. Unë pajtohem 100% me deputeten Pantina, e cila thotë për shembull që një gjë që është e nënkuptueshme, nuk ka nevojë të jetë si propozim ose rekomandim i një dokumenti që ne do ta miratojmë.

Prandaj, ju kisha lutur që përfaqësuesit e grupeve parlamentare ta harmonizojnë tekstin, edhe ashtu duket që jemi në fazën e fundit të diskutimeve, në mënyrë që ta votojmë rezolutën ose propozim-dokumentin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën. Replikë? Zoti Damka ka replikë.

FIKRIM DAMKA: Vetëm gjysmë minute.

Të gjitha mediat edhe portalet e kanë pasur raportet e AKI-së, shkurt dhe për bazat të cilat e kanë. Po çka po doni në qoftë se ju nuk e keni lexuar nëpër portale, e para.

Edhe e dyta, duhet kërkuar edhe prej presidentit, pasi që edhe presidenti e ka shpallur që e ka një raport dhe e ka thënë që janë këto, raporti i AKI-së, i cili ka thënë që janë kundër Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka Shqipja.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

E para, prapë pyetja është se si dalin raportet e AKI-së nëpër media, po më vjen keq, nuk e kam lexuar nëpër media, e ato nuk i ofrohen institucionit të Kuvendit, në këtë rast Komisionit për Mbikëqytje të AKI-së.

Por shqetësimi im vazhdon të mbetet kush e ka shpallur këtë organizatë terroriste, sepse zoti Damka iu referua si 'organizatë terroriste'. Nëse qenka e tillë, si është e mundur të lejohet të veprojë në Kosovë, pra nëse kjo qenka shpallur organizatë terroriste nga institucione relevante ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Meqë e kam mbajtur një fjalë në cilësinë e kryetarit të grupit, do të përpiqem të jem më i shkurtër, kryesisht do të prek disa çështje, të cilat u thanë gjatë debatit.

Përpjekja për të relativizuar këtë edhe për t'i sjellë gjashtë personat, shtetasit turq të depërtuar, është për keqardhje.

Tërë debati nuk mund të relativizohet në një keqardhje për disa njerëz, sepse këtu kemi të bëjmë me një debat që shtron përgjegjësinë e shtetit në raport me veprimin në kundërshtim me Kushtetutën dhe me konventat ndërkombëtare.

A keni dëgjuar, disa nga kolegët thonë që është bërë konform ligjit. Nuk është bërë konform ligjit, s'ka ligj në botë në një vend demokratik që mund t'u mbivendoset konventave

ndërkombëtare as Kushtetutës. Të gjitha ligjet derivojnë nga Kushtetuta dhe nëse një vend, në këtë rast Kosova, ka miratuar, ka aprovuar, ka pranuar, ka ratifikuar, si doni ta quajmë, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, asnjë ligj nuk mund të jetë mbi atë konventë dhe nëse vetëm dyshimi më i vogël ekziston se personat mund t'i nënshtrohen torturës, është e ndaluar të dorëzohen, të deportohen, të ekstradohen. Nuk kemi debat këtu se çka është organizata gylen, a është terroriste a s'është terroriste, nuk na takon neve ta bëjmë këtë debat. Absolutisht nuk kemi të drejtë të përfshihemi në këtë debat, sepse ai është debat i brendshëm i kombit turk, i shtetit turk, i institucioneve dhe i shoqërisë turke, nuk është debat yni.

Ajo që është debat yni është: a është vepruar konform Kushtetutës së vendit, konform konventave ndërkombëtare, apo nuk është vepruar në Kosovë?

Dhe, unë mendoj që këtu kemi një shkelje gjatë këtij veprimi, gjatë këtij aksioni kemi shkelje të rëndë të Kushtetutës së vendit, e cila i ka të integruara konventat ndërkombëtare, duke filluar nga nenin 22 deri te neni 27 diku, 28, 30.

Pra, duke i pasur parasysh këto debate, duhet të përqendrohet te kjo çka kemi bërë.

Tjetra, po shihe, kemi me qindra, rreth 310, a sa u tha në vit që i ekstradon Kosova, i përcjell, i largon, i dëbon, se tash kemi probleme edhe me terminologji.

Unë ju siguroj, pa i pa dosjet e asnjërit nga ata, që asnjëri nga ata nuk ka qenë i kërkuar nga shtetet në fjalë, hiq pa i parë, jam shumë i sigurt në atë. Asnjëri nga ata mbi të gjitha nuk ka pasur leje qëndrimi në Kosovë, të cili i është marrë brenda 5 ditësh dhe janë dëbuar, asnjëri nga ata nuk i ngjajnë këtij rasti.

Ata janë në raste të zakonshme, të cilët kanë qëndruar ilegalisht në Kosovë, edhe unë, edhe shumë të tjerë të cilët kemi qëndruar në Zvicër, Gjermani, e dimë po qe se të zë Policia duke qëndruar ilegalisht, të merr, të çon në stacion policor, të çon te gjykatësi për kundërvajtje dhe me aeroplan të kthen në vendin e origjinës, po nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë.

Përpjekja tash për të futur këta gjashtë persona te ata 300, është e pasinqertë dhe të njëjtën kohë, të thuash 'na vjen keq për ata'. Po, leje, se keqardhja është njerëzore, por shkeljet janë ligjore, janë kushtetuese, janë konventa ndërkombëtare, mua kjo më dhemb, kjo më shqetëson.

Fati i individëve në fjalë ka qenë në duar të ligjit, të shtetit të Kosovës dhe kjo fatkeqësisht është keqpërdorur.

Ne e dimë që është bërë përpjekje të kamuflohet me ligj, duke ua hequr të drejtën e qëndrimit në Kosovë, mirëpo harrojmë ta potencojmë e ta theksojmë se të njëjtëve u është mohuar e drejta e ankesës, e drejtë elementare.

Xhavit, qysh je ndier në Itali kur të kanë mbajtur dy javë ditë para se të shpëtohesh nga angazhimi i miqve, i avokatëve, e i krejt organizatës që të mos të dëbonin, për të mos ekstraduar ty në Jugosllavi.

Jugosllavia i ka pasur të bazuara akuzat kundër teje, ti mirë e di që i ka pasur të bazuara, po ti ke qenë i rrezikuar fizikisht, që t'i nënshtroheshe torturës po të dorëzoheshe, jo pse ti s'e ke bërë veprën.

I lëmë këto, nuk është debat yni çka janë gylenistët, a jemi me ata a jemi këta? Ne me asnjë nuk jemi, ne jemi me popullin turk, ne jemi me shtetin turk.

Unë ju lus, kolegë të nderuar, mos u merrni me deputetët e pakicës turke, kur shteti, bartësit, prej presidentit e teposhtë i janë nënshtuar, i janë gjuhëzuar Turqisë, po pritni këta të jenë në linjë me neve, nuk është korrekte t'i kritikoni ata, leni ata, e kanë të drejtën e tyre të marrin anë kah donë, është e drejtë e tyre.

Ne duhet t'i gjykojmë veprimet e institucioneve tona, e bartësve të atyre që e kanë ideuar, e kanë përgatit dhe e kanë zbatuar këtë aksion. Besa, kjo i ka rrënjët, gjenezën te një fjali e famshme e presidentit, ju e dini mirë, në Ankara e ka thënë: "Kush është terrorist në Turqi, është terrorist edhe në Kosovë". Ai vetë e ka thënë këtë. Edhe ne e dimë që krejt kjo është ngjizur në atë konferencë për shtyp, kanë qenë shenjat e parë se kah do të shkojë. Tjetër është që këta të shkretët kanë besuar në një sistem ligjor, në vend demokratik që i zbaton Kushtetutën dhe konventat, kanë gabuar.

Unë frikohem që këtu do të rivendoset rendi, kam frikë se do të mund të rivendoset rendi kushtetues, siç do të duhej lidhur me këtë çështje.

Unë frikohem se presionet do të jenë edhe më të mëdha apo kam shqetësimet e mia, kam dilemat e mia dhe gabime do të ketë edhe në të ardhmen, do të bëhen edhe në të ardhmen.

Rreth rezolutës, unë mendoj që rezoluta, përfundime duhet të ketë dy nene, hiq më shumë, që Kuvendi të themelojë një Komision hetimor për të hetuar në tërësi dhe në plotëni në mënyrë që të ndriçohet në tërësi rasti, dhe

Nën dy, për mendimin tim, obligohen të gjitha institucionet relevante që të bashkëpunojnë me komisionin deri në ndriçimin e plotë të këtij rasti.

Nuk mendoj të ketë nevojë më shumë se për këto dy pika.

Nëse ne arrijmë një pajtueshmëri që këtu ka shkelje të Kushtetutës, s'po merrem me ligje, me nene atje. Ja, ky nen ia ka mundësuar t'ia marrë lejen brenda pesë minutave dhe pas 5 minutave ta hedhë në aeroport, lëne këtë, i dimë malverzimet që bëhen.

Por, le ta bëjnë një rezolutë që ka dy nene: njëra që e krijon Komisionin hetimor, i përbërë nga të gjitha grupet parlamentare dhe, tjetri që e mandaton komisionin të hetojë deri në fund dhe i detyron të gjitha institucionet relevante, nga Policia, hetuesia, Prokuroria, ku ta di unë, të gjitha institucionet, AKI-në, të bashkëpunojnë dhe të jenë në dispozicion të këtij komisioni.

Pastaj, pasi komisioni të vijë në përfundim mbi bazën e hetimeve që i ka bërë, hetimeve në kuptimin e punës hetimore, duhet të vijmë sërish për mendimin tim në këtë Kuvend dhe të miratojmë konkluzione që dalin nga raporti hetimor. Aktualisht po, ne të gjithë flasim mbi bazën e informatave publike që kemi dhe informata publike është kjo. Njerëzve u është hequr e drejta e qëndrimit, janë marrë nëpër shtëpitë e tyre apo nëpër shkolla, ku kanë qenë dhe janë dëbuar deri në aeroport, janë dorëzua një hetuesie të një shteti tjetër pa iu dhënë e drejta e ankesës, këto janë informata publike, nuk na nevojitet këtu të thërrasim askënd për ta marrë vesh, e dimë këtë. Ajo që komisioni duhet të marrë vesh, cila ishte ajo informata vendimtare që ua mori të drejtën e lejeqëndrimit, që ua hoqi të drejtën për të qëndruar në Kosovë. Përderisa ata kishin leje qëndrimi, dikush një institucion ua kishte lëshuar, tash çka ishte aq vendimtare brenda natës që u konstatua se përbën rrezik të madh nacional dhe u hoqën menjëherë. Nga momenti kur iu hoqën, ata u lanë të lirë, siç quhet, "të lirë për gjuajte" dhe kjo do të duhet të sqarohet gjatë procesit të punës që do të bëjë komisioni hetimor.

Nëse shkojmë dhe zgjerohemi në çështje politike, mendoj që nuk do të arrijmë asnjë rezultat, edhe kjo seancë do të mbetet një nga seancat ku të gjithë shfryhemi dhe i themi pikëpamjet tona rreth kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Kolegë të dashur,  
Zonja dhe zotërinj,

Mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me ligjet e vendit dhe standardeve evropiane, është pjesa e betimit, të cilën ne e kemi dhënë kur jemi bërë deputetë, kur ka filluar mandati ynë.

Unë i kam dy vështrime për këtë debat, deri tash. E para, më vjen shumë mirë që ekziston unifikimi dhe e dënojmë një shkelje flagrante të Kushtetutës së vendit, të Kosovës. Të gjithë jemi të unifikuar në kërkesë për aprovimin e Komisionit hetimor parlamentar, por këtu në anën tjetër

po ndodhin edhe disa një lloj ndryshimi të tezave të debatit pse është thirrur. Më së paku na përket neve që të përcaktohem për Republikën e Turqisë, domethënë diskutimi sot nuk është për rendin demokratik në Turqi, nuk është për çështjet e brendshme të Turqisë, nuk ka të bëjë kjo me miqësinë tonë, të cilën duhet ta kultivojmë me shtetin mik të Turqisë, por kemi të bëjmë më 29 marsin, i cili ishte triumf i paligjshmërisë dhe shembje e sistemit kushtetues juridik në Republikën e Kosovës.

Kjo është ajo çka ka të bëjë debati i sotëm dhe kërkesa për Komision hetimor parlamentar.

E qartë ka qenë për të gjithë që më 29 mars janë shkelur së paku pesë nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Edhe unë po i cekim pesë, ka më shumë po pestat, të cilat mua m'u kanë dukur kyçe.

E para, është neni 3, që ka të bëjë me ndarjen e pushteteve, është shkelur në mënyrë flagrante.

Neni 22, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut, që është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Kosovës, është shkelur në mënyrë brutale.

Neni 24, që ka të bëjë me barazinë para ligjit, është shkelur njëjtë.

Neni 29, që ka të bëjë me privim nga liria pa urdhër të gjykatës, ku ata të cilët janë të privuar, kanë të drejtë të ankohen, është shkelur.

Neni 32, çdo qytetari, njeriu në Kosovë i garantohet përdorimi i mjeteve juridike kundër vendimit të gjykatave, është shkelur.

Neni 29, që ka të bëjë me AKI-në, pika 4, ku shefi i AKI-së informacionet e njëjta ua dorëzon apo ua jep presidentit dhe kryeministrit të shtetit dhe s'është këtu kolegu Pajaziti, ai e lexoi një pjesë të Ligjit për të huajt, por nuk e ka lexuar pikën kyçe, e ajo ka të bëjë me pika 3, të nenit 6 të Ligjit për të huajt, i cili jep gjithkujt, i cili edhe mund të konsiderohet se po punon kundër interesave të shtetit tonë, të drejtë për t'u ankuar në gjykatë.

Tash, çka kemi parë ne më 29, 30, 31 mars? Suspendimi i plotë i rendit kushtetues juridik prej një vendimi, të cilin e ka marrë një njeri. Unë nuk mendoj që ka dikush, s'është në rregull të na thuhet 'mos jepni kualifikime politike', sepse kur të shkelet Kushtetuta, besomëni që është kualifikim politik. E dyta, ka tejkalim të kompetencave. Nga kush? Nga kryetari i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Ne kemi një lloj uzurpimi të segmentit të sigurisë, tash ne që jemi në opozitë një kohë të gjatë, kemi thënë që Kosova është shtet i kapur, por atë çka kemi parë më 29 mars është që po ekzistua edhe një qark më i kapur se sa i shtetit të kapur, të cilin e kemi kritikuar ne.

Ky debat, faktikisht ka të bëjë më së shumti me ne. Ne, të cilët jemi persekutuar në një 100 vjetësh, jemi bërë persekutues të njerëzve të tjerë. Më falni, po ne jemi shteti i parë në Evropë, i cili në kësi lloj mënyre i shkel të drejtat e njeriut. Edhe me këtë është dëmtuar themeli i shtetit të Republikës së Kosovës, edhe është fyerje për historinë tonë të paktën 100-vjeçare të fundit. Ndoshta, këtë themel të dëmtuar mund ta sanojmë sado pak me Komision hetimor parlamentar, por turpin, i cili i ka ndodhur shtetit do të jetë një kohë shumë të gjatë derisa ta tejkalojmë këtë njollë të zezë, sepse besomëni në botë kujt s'i intereson a ka qenë kryeministri i përfunduar apo jo, a i ka tejkaluar presidenti i shtetit kompetencat a jo? Ata të shohin ty si një Republikë e Kosovës, e cila i shkel të drejtat e njeriut dhe po rreshtohesh me shtete jofunksionale të botës.

Tash, pse është me rëndësi Komisioni hetimor parlamentar?

Me këtë lloj vlimi të paligjshmërisë, shembje apo tentim shembje të rendit juridik dhe kushtetues, ne i kemi mjetet institucionale, demokratike, që ta kthejmë në binarë kushtetutshmërinë e vendit. Të paktën, tregojmë para qytetarëve tonë, para vetes që rregullat bazë demokratike i respektojmë. Me Komision hetimor parlamentar unë kisha sugjeruar që të shohim gjatë kohës së konsultimeve të grupeve parlamentare kohëzgjatjen kur duhet të dalim me të gjetura. Derisa ne jemi duke e mbajtur seancën sot, Avokati i Popullit ka dalë me të gjeturat preliminare dhe i ka publikuar ato në media.

Ne njëjtë në këto ditët e fundit patëm reagime emotive nga bartësit institucionalë, për shembull, përgjigjja e kryeministrit Haradinaj kryetarit të Turqisë nuk na bën nder. Ai duhej të ishte përgjigjur në mënyrë më të lartë, se sa në atë që bëri. Jo të bjerë në grackë të emocionit dhe, e fundit, kryetari i Kosovës, Thaçi, doli në konferencë për shtyp dhe tregoi që është uzurpator. Doli edhe tregoi që ai e ka ditur, ka qenë i informuar, e rrjedhimisht edhe ka dhënë urdhër për veprimin e bërë. Edhe ne duhet ta vendosim një vijë të kuqe në mënyrë kolektive që asnjë individ më të mos i bie në mend në këtë Republikë të Kosovës që të uzurpojë për interesa personale zyrat më të larta, funksionet më të larta publike. Kjo ka të bëjë me një standard minimal, faktikisht, i cili është normal në botën e zhvilluar, e i cili është jonormal në Kosovë, Kuvendi i Kosovës në mënyrë unanime duhet ta vendosë atë standard. Edhe kujt më s'i intereson, a Iliri, a ky, a ai çka po bën, po duhet nënshtruar rregullave, të cilat i kemi vendosur bashkë.

Këtë vit, një prej proklamimeve të Qeverisë së Kosovës ka qenë aplikimi në Këshillin e Evropës. Duhet ta harrojmë aplikacionin në Këshill të Evropës për këtë vit, e për vitet e ardhshme. Kjo Qeveri jo që nuk do ta ndihmojë integrimin e Kosovës në çfarëdo organizate ndërkombëtare, po unë ju them që edhe qeveritë e ardhshme do ta kenë shumë të vështirë, për shkak të pasojave të 29 marsit, sepse ato i tejkalojnë kufijtë e Kosovës, i tejkalojnë lojërat politike, të cilat ndodhin në Kosovë. Dhe, në fund, ne patjetër duhet ta mbërrijmë një pajtim që Kosova nuk mund të prishet me miqtë e vet. S'kemi ne shumë miq që na kanë mbetur në botë, pak na kanë mbetur. Prishu me Evropë, prishu me Amerikë, prishu me Turqi, çka po duam ne? Çka është shembulli i Kosovës?

A është Koreja e Veriut? A është shteti i izoluar prej botës? Përgjegjësi për atë çka do të bëjmë ne sot dhe çka do të bëjë ai Komision hetimor parlamentar nuk marrim ne vetëm sot me aprovimin e tij, por edhe me të gjeturat, të cilat do t'i ketë. Edhe ai komision duhet të ketë pavarësi të plotë në emërimin e atyre, të cilët me të vërtetë e kanë shkelur Kushtetutën, të cilën ne jemi të thirrur ta mbrojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Para disa ditësh në formë të kundërligjshme u deportuan gjashtë shtetas turq. Në Ligjin për të huajt, në nenin gjashtë, te refuzimi apo revokimi i lejes së qëndrimit për rrethana të sigurisë shtetërore thuhet: “Kontrollet e sigurisë për të huajt për qëllime të përcaktimit të arsyeve që lidhen me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë”, e cila është përcaktuar në nenin 2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës.

Nën 2, në rastet të revokimit apo të refuzimit të lejes së qëndrimit të huajt për arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, lëshohet vendim pa arsyetim lidhur me rrethanat për të cilat është nxjerrë ky vendim.

Nën 3, i huaji subjekt i paragrafit 1, të këtij neni, ka të drejtë ankese në gjykatën kompetente.

Nën 4, i huaji subjekt i paragrafit 1 të këtij neni që kanë status të refugjatit apo mbrojtje plotësuese, do të procedohen bazuar në procedurat e përcaktuara në Ligjin për azil. Asnjëra prej këtyre nuk është respektuar.

Drejtori i AKI-së ende nuk i ka bërë të qarta arsyet e këtij deportimi, duke mos respektuar as nenin 3 të këtij ligji. Menjëherë së bashku me Policinë e Kosovës, brenda disa orëve, përmes një aeroplani të shërbimit inteligjent turk i kanë hipur aty dhe i kanë deportuar në Turqi. Menjëherë, pas kësaj kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe presidenti Hashim Thaçi në prononcimet e tyre thanë se nuk dinë asgjë në lidhje me deportimet. Në të vërtetë, secili prej tyre mendohej që këtë përgjegjësi t'ia ndante tjetrit. Ndërsa, qartësimi ndodhi kur Presidenti turk e falënderoi Thaçin dhe protestoi kundër Haradinajt. Ndërsa, në anën tjetër, Thaçi në fillim mohonte çdo gjë që kishte të bënte me deportimet. Kjo nuk e amniston as Pacollin, sepse pas vizitës së Pacollit në Turqi, pas së cilës pasoi edhe kjo ngjarje, ne duhet t'ia bëjmë të qartë Kabinetit qeveritar se bizneset individuale të ministrave, pra përfshirë Pacollin, nuk mund të jenë politika e jashtme e Kosovës.

Sa për të qartësuar, unë nuk kam shqetësim me presidentin e një vendi tjetër që megjithatë është zgjedhur në mënyrë legjitime dhe përfaqëson atë vend, mua dhe të tjerëve na shqetësojnë ndodhitë e fundit, ku Kosova u radhit në shtetet që nuk respektojnë të drejtat themelore, liritë politike dhe veprojnë njëjtë sikurse shtetet autoritare. Kjo ka dëmtuar themelet e shtetit tonë,



institucionet tona, demokracinë edhe ashtu të brishtë. Madje, në mënyrë si janë bërë edhe vetë me Turqinë janë destabilizuar këto marrëdhënie, edhe pse ky shtet është nga të parët që e ka njohur pavarësinë e Kosovës, respektivisht shteti i dytë.

Kryeministri shkarkoi ministrin Sefaj dhe kreun e AKI-së, ministri Sefaj mori përgjegjësinë e kryetarit të tij partiak, por Driton Gashin po e mbron presidenti. Në Komisionin për Mbikëqyrje të AKI-së Gashi nuk mori mundin fare të vinte për të raportuar mbi ngjarjet e fundit, madje këtë nuk e mori as zëvendësi i tij dhe askush nga udhëheqja e AKI-së. Nga ky komision kam kërkuar listën e fluturimeve për atë ditë, të cilët kanë ateruar në aeroportin e Prishtinës, sepse duhet të dimë bazën ligjore të veprimit të një shërbimi të një shteti të huaj në hapësirën dhe territorin tonë, e cila fatkeqësisht është antiligjor.

Hapësira dhe territori ynë nuk duhet të jenë arenë e lirë për shërbime të huaja, AKI-ja duhet të raportojë para komisionit, sepse Kosova është Republikë parlamentare. Prandaj, ata kanë detyrë të na njoftojnë se çfarë ka ngjarë, nga kush Driton Gashi ka marrë përgjegjësi të hartojë dosje? Nga kush ka marrë urdhra për t'i klasifikuar si të rrezikshëm këta persona? Kush i solli emrat e gjashtë shtetasve turq dhe si u bënë ata emra që zyrtarisht po përndiqeshin nga agjencia. Në Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, pika 3, thuhet: “Ministria mund të lejojë transferimin në bazë të paragrafit 1 të këtij neni vetëm pasi të jenë të njoftuar me mendimin e personit të dënuar”. Pastaj, “Ministria i ofron shtetit zbatues dokumentet në vijim: deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar lidhur me transferimin e tij apo të saj dhe kopjen e urdhrat për deportim apo dëbim, apo ndonjë urdhri tjetër me të cilit personit i ndalohet qëndrimi në territorin e Republikës së Kosovës, pasi që ai apo ajo është liruar nga burgu dhe kur një person është transferuar pa pëlqimin e tij apo saj, siç parashihet në këtë nen. Ministria në bazë të kërkesës së shtetit zbatues mund të autorizojë atë shtet që të ndjekë penalisht, ta dënojë apo të mbajë personin e transferuar për një veprë të kryer para transferimit. Autorizimi i tillë mund të jepet vetëm kur vepra penale për të cilën është kërkuar do t'i nënshtrohej ekstradimit, sipas ligjit vendor, ose kur ekstradimi do të përjashtojë vetëm në lartësinë e dënimit”, asnjëra prej këtyre nuk është respektuar, fatkeqësisht.

Përgjegjës për këtë është Hashim Thaçi, i cili duhet të shkarkohet nga deputetët e Kosovës urgjentisht, sepse ka shkelur parlamentarizmin, demokracinë dhe ka rrënuar institucionet e Kosovës. Sigurisht, nga përgjegjësia nuk duhet të largohet as kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentari Kadri Veseli, ndërsa në AKI duhet shkarkuar i tërë zinxhiri përgjegjës për këtë aksion.

Prandaj, kjo Qeveri duhet të quhet “qeveri që nuk di gjë”, sepse pak më parë mora vesh se në pyetjen që ia kishin bërë edhe kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me largimin e njohjes së shtetit të fundit, ai kishte thënë “nuk di gjë”. Prandaj, kjo Qeveri, së bashku me presidentin është qeveri “nuk di gjë”, e cila duhet të shkojë në shtëpi, duhet të shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të fillojë, pra që qytetari megjithatë të vendosë për të ardhmen e Kosovës.

Në fakt, edhe dy gjëra të tjera po dua t'i potencoj në këto minutat e mbetur. Me shqetësim për herë të parë konceptova një fjalim të drejtë të Milaim Zekës dhe unë e ftoj atë që ai, pra ato të cilat i përmendi këtu për AKI-në, si shantazhe, si bazë kriminale, të cilën e përmendi, është mirë të kurajohet dhe të shkojë në vendin ku duhet dhe t'i deponojë këto si kallëzime penale, sepse vërtet ishte tejet shqetësuese mënyra se si ai e përshkruante AKI-në.

Unë vetë jam pjesë e Komisionit Mbikëqyrës të AKI-së dhe edhe kolegët e mi, në të gjitha subjektet politike e dinë që sa herë ka ardhur kryetari i AKI-së, ai është sjellë si një top model dhe neve na ka konsideruar si një grup gazetarësh, të cilët i bëjnë pyetje dhe ai i përgjigjet kur të dojë, e kur të mos i dojë qejfi, ai edhe nuk kthen përgjigje. Dhe, për fund, nuk mund të pajtohem me hipokrizinë e disave këtu, të cilët thanë, sidomos të deputetëve të LDK-së, të cilët po e përmendnin varësinë e Hashim Thaçit, të cilët e kanë votuar vetë, e në fakt, ata të cilët përnjëmend mund ta përmendin këtë janë deputetët Anton Quni, Vjosa Osmani, Shpejtim Bulliqi, Adem Salihaj dhe Atim Baxhaku. Të gjithë këta të tjerët, të cilët po thirren dhe po thonë se 'Hashim Thaçi është e keqja e Kosovës' prej LDK-së e kanë gabim, sepse e kanë dhënë votën aty dhe prandaj nuk e kanë as legjitimitetin moral për t'u thirrur në shkarkimin e presidentit të gazit Hashim Thaçi. Këtë mund ta bëjë vetëm Lëvizja "Vetëvendosje", sepse vetëm ajo ka votuar si tërësi kundër zgjedhjes së Hashim Thaçit. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti Pacolli!

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Po dua të përgjigje, unë edhe më herët e ceka që ndoshta Driton Gashi dhe ministri Sefaj janë vetëm kurban i kësaj çështjeje, por kjo do një hetim më të gjerë në të gjitha dikasteret, që nga fillimi, si ka ardhur dhe si ka përfunduar.

Do të thotë, sigurisht që ata që nuk mërzhiten fort, besoj shumë që kanë edhe fakte të arsyeshme për veprimin e tyre. Megjithatë, Flamur Sefaj ka dhënë dorëheqjen morale, për arsye që është bërë bujë dhe u përmend emri i tij dhe unë besoj shumë që ai ka respektuar ligjin. Prandaj, ne edhe një herë bëjmë thirrje që të formohet Komisioni parlamentar hetues dhe ta sqarojë këtë çështje një herë e përgjithmonë dhe të mos i thërrasim njerëzit emra këtu, derisa ne nuk kemi fakte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Për shkak se edhe jam kryetar i Komisionit për Siguri, dua ta them një gjë, Kushtetuta e Kosovës garanton kontrollin civil dhe demokratik, parlamentar ndaj sektorit të sigurisë në Kosovë.

Tri institucionet operative të sigurisë që janë kategori kushtetuese, pra: FSK-ja, Policia dhe AKI-ja, këto dy të fundit janë të përfshira direkt në aksionin e arrestimit të shtetasve të huaj. Bashkësia ndërkombëtare, NATO dhe çdokush në të gjitha vizitat që kemi bërë atje, çdoherë na kanë cituar se kontrolli demokratik duhet të jetë i rreptë ndaj forcave të sigurisë. A kemi kontroll demokratik sot në Kosovë? Në rastin e fundit po shihet se kontroll demokratik mbi institucionet e sigurisë nuk kemi, nuk kemi parë deri tash.

Komisionin për herë të fundit kur e kam thirrur, në atë komision për herë të parë kemi shkuar si deputetë pa asnjë informacion se çka ka ndodhur më 29 mars.

E kemi ndier vetën të gjithë deputetët jashtëzakonisht keq, sepse nuk kemi informacione, kur dihet se në atë kohë u dëbuan gjashtë shtetas turq nga Kosova në Turqi. Gjashtë profesorë të shkollës së mesme, e në ato shkolla kemi parë më herët shumë ministra, të cilët e kanë vizituar dhe janë krenuar me ato kolegje, e atë ditë pamë se kishte arrestime. Pas një dite pamë një konferencë për shtyp të presidentit të Kosovës, ku gjatë konferencës tha se në raportin e AKI-së thuhet se këta persona kanë cenuar shkallën e rrezikshmërisë nacionale të vendit. Ne si komision nuk kemi parë asnjë raport, përveç neve që s'kemi parë raport të AKI-së, nuk ka parë as kryeministri dhe as kryetari i Parlamentit. Bie fjala, pse presidenti i Republikës së Kosovës nuk ia dërgoi atë raport, me ato të dhëna, kryeministrit të Kosovës që të mos ngutet në shkarkimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të AKI-së? Në qoftë se ata persona janë të rrezikshëm për sigurinë nacionale dhe ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i AKI-së kanë marrë veprime ndaj atyre personave, atëherë kryeministri është dashur t'u japë dekorata, e jo t'i shkarkojë.

Në këtë Parlament është folur shumë për kapjen e shtetit. Është e vërtetë që ka kapje të shtetit, është parë edhe në rastin e fundit, në operacionin e fundit që ka këtu kapje të shtetit, por është hera e parë që ky Parlament duhet të merret seriozisht me një komision hetimor, ta krijojë një komision hetimor dhe jo ta hetojë vetëm këtë tast, por me të vërtetë t'i hetojë të gjitha hallkat se ku është kapur shteti. Tash, aktorët se kush e ka kapur shtetin po dihen. Po dihen, se kërkesa për ekstradimin e njerëzve vjen nëpërmjet ministrit të Punëve të Jashtme. Ministri i Punëve të Jashtme as që e ka njoftuar Qeverinë e Republikës së Kosovës, po ka shkuar në ato rrugët e tij. Ministri i Punëve të Jashtme ende nuk është ftuar nga Komisioni për Punë të Jashtme që të raportojë për një kërkesë të tillë.

Ministri i Punëve të Jashtme bashkë me presidentin e vendit janë njerëz të informuar për këtë operacion, i cili është zhvilluar më 29, e që, për mendimin tim, është një operacion i jashtëligjshëm dhe për këtë arsye komisioni që do të propozohet nga ky Parlament duhet të jetë një komision që duhet ta hetojë jo vetëm këtë rast, por ra ky rast e i dha shans Parlamentit që ta krijojë një komision dhe të merret seriozisht me të gjitha elementet se ku është kapur shteti. Kushdo që di se me të vërtetë atje ndikon presidenti apo ndonjë kryeministër, apo kryeministri,

të merret në hetime dhe të krijohet zinxhiri i udhëheqësve të shtetit. Jo çdokush të marrë vendime dhe të na vë në këtë pozitë, që të prishen marrëdhëniet me shtetet mike, siç është Turqia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot në Parlamentin e Kosovës nuk na takon të flasim as për rendin kushtetues, as për kualitetin e qeverisjes, ose vendimmarrjes së udhëheqësve shtetërorë në Turqi, po aq njëjtë sa që nuk i takon presidentit të Turqisë, ose dikujt tjetër, që të flasë për personalitetet, ose për udhëheqësit shtetërorë të Kosovës.

Kosova si republikë parlamentare e ka treguar në fakt një seriozitet dhe një avancim në përpilimin dhe miratimin e Kushtetutës, për aq sa kanë të drejta pakicat në Kosovë, aq të drejta mund të themi se nuk i kanë pesë milionë shqiptarët në Turqi, në kohën kur kanë migruar dhe në kohën kur ka filluar asimilimi i tyre. Turqishtja është gjuhë zyrtare në Kosovë.

Por, çka ndodhi më 29 mars? Trajtimi i sotëm mendoj se mund të diskutohet në katër pika: në aspektin e të së drejtës ndërkombëtare e humanitare; në aspektin e të së drejtës humane dhe socio-kulturore dhe efektin që e pati deportimi dhe pamjet e deportimit në Kosovë dhe në kulturën tonë; në aspektin ligjor dhe shkeljet ligjore që janë bërë me këtë proces. Natyrisht, nuk mund t'i ikim edhe elementit politik apo elementit të qeverisjes në Kosovë, përkatësisht raportit ndërmjet institucioneve të zgjedhura në Kosovë dhe institucioneve të pavarura të drejtësisë, të cilat pavarësinë e kanë kushtin themelor.

Së pari, nga aspekti i të së drejtës ndërkombëtare, nëse ne nuk i besojmë, ose kemi dyshime me njëri-tjetrin, mendoj se i kemi pasur mesazhet shumë të qarta. Kosova me këtë gjest, përkatësisht institucionet e Kosovës, përveç se kanë treguar një pasiguri, ose një dozë të madhe të pasigurisë të ushtrimit të rendit dhe ligjit brenda në Kosovë, e kanë dërguar një sinjal tepër komprometues të bashkësia ndërkombëtare. Hiç më pak se reagimi i Bashkimit Evropian se ka shumë pyetje për rendin dhe ligjin në Kosovë në kohën kur e drejta dhe funksionimi i shtetit ligjor është një prej kriterëve të fundit edhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, tregon vet për pasojat që tashmë nuk do t'i vuajnë vetëm gjashtë turqit e deportuar apo familjet e tyre në Kosovë, por gjithë popullata e Kosovës, e cila ka mbetur peng i izolimit, përkatësisht mosliberalizimit të vizave.

Në aspektin human dhe në aspektin kulturor, mendoj se u trajtua shumë. Pamjet e tërheqjes zvarrë të gjashtë shtetasve turq, në fakt pesë mësimdhënësve dhe një mjeku, pamjet apo përvoja e hyrjes në klasë, siç ka ndodhur në shkollën "Mehmet Akif" në Gjakovë dhe tërheqja e

mësimdhënësve nga procesi mësimor, mendoj se e ka lënë një vragë të përjetshme për të gjithë ata fëmijë që kanë qenë në kuadër të procesit mësimor.

Të gjithë i kemi të freskëta pamjet e tërheqjes apo pamjet e arrestimeve nga Policia apo regjimi serb dhe më së paku e kemi pasur të nevojshme një ripërsëritje të të gjithë asaj, me çfarë është ballafaquar popullata shqiptare në Kosovë.

Në aspektin ligjor, shkeljet kushtetuese janë evidente. E para, shumë pak u fol, por duket se arrestimi sipas fakteve dhe ajo mbetet të konfirmohet edhe nga organet përgjegjëse, nëse ka të tilla të pavarura në Kosovë, është bërë nga policë turq. Asnjë nga familjarët nuk ka deklaruar se janë ndalur nga Policia e Kosovës. I vetmi element i Policisë së Kosovës kanë qenë automjetet me stemë të Policisë së Kosovës. Ndalimi i shtetasve turq është bërë nga policë turq. Kush e autorizoi veprimin dhe operacionin e tyre në Kosovë? Cilat ishin rreziqet e mësimdhënësve sikur ata të vazhdonin ta kryenin procesin mësimor, ose ata, pas asaj siç e parasheh edhe Ligji për të huajt, të ndaleshin dhe të dërgoheshin te gjykata kompetente. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 129 që u përfol shumë sot, që e rregullon funksionimin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, e parasheh që presidenti i Kosovës dhe kryeministri pas konsultimit me Qeverinë i emërojnë bashkë drejtorin, zëvendës drejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Presidenti dhe kryeministri i marrin të njëjtat informacione. Në fakt, në kuadër të asaj se çfarë ka bërë së pari Agjencia e Kosovës për Inteligjencë e ka shkelur Kushtetutën, sepse nuk ia ka dhënë të njëjtat informacione presidentit dhe kryeministrit të Kosovës.

Në kuadër të kompetencave të kryeministrit, neni 94, kryeministri e kryeson Këshillin e Sigurisë së Kosovës, pjesë e të cilit është edhe drejtori i Policisë së Kosovës. Hiç më larg se më 27 mars, përkatësisht dy ditë para arrestimit, kryeministri e kryesoi një këshill të tillë me temën apo agjendën e arrestimit të Marko Gjuriqit në veri. Si ndodhi që në atë takim asnjë informacion të mos i jepet kryeministrit të Republikës së Kosovës për situatën, e cila thuhej se është diskutuar për një periudhë të gjatë kohore, ose të paktën për një javë më herët.

Në kuadër të kompetencave të kryeministrit është që kryeministri, pika 7 e nenit 94 të Kushtetutës, këshillohet me presidentin e Republikës së Kosovës për çështje të inteligjencës. Tash, edhe kryeministri, edhe presidenti, të dy bashkë, nuk kanë qenë në përputhshmëri me këtë nen, sepse ka qenë tepër evidente se të paktën njëri prej tyre ka deklaruar nga kjo foltore që nuk di gjë për arrestimin, përkatësisht për operacionin i cili kishte ndodhur para syve të të gjithëve. Në anën tjetër, aspekti ligjor tregon se kemi edhe shkelje të nenit 6 Ligjit për të huajt, te refuzimi apo revokimi i lejeqëndrimit për rrethana të sigurisë shtetërore. Është e përcaktuar që në rast të refuzimit apo revokimit të lejes së qëndrimit të të huajit për arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore lëshohet vendim pa arsyetim, që ma merr mendja se tashmë ky vendim pa arsyetim

është i lëshuar, por i huaji subjekt i paragrafit 1 në këtë nen ka të drejtë ankese në gjykatën kompetente, gjë që nuk ka ndodhur në Kosovë.

Një paralele që u tërhoq këtu në raport me arrestimin në Klinë të dhjetë shtetasve..., në fakt ka pasur përzierje, sepse ka pasur shtetas amerikanë. Dallimi është ky, në Klinë, më 28 qershor 2017 janë arrestuar dhjetë persona. Në komunikatën e Policisë së Kosovës tregohet se janë zënë armë të kalibrave të ndryshëm, janë zënë 60 mijë euro kesh dhe i njëjti grup ka qenë i dyshuar për shpëlarjen e 800 mijë dollarëve, si pjesë e grupit mafioz “La cosa nostra” nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po të njëjtit kanë qenë duke u përcjellë një muaj më herët, ka qenë e informuar Konsullata e Republikës së Kosovës në Nju-Jork dhe i gjithë aksioni i Policisë së Kosovës me DEA-n ka qenë i koordinuar, i pasuar nga një komunikatë e Policisë së Kosovës. A ka dëgjuar dikush që zyrtarisht jemi informuar si shtet nga AKI, nga Policia e Kosovës, apo nga kushdo në këtë shtet, në raport me arrestimin dhe “rrezikueshmërinë” të këtyre shtetasve turq? Askush. Prandaj, paralele të këtilla apo krahasime të tilla të operacioneve le të bëhen me fakte. Në këtë rast nuk janë të krahasueshme.

Në aspektin politik, natyrisht se opozita do të flasë për moskompetencën e kësaj Qeverie. Nga kjo foltore e kemi dëgjuar më shumë se një herë, përkatësisht disa herë, kryeministrin e Republikës duke thënë “nuk e di”, “nuk e di, nuk kam informacion”. Kryeministri vetë e shkel Kushtetutën, përkatësisht neni 94 për kompetencat e veta. Kryeministri pyetet se çfarë ka ndodhur me deportimin e gjashtë shtetasve turq, “nuk e di!” Kryeministri pyetet pse është tërhequr njohja nga Burundi, “nuk e di!” Kryeministri tregon se nuk ka asnjë informacion se çfarë po ndodh me Asociacionin e Komunave Serbe, prapë thotë “nuk e di!”

Të gjitha këto ndodhin para syve të një njeriu që ka ardhur në pushtet duke deklaruar se është njeri i vendimeve të mëdha, por nuk ka përgjigje as për kompetencat e veta. Këto ndodhin në Kosovë, në territorin e Republikës së Kosovës dhe kryeministri deklaron se nuk ka informacione. Nëse kryeministri i vendit nuk ka informacion dhe nëse kryeministri i vendit thotë se kushdo që inicion mocionin për rrëzimin e Qeverisë ai do t’i bashkëngjitet, unë i them kryeministrit, kryeministër mos fol se nuk e din.

Është më mirë ta përcaktojmë ne kohën kur të bije Qeveria, se sa të na tregosh ti, se me siguri një fjalë do ta thuash paradite e një tjetër pasdite, siç të ka ndodhur shumë herë prej kësaj foltoreje, kur ke deklaruar me fjalë të mëdha se nuk ndërron as pikë as presë, dhe e ka kaluar. Kur ke deklaruar se shumë gjëra të tjera do të ndodhin dhe ti do të jesh ai i prerjes, se do t’i shkarkosh ministrin e Punëve të Brendshme dhe shefin e AKI-së, ministri shkoi në shtëpi, sepse partia e çoi në shtëpi, për shefin e AKI-së, kemi mbetur duke e pyetur presidentin, edhe pse me kompetencë Kushtetuese i takon kryeministrit bashkë me presidentin ta marrin vendimin. Sot nuk e kanë guximin politik dhe njerëzor asnjëri prej tyre të na tregojnë se pse, edhe pse ligjërisht shefi i

AKI-së e ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sot ende nuk e kemi një lajm për shkarkimin e tij.

Mocioni i sotëm, në fakt Komisioni Hetimor duhet të vazhdojë dhe zinxhiri komandues i të gjitha ngjarjeve të 29 marsit duhet të përmbillet në atë se çka mund të themi më së thjeshti “ta shpëtojmë fytyrën e Republikës”. Më 29 mars Kosovës i janë hequr të gjitha atributet e republikës parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! S’ta ka përmendur emrin. Fitore Pacolli e ka fjalën. S’je Ramushi ti, Ramushin e ka përmendur, jo ty, të lutem!

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Në shkurt të këtij viti, Qendra Sociale “Sabota” i kishte organizuar disa aktivitete kulturore rreth çështjes kurde. Në natën e 9 shkurtit organizimi u pengua nga Policia. Tamam sikur në shtetet autoritare, Policia kishte urdhëruar që kjo qendër të bastiset pikërisht në natën kur nga qendra u dëgjuan tingujt e muzikës kurde. Cila ishte arsyeja dhe kush e kishte dhënë këtë urdhër për këtë bastisje, ende mbetet e paqartë.

Një muaj më vonë, pak ditë më parë, u rrëmbyen gjashtë shtetas turq, të cilët kishin leje të rregullt të qëndrimit. Askush nuk dinte se çfarë ndodhi, as familjarët e tyre nuk dinin gjë se nga kush u rrëmbyen dhe ku u dërguan. Si për çudi, as presidenti e as kryeministri nuk e dinin, të gjithë dolën kundër arrestimit, përfshirë edhe kryetarin e këtij Kuvendi. Të gjithë shprehën ndjenjën e zhgënjimit sesi institucionet tona shtetërore dështuan t’i mbrojnë të drejtat elementare të shtetasve turq. Ky veprim u tentua të përmbillet me shkarkimin e ministrit për Punë të Brendshme dhe shefit të AKI-së, të cilët paskan urdhëruar pa i përfillur procedurat ligjore rrëmbimin dhe deportimin e menjëhershëm të tyre.

Asnjë shtet evropian, përfshirë edhe SHBA-të, përveç Bullgarisë, nuk kanë ekstraduar apo deportuar shtetasit turq në Turqi, sikur Kosova. Kosova sot bëhet shteti i parë në Ballkan, i cili e bën një gjë të tillë. Presidenti turk ka kërkuar edhe nga SHBA-të, edhe nga shtetet evropiane, ekstradimin e shumë anëtarëve bashkëpunëtorë të Gylenit. Nga Greqia, për shembull, është kërkuar t’i ekstradojë tetë ushtarë dhe pilotë turq, por këtë e kishte refuzuar gjykata në Greqi. Njëjtë kanë vepruar Gjermania, Spanja e Kroacia. Siç po e shihni, çdo rast u është nënshtruar procedurave gjyqësore, ndryshe prej rastit të Kosovës. Kosova nuk është vendi i vetëm prej të cilit, pas grushtshtetit, presidenti i Turqisë ka kërkuar t’i dorëzojë shtetasit turq. Kosova është një ndër ato pak shtete, të cilat iu bindën kërkesës së Erdoganit për ekstradim të shtetasve turq. Malajzia dhe Arabia Saudite kanë vepruar në mënyrë të njëjtë sikur Kosova. Të gjitha rastet e ekstraduara nga Malajzia janë rrëmbyer, familjarët e të kidnapuarve me javë nuk kanë ditur për fatin e familjarëve të tyre. Deportimi i tyre në Turqi është bërë pa procedura gjyqësore.

Po e marrim si shembull rastin e Gjeorgjisë, ekstradimi i Mustafa Emre Çabuk është kërkuar nga Turqia nëntë muaj më parë. Tani, pas nëntë muajve, Gjeorgjia ende nuk e ka ekstraduar Çabuk. Gjeorgjia, e cila synon anëtarësimin në BE, u gjend para një situatë të vështirë, t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor, apo ta dorëzojë Çabuk për hir të ruajtjes së marrëdhënieve tregtare që ka me Turqinë, pra me partnerin kryesor tregtar. Në situatë paksa të ngjashme ka qenë edhe Kosova. Pra, Kosova e ka gjetur veten në një pozitë, të vendosë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimet e shtetit ligjor, apo të vendosë për interesat e Hashim Thaçit? Me veprimin e fundit, interesat e Hashim Thaçit mbizotëruan mbi parimet e shtetit ligjor, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Kosova si shtet që e synon anëtarësimin në BE dhe anëtarësimin në organizata tjera ndërkombëtare është dashur të vendosë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe në përputhje me parimet e shtetit ligjor. Në një shtet ku segmentet e caktuara të Policisë urdhërohen t'i ndalojnë aktivitetet kulturore të qytetarëve të vet, siç ishte rasti në Qendrën Sociale, dhe pastaj pa procedura gjyqësore rrëmbehen dhe deportohen shtetasit e huaj, nuk mund të quhet shtet demokratik. Këto veprime nuk u ngjajnë aspak shteteve demokratike. Këto veprime e cenuan demokracinë dhe shkelën të drejtat dhe liritë e qytetarëve brenda këtij vendi të garantuara me Kushtetutë.

Këto veprime tregojnë shumë. Tregojnë shumë për drejtimin që po e merr Kosova si shtet. Nga një demokraci parlamentare, Kosova ngadalë po rrëshqet drejt një sistemi autoritar. Me një president despotik e abuziv, Kosova sot është shndërruar në një shtet që po kidnapon njerëz dhe vendos se kujt t'i përgatitet dosje hetimi, e kujt jo. Kosova sot e ka një kryeministër, që po dirigjohet paligjshëm nga personi që mban postin e presidentit, nga personi që po fshihet tash e sa kohë pas posteve publike për dëmet që po i bën Kosovës. Kosova është shndërruar në një shtet, ku pushteti i ka nën kontroll institucionet e drejtësisë dhe mediet dhe nëpërmjet tyre po i manipulon qytetarët.

E për këtë gjendje nuk duhet të çuditemi ne deputetët e këtij Kuvendi. Shumë vendime të dëmshme kanë dalë nga po ky Kuvend. Historia e shkurtër e këtij Kuvendi njeh shumë deputetë, të cilët u nënshtruan dhe e shitën votën e tyre për përfitime personale, e shumë pak deputetë, të cilët bënë çmos që ta mbrojnë Republikën. Në këtë Kuvend, nëpërmjet dhunës dhe shtypjes së protestuesve u zgjodh ky president. Ky president u zgjodh edhe me votat e LDK-së. Ky Kuvend, në emër të liberalizimit të vizave, që ka pak gjasë të ndodhë sivjet, fali mbi 8 mijë hektarë tokë. Për këtë gjendje të krijuar nuk duhet të çuditen as politikëbërësit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe as ata të Bashkimit Evropianë, ngase për ta ruajtur stabilitetin e lejuan me vetëdije të lulëzojë këtë lloj autokracie. Në vend të fuqizimit të demokracisë fuqizuan dhe rritën autokratët dhe oligarkët.



Sigurimi i stabilitetit nëpërmjet tolerimit të këtij shteti abuziv e korruptiv po del të jetë tejet i kushtueshëm dhe i rrezikshëm. Oligarkët dhe autokratët që u lejuan të rriten dhe ta shtrijnë pushtetin e tyre në të gjitha shtresat e shoqërisë, sot për ta ruajtur këtë pushtet ata janë në gjendje që nëpërmjet krijimit të krizave të njëpasnjëshme t'i shkatërrojnë edhe këto pak gjëra të mira që i ndërtoam.

Ne si deputetë e kemi obligim të marrim vendime për të mirën e vendit tonë. E sot, vendimin më të duhur që mund ta marrim është shkarkimi i menjëhershëm i presidentit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sinqerisht nëse këtë debat nuk do ta përcillnim prej fillimit, ose ndonjë qytetar që e përcjell nëpërmjet medieve këtë debat dhe dëgjon diskutimin e deputetëve, mendon se është debat për zgjedhjen e presidentit, ose debat për punën e presidentit.

Ky debat është thirrur nga iniciuesi bazuar në një qëllim human, besoj kështu, sepse janë shkelur të drejtat humane dhe njerëzore të gjashtë qytetarëve të huaj, qytetarëve turq që kanë jetuar në Kosovë. Unë e di se ka këtu plot që nuk e duan presidentin, por ka edhe të atillë që e kanë votuar dhe besojnë shumë që presidenti e bën punën e tij mirë, ashtu sikur e ka bërë mirë kur në këtë foltore e ka shpallur pavarësinë e Kosovës.

Kërkesat tjera që adresohen këtu, mendoj se së pari duhet ta shikojmë këtë problematikë në aspektin ligjor, për çka besoj se të gjithë këtu jemi të shqetësuar - përgjegjësia ligjore dhe kushtetuese dhe cenimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Ne si shqiptarë dhe qytetarë të këtij vendi, që kemi vuajtur shumë dhe e kemi bartur në lëkurën tonë persekutimin dhe deportimin, nuk do të ishte i pranueshëm për asnjë bashkëvendës tonin, i cili në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian e ka gjetur strehimin e duhur në kohën kur kanë qenë të përndjekur nga organet pushtuese në Kosovë. Kjo është edhe më shqetësuese për ne dhe kjo e rrit edhe nivelin e përgjegjësisë më të madhe dhe interesin tonë më të madh për këtë çështje.

Shqetësuese është edhe mosgatishmëria e raportimit dhe mendoj se edhe ministri Sefaj përpara dorëheqjes do të duhej të raportonte, të paktën, në Komisionin Parlamentar për Siguri për gjithë operacionin, sepse është udhëhequr nga Policia e Kosovës, ne e kemi parë që Policia e Kosovës ka qenë pjesë e operacionit, e pastaj edhe drejtori i AKI-së gjithashtu raportimin e tij në Komisionin Parlamentar, sepse llogaridhënia duhet të jetë institucionale.

Jashtë asaj që ne mund të kemi paragjykitime, ose mendime, simpati, ose jo simpati për bartës të caktuar të institucioneve, këtu bartim edhe përgjegjësitë tona politike, por jashtë asaj ne jemi të

obliguar si deputetë të gjithë të jemi bashkë në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në këtë vend. Pra, kërkojmë llogaridhënie.

Unë më shumë do të doja që parashtruesi i kërkesës për këtë seancë, ndoshta më mirë ta adresonte një kërkesë, një raportim, sepse ligji e parashih edhe raportimin e drejtorit të AKI-së para deputetëve në një seancë të mbyllur, kur ne do t'i kishim informacionet e duhura dhe nëse në këtë rast nuk do t'i përgjigjej ftesës së deputetëve për një raportim, atëherë përgjegjësia do të ishte e adresuar drejt. Sigurisht se ai që nuk do të raportojë ka diçka për të fshehur dhe kot ne mund të adresojmë, ose dikush, për ambicie të caktuara, ose simpati ose jo simpati ndaj presidentit ta drejtojmë gishtin. Ju e dini shumë mirë që presidenti i vendit është një politikan i rryer dhe kot mundoheni të gjeni ndonjë gabim, sepse nuk e bën atë gabim presidenti i vendit. Ai e respekton Kushtetutën presidenti i vendit, nuk bën aso gabimesh presidenti i vendit. Kot e keni! Këto mbeten dëshira tuajat. Mbeten vetëm dëshira.

Por, ne po kërkojmë llogaridhënie për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut nga përgjegjësit. Nëse dikush atje ka marrë detyrë dhe përgjegjësi t'i bëjë ato veprime, ato shkelje le të mbeten përgjegjësia e tij, sepse përgjegjësia është edhe penale. Cenimi i rendit kushtetues të Kosovës, cenimi i sovranitetit, shkelja e Ligjit të AKI-së, shkelja e Ligjit për të huaj, çdo qytetari të këtij vendi i garantohet e drejta e ankesës, i cili ka aplikuar për leje qëndrimi, edhe nëse ajo leje qëndrimi refuzohet, ai ka të drejtë ankese.

Dhe, ne kemi parë në media se si janë depërtuar këta qytetarë turq. Ajo pika e kontrollit në aeroportin e Prishtinës nuk ka funksionuar, ajo është vijë kufitare, po nuk mund të akuzohen presidenti a kryeministri pse atje nuk e bën punën një polic, përgjegjësinë duhet adresuar dhe përgjegjësia vërtet kërkohet edhe në llogaridhënie.

Komisioni parlamentar ose Komisioni hetimor që kërkohet nga Parlamenti, edhe si Parti Demokratike e mbështesim, por si duke, nganjëherë këto debate a diskutime po anashkalohen nga qëllimi.

Ka shumë kërkesa këtu për zgjedhje, për rrëzimin e Qeverisë, para disa ditësh edhe vetë Vuçiqi kërkoi që Qeveria e Kosovës të rrëzohet, pasi Lista serbe u largua prej saj. D.m.th. pa Listën serbe nuk mund të funksionojë Parlamenti i Kosovës, as Qeveria, disa kërkesa ishin në atë frymë, në atë vijë me Vuçiqin.

Po a duam të dëshmojmë ne si spektër politik shqiptar që dimë të jemi unik për interesin e shtetit.

A dimë ne të dëshmojmë se kemi agjenda shtetërore, jo veç politike, partiake, kur të doni të shkojmë në zgjedhje, Partia Demokratike është e gatshme edhe t'i fitojë ato prapë qysh i ka fituar prej vitit 2007. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Kryesues,

Të nderuar kolegë,

Kohë më parë shumë nga ne, të rinj nga Kosova e lëshuan Kosovën nën kërcënimin e dërgimit të dhunshëm në ushtrinë e Jugosllavisë që në atë kohë kontrollohej nga Serbia.

Si të rinj ikën shteteve anembanë botës, ndoshta Serbia i cilësonte shumë prej neve si terroristë, kriminelë e dezertorë, sepse refuzuam t'i bashkohemi një ushtrie okupuese, terrorizuese e famëkeqe.

Shtetet që na u bënë amë e përkohshme dhe na dhanë strehim respektuan të drejtat tona elementare dhe refuzuan kërkesat e Serbisë që të na dorëzojë te ata që padrejtësisht kërkonin kokat tona.

Fatmirësisht këto shtete vepruan në përputhje edhe me atë që njihet si traditë jona shekullore. Traditë jona, ku edhe hasmit kur të hynte në konak i jepej besa për strehim dhe mbrojtje.

Kjo traditë mbijetoi edhe në kohët më të vështirë, përfshirë edhe mbrojtjen e brengave gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur shqiptarët dëshmuuan se janë popull që jetën e jepnin, por mikun nuk e dorëzojnë, sepse shtëpia e shqiptarit ishte e Zotit dhe e mikut, traditë që mbijetoi mbi shekuj dhe në kohë shumë të vështira. Por, me një veprim të vetëm u shkatërrua ditë më parë.

Gjashtë shtetas të Republikës së Turqisë me qëndrim të ligjshëm në Kosovë u rrëmbyen dhe u dëbuan nga Kosova nga persona që, sipas informatave, janë pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Këta përfaqësues të shtetit tonë, pa respektuar obligimet ligjore, duke shpërfillur tërësisht Kushtetutën, Konventën Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e njeriut dhe duke rrezikuar qenësisht Republikën dorëzuan pa respektuar asnjë procedurë shtetasit e Turqisë te disa njerëz që thuhet se janë agjendë të inteligjencës turke.

Unë sot nuk dua të paragjykoj fajësinë ose pafajësinë e qytetarëve të Turqisë, të cilët u rrëmbyen ditë më parë.

Në fakt, brenga ime kryesore nuk ndërlidhet fare me këta persona, brenga ime kryesore ndërlidhet me faktin se kjo ngjarje solli në sipërfaqe atë që kemi ditur që një kohë, e ajo është se për një njeri në këtë shtet nuk ekziston as Kushtetutë, as ligj, as institucione e as të drejtat e qytetarëve.

Thjesht, doli në pah se ky njeri mbizotëron, sundon dhe ka privatizuar institucionet kyçe të vendit, përfshirë edhe Policinë dhe AKI-në.

Ai dërgoi porosi të qartë për të gjithë ne, vendës e ndërkombëtarë, se ai është dirigjues faktik i Policisë, AKI-së e shumë institucioneve të vendit që janë të thirrura për të siguruar drejtësi e siguri, se ai mund të sjellë qetësi, por edhe kaos, se në mes të tij dhe synimit që ka, nuk ka as gjykata, as kryeministër, as Qeveri, e as institucione të pavarura, asgjë, se ai është urdhërdhënësi i parë dhe i fundit për të gjithë, pa kufizime.

Qytetarë të nderuar,

Kushtetuta e Kosovës garanton ndarjen e pushteteve në Republikën e Kosovës, paraqet një udhërrëfyes të qartë për të gjitha institucionet e vendit se cilat janë kompetencat, por edhe cilat janë kufizimet e tyre, së paku ashtu thotë në letër.

Ligji për AKI-në thotë qartë se ky institucion nuk ka kompetenca ekzekutive. Pra, kompetencë ka vetëm për të mbledhur informata dhe për t'ua afruar këto informata institucioneve përkatëse, për çdo verim përtej kësaj, i nevojitet leje nga gjykata.

Dhe, neni 129, pika 4 e Kushtetutës obligon AKI-në që të njëjtat informata t'ua dorëzojë edhe presidentit, edhe kryeministrit. Kjo nuk ka ndodhur, që është konfirmuar edhe nga vetë kryeministri.

Kush po jep përgjegjësi për këtë? Presidenti po thotë askush.

Për më tepër, Policia e Kosovës, me gjasë, ka marrë urdhër ose nga presidenti ose nga AKI. As presidenti, sipas nenit 84 të Kushtetutës, e as AKI nuk kanë të drejtë t'i japin urdhër Policisë. Aq më pak, kur procedurat nga Ligji për të huajt që garantojnë mbikëqyrjen nga gjykata kompetente për refuzim ose tërheqje të lejes për qëndrim, nuk janë përfillur.

Në fakt, nëse shikohet nga ana tjetër, as Policia nuk guxon të zbatojë urdhra të jashtëligjshëm.

Neni 13, pikat 2 dhe 3 të Ligjit për Policinë, thonë specifikisht, pra ky është parim që daton nga gjykimet e Nurenbergut.

Zyrtari policor ka për detyrë t'i refuzojë urdhrat e paligjshëm dhe të raportojë për këtë menjëherë në pajtim me aktet nënligjore.

Zyrtari policor nuk do të shkaktojë, të nxisë, të mbështesë ose të tolerojë asnjë akt të torturës, të degradimit ose të trajtimit çnjerëzor në çfarëdo rrethanash, ndërsa asnjë rrethanë e jashtëzakonshme apo urdhër i lëshuar nuk do ta arsyetojë veprimin e tillë.

E Polica e bëri pikërisht të kundërtën, pra pse nuk e ka refuzuar një urdhër të tillë Policia që ka ardhur jashtë zinxhirit të qartë komandues të Policisë ose nga gjykata dhe që qartazi shkel të drejtat elementare të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Në fakt, pse drejtori i Policisë nuk tregon se kush i ka dhënë urdhër të veprjës kundërligjshëm, sepse këtë urdhër nuk ia ka lëshuar as gjykata, e as ndonjë institucion tjetër i autorizuar nga Kushtetua apo ligji.

Si mund të jetë përgjegjës ministri i Punëve të Brendshme, sepse kinse paska qenë i përfshirë, ndërsa ai që ka urdhëruar varësit e tij për të zbatuar këtë urdhër të jashtëligjshëm, në kundërshtim me Ligjin për Policinë, të mbetet në pozitë?

Për më tepër, edhe sikur dëbimi të bëhej pas një procedure të ligjshme dhe leja e qëndrimit të revokohej dhe ankesa e tyre të refuzohej nga gjykata kompetente, a nuk është dashur që këta persona të dorëzohen te kufiri i parë. Në bazë të çfarë ligji apo procedure i dorëzohen këta persona një shtetit tjetër më të largët përmes një aeroplani privat, e jo te kufiri më i afërt.

Të them të drejtën, do të më duhej kohë e gjatë të listoj të gjitha dispozitat kushtetuese dhe ligjore që janë shkelur gjatë zbatimit të këtij urdhri të presidentit.

Besoj që deri tani po shihet qartë se nuk bëhet fjalë këtu për veprime nga njerëz të përgjegjshëm që respektojnë Kushtetutën, ligjin apo të drejtat e qytetarëve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po flitet se këta qytetarë paskan rrezikuar shtetin, disa po thonë se ata janë kriminelë, ndërsa të tjerët po i vlerësojnë si njerëz të mirë.

Po ne nuk jemi të thirrur për të dhënë vlerësim për këtë, sepse si instancë e fundit dhe neutrale i kemi gjykatat për këtë punë. Pra, për qytetarët e dëbuar, por edhe për gjithë ne të tjerët, kemi gjyqësorin që garanton që të drejtat tona elementare të zbatohen dhe të respektohen në tërësi, përfshirë edhe procedurat e parapara me ligj.

Kjo nuk ka ndodhur këtu, sepse me paramendim dhe me dashje disa persona, e njëri nga ata në veçanti, kanë cenuar rrënjësisht bazat e Republikës, të ardhmen e vendit, Kushtetutën dhe ligjet që obligojnë ata persona. Thjesht, kanë treguar zanafillën e një puçi dhe për këtë duhet të japim përgjegjësi jo vetëm para qytetarëve, por edhe para historisë.

Qytetarë të dashur,

Po shihet qartë se këtu nuk ka pasur as dëbim e as ekstradim, sepse këto janë të gjitha procedura ligjore.

Nuk ka pasur përfillje të procedurave as gjyqësore, as ligjore, as kushtetuese e as ndërkombëtare, në bazë të instrumenteve ndërkombëtare apo të marrëveshjes me Turqinë.

Në fakt, kjo çështje nuk ka të bëjë fare as me Turqinë, një shtet mik që ka mbështetur shumë herë Kosovën, kjo çështje ka të bëjë me ne dhe me fatin e vendit tonë. Me faktin që këtu ka pasur shkelje të të drejtave elementare të njeriut me vendim të kreut të shtetit.

Në Republikën e Kosovës shkelen çdo ditë të drejtat e njeriut, por kjo dallon dukshëm, kjo është diçka shumë më serioze, ka pasur kidnapim dhe dorëzim të një shtet tjetër të personave që qëndronin ligjshëm në Kosovë nën urdhrin e presidentit të vendit për qëllime që i dinë vetëm ai, sipas një marrëveshje private, kushtet e të cilës i di vetëm ai.

Një pjesë e përgjegjësive për të vepruar natyrisht bie mbi ne si Kuvend i Republikës së Kosovës.

Por sikur të ishte Qeveria këtu, në krye me kryeministrin, do ta bëjë një pyetje për të. A dëshironi të hyni në histori si kryeministri që gjatë mandatit të tij lejoi shndërrimin e Kosovës në një shtet diktatorial? A keni kurajën që ta sfidoni një person të tillë dhe të ballafaqoheni me këto rrethana fatkeqe?

E di që nga themelimi i kësaj Qeverie të lodhtë keni pasur problem me numra dhe mbështetje në këtë Kuvend, por po ju garantoj që nëse vendosni ta mbronin Republikën dhe Kushtetutën, kërkon përgjegjësi për këtë veprim antikushtetues nga të gjithë aktorët, pa diskriminim, po veçanërisht nga presidenti, atëherë mos ke drojën fare, se nuk do t'ju lëmë vetëm, do të na kesh mbrapa në çdo hap për t'i shkuar kësaj pune deri në fund. Në të kundërtën, ditët janë të numëruara edhe për ju, por edhe për ne si Kuvend, se bashkë me presidentin, edhe neve do të na zhduket edhe ata pak legjitimitet që na ka mbetur para qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është te Shemsi Sylja.

SHEMSI SYLA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës botës dhe qytetarëve të Kosovës u dhamë shembullin më të keq si qeverisjet ky vend, si abuzohet me pozitën dhe postet shtetërore, si shkelen ligjet e Kushtetuta e këtij vendi dhe, çka është më e keqja, liderët institucionalë treguan se sa i rëndësishëm është shteti që ta udhëheqin me agjendat e tyre personale.

Të nderuar deputetë,

Kosova është një vend i cili ka një Kushtetutë, përmes të cilës është dizajnuar shteti dhe rendi juridik e institucional. Kemi dy shkallë të pushtetit, të cilat lehtësojnë shumë menaxhimin dhe

ndërtimin e një shteti funksional, por qeverisja e keqe, kapja e shtetit nga politika dhe parapolitika e ka bërë funksionimin institucional tejet të ndërlikuar.

Ky mish-mash shtetëror dhe kjo përzierje e ndërhyrje e kompetencave e ka shndërruar Kosovën në një vend të rrezikshëm për qytetarët e saj, për këdo që vepron në Kosovë në secilën fushë dhe ka krijuar një dilemë të madhe të partnerët tanë dhe sa i takon përcaktimit të saj drejt demokracive bashkëkohore.

Rasti më i fundit i gjashtë qytetarëve turq të dëbuar dhe të kidnapuar, gjashtë pedagogë dhe arsimtarë, të cilët edukuan breza të tërë në shkollat tona, vërtetojnë më së mirë shkeljen në themel të demokracisë.

Pas votimit të Ligjit për të demarkacionin me Malin e Zi, në Kosovë ka filluar një betejë politike ndërmjet kryeministrit dhe presidentit.

Me gjasë, presidentit nuk i duhet më Ramush Haradinaj kryeministër dhe po kërkon partner tjetër politik për ta përmbyllur kërkesën ndërkombëtare që ka të bëjë me marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Kurse kryeministri këto ditë është sprovuar me një lloj gjysmë puçi për të rrëzuar Qeverinë, sepse në rrethana normale, kur ministrat e Kabinetit qeveritar nuk e njoftojnë kryeministrin e tyre për veprimet që e cenon edhe rendin kushtetues e juridik, kryeministri është praktikisht i rrëzuar dhe dorëheqja është e paevitueshme. Por tek ne kjo nuk mund të ndodhë, sepse përgjegjësia ndaj institucioneve dhe ndaj shtetit në krahasim me pasionin dhe dëshirën për të qenë në pushtet është e pakrahasueshme.

Të nderuar deputetë,

Beteja politike kryeministër-president tash e tutje vetëm sa do të thellohet. Ne si deputetë të këtij Kuvendi duhet t'i përgjigjemi kësaj situatë. Një person si presidenti Hashim Thaçi nuk mund të jetë president i besueshëm i Republikës së Kosovës, ai nuk garanton me asnjë element të funksionimit që i parashihet, ndërsa kryeministri ka humbur plotësisht fuqinë ekzekutive.

Kush na garanton se ne si Kuvend që sërish drejtori i Policisë, Shpend Maxhuni, së bashku me presidentin Hashim Thaçi nuk ndërmarrin ndonjë operacion tjetër jashtë linjës institucionale, e në dëm të Kosovës.

Kryeministri aktual tanimë nuk mund të jetë garantues për këtë, sepse ai tashmë ka kërkuar shkarkimin e kreut të AKI-së dhe presidenti nuk e ka dhënë një miratim të tillë.

Nuk mund të ketë dy lexime për këtë çështje, pra nëse kryeministri e presidenti nuk pajtohen që drejtori i Policisë dhe drejtori i AKI-së e kanë shkelur rëndë ligjin, atëherë kjo nuk është gjë tjetër veç se dalje prej funksionimit të shtetit.

Fillimisht ky Kuvend, siç theksuan edhe shumë deputetë sot, duhet të formojë një Komision hetimor parlamentar që do të hetojë këta dy drejtues institucionalë.

Konform të gjeturave, ky Kuvend duhet të veprojë urgjentisht. Ne jemi para një sprove të madhe, në një krah veprime jointucionale në raport me presidentin e Serbisë të presidentit të Kosovës, në krahun tjetër, veprime arbitrare të presidentit të Kosovës me rendin kushtetues të Kosovës.

Është koha që ky Kuvend të marrë sa më parë masa. Tash është vonë, dëmet kanë meritur kulmin dhe nuk ka rrugë tjetër përpos se t'i ndalim këto që t'i ndalim edhe dëmet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë dua që kryetarët e grupeve parlamentare, bashkë me zoti Hoti, të shkojnë për të harmonizuar tekstin e rekomandimeve që i kanë që duhet t'i votojmë dhe them që në orën 20:20 deri në 20:30 duhet të bëhet votimi, prandaj duhet t'i thirrni deputetët që të vijnë në sallë për të votuar.

Fjalën e ka Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi dëshmitarë të një prej rasteve më eklatante të ikjes së përgjegjësisë nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe kjo do të thotë edhe injorim i tërësishëm i çështjes, do të thotë edhe injorim i tërësishëm i çështjeve që ata vetë po i identifikojnë si të lidhura me sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës, do të thotë injorim i tërësishëm i Kushtetutës së vendit dhe i dispozitave, nëpërmjet të cilave ne e kemi marrë përsipër t'i mbrojnë të drejtat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Para pak javësh në këtë Kuvend, duke folur për strategjinë e zgjerimit të BE-së lidhur me Ballkanin Perëndimor, kam theksuar se aty me të drejtë thuhet që liderët e Kosovës nuk duhet të lënë asnjë dyshim se orientimi i tyre strategjik është Bashkimi Evropian, pra është bota properëndimore.

Dhe si dëshmohet ky orientim strategjik? Vetë ai dokument i BE-së thotë se duhet të dëshmohet duke përqaftuar, duke ruajtur dhe duke mbrojtur vlerat evropiane.



Një përkujtim për zotin Thaçi, shkelësin e Kushtetutës, që përveç shumë dispozitave që u përmendën nga kolegët më herët, ta shikojë edhe nenin 53. Ai e di shumë mirë, sepse ka qenë edhe një ndër aktorët e përfshirë në procesin e hartimit të Kushtetutës, pse ky nen është futur në Kushtetutë.

Për një qëllim të vetëm, që Kosova të dëshmojë se është me vlerat evropiane, e jo të tjera, duke marrë përsipër që të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, pra edhe ai vetë dhe institucioni që përfaqëson, do të marrin parasysh në vendimet e tyre për të drejtat e njeriut vendimet e Gjykatës Evropiane, e njohur ndryshe edhe si Gjykata e Strasburgut.

Dhe çfarë ka thënë Gjykata e Strasburgut për raste të ngjashme sikur kjo, me të cilën po ballafaqohemi ne.

Janë së paku dy raste kundër Anglisë dhe dy raste kundër Italisë, ku gjykata ka qartësuar se edhe në qoftë se shteti ka dyshime lidhur me veprimtarinë e shtetasve të huaj dhe se ajo veprimtari mund ta rrezikojë sigurinë kombëtare, atëherë duhen të gjenden mjetet alternative për luftimin e këtyre veprimtarive, e jo të shkohet me deportim apo dëbim të tyre, apo edhe në rastin më të keq, kidnapim, siç ka ndodhur para pak ditësh në Kosovë.

Nëpërmjet këtyre veprimeve të institucioneve të Kosovës janë shkelur vlerat më sublime për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat Republika e Kosovës me vullnet të plotë dhe pa iu imponuar nga askush i ka marrë përsipër t'i aplikojë dhe t'i mbrojë jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe për gjithë ata që ligjshëm qëndrojnë në Kosovë, siç ka qenë rasti me gjashtë shtetasit turq.

Tash shkarkimi i disa zyrtarëve të lartë aspak nuk i shfajëson ata nga përgjegjësia që mund të kenë dhe kanë, në fakt, për dëmin që është shkaktuar nëpërmjet kësaj ngjarjeje.

Edhe një herë duhet t'i bëjmë thirrje prokurorit të Kosovës, kryeprokurorit, që të bëjë hetime të pavarura, në qoftë se ka elemente të veprës penale në këtë rast.

Por mbi të gjitha, Kuvendi i Kosovës duhet t'i bëjë thirrje edhe udhëheqësit të AKI-së, edhe ish-ministrit të Brendshëm, zotit Gashi dhe zotit Sefaj, sepse ata kanë obligim ndaj këtij shteti të tregojnë se kush u dha urdhër, përndryshe, në qoftë se mbajnë informacione të tilla sekret, në qoftë se u japin vetëm partitë e tyre mediave të caktuara, me të cilat kanë lidhje, atëherë nuk do ta bëjnë vetëm veten kurban, por do ta bëjnë edhe shtetin e Kosovës të tillë.

Unë mendoj që kushdo që sot brenda Kosovës e interpreton çdo kritikë tonën të drejtë në raport me shkeljet procedurale që janë bërë në këtë rast, si veprim që dëmton raportet me Turqinë, e ka shumë gabim dhe pikërisht ata njerëz që thonë kështu, janë ata që synojnë nëpërmjet shkaktimit

të krizave të njëpasnjëshme në këtë vend të dëmtojnë raportet me secilin shtet mik që deri sot na ka mbrojtur, na ka përkrahur, siç është rasti edhe me Turqinë pas shpalljes së pavarësisë, meqë ka qenë një prej shteteve të para që e ka njohur Republikën e Kosovës dhe edhe sot na ndihmon që të mbrojmë të drejtat e Kosovës në organizata ndërkombëtare, ku ne kemi synim të anëtarësohemi.

Pra, ato që ne sot themi si Kuvend i Kosovës janë kritika me vend për mospërputhje me procedurat, me dispozitat kushtetuese dhe, mbi të gjitha, siç e thashë, me vlerat evropiane, të cilat Republika e Kosovës do të duhej t'i ndiqte.

Për informatën e këtij Kuvendi, në cilësinë e kryetares së Komisionit për Punë të Jashtme, unë kam ftuar ministrin e Jashtëm që të raportojë, meqenëse kjo ngjarje ka të bëjë edhe me shtetas të huaj, natyrisht edhe siç kam pritur ai nuk është përgjigjur, përfshirë edhe në ftesën e sotme. Ftesa do të përsëritet dhe shpresoj shumë që edhe nëpërmjet rezolutës që sot do të miratohet, do të nxiten ministrat t'i respektojnë obligimet e tyre kushtetuese që të raportojnë para deputetëve.

Si përfundim, të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kur lufta jonë gjithëpopullore kundër regjimit gjenocidal serb kishte filluar para disa dekadash, ajo luftë e popullit tonë triumfoi për shkak se ishte bazuar në vlera civilizuese, në vlera properëndimore, në vlera evropiane.

Sot, 20 vjet pas, një njeri, për teket e veta personale, po tenton t'i gjuajë të gjitha këto vlera në ujë, të gjitha këto vlera të popullit tonë, të sovranit, të cilin ne e përfaqësojmë. Po pikërisht sot Kuvendi i Kosovës duhet t'i thotë jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Kohët e fundit në Kosovë po ndodhin gjëra misterioze, në kuptimin që autorët e ngjarjeve të dëmshme për vendin po e hedhin gurin e po e fshehin dorën. Në dhjetor të vitit të kaluar, pa paralajmërim dhe as diskutim të nevojshëm u iniciua tërheqja e Ligjit për Gjykatën Speciale, pikërisht nga ata që para dy vjetëve bënë çmos për ta kaluar atë ligj. Kjo iniciativë, e motivuar për hesape personale, nuk kaloi, autorësia nuk u pranua, edhe pse autori dihej.

Në mars të këtij viti, në pjesën veriore të vendit, zyrtari i lartë i Serbisë, Marko Gjuriq, e kaloi kufirin ilegalisht dhe kështu ra në kundërshtim me ligjet në fuqi të Kosovës. Reagimi i Policisë së Kosovës ka qenë një reagim i ligjshëm, reagimi u dukej i padrejtë disa deputetëve, jo se nuk ka pasur shkelje, jo se nuk ishte i ligjshëm, por sepse shkelje të këtilla nga zyrtarët e lartë të

Serbisë në të kaluarën kanë ndodhur shpesh, por institucionet e Kosovës dhe individë të caktuar në këto institucione këto shkelje i kanë toleruar, me arsyetimin se duhet të ruhen raportet e mira me Serbinë e të mos pengohet procesi i dialogut, që ka legjitimuar ndërhyrjen e Serbisë në organizimin e brendshëm të Kosovës, në legalizimin e strukturave serbe në të gjitha nivelet dhe në të gjitha pushtetet në Kosovë, deri te zëvendëskryeministri, ministrat dhe deputetët që vijnë nga Lista serbe, e që nuk përfaqësojnë interesat e qytetarëve serbë në Kosovë, por përfaqësojnë politikën hegjemoniste të Serbisë karshi Kosovës.

Deputetët që sot këtu vajtuhan për gjoja shkeljen e të drejtave të njeriut, e që e ka dhunuar shumë herë sovranitetin e vendit, të atij vendi që i paguan këta deputetë, madje ua paguan edhe rrymën elektrike që e shpenzojnë nëpër shtëpitë e tyre. Këta deputetë asnjëherë nuk janë brengosur për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës, të cilët ka kohë që nuk po mund të flenë të qetë nga aeroplanët luftarakë të Serbisë që po fluturojnë mbi çatitë e shtëpive të tyre dhe shumë shkeljeve të tjera elementare që po i përjetojnë shqiptarët atje.

Këta deputetë asnjëherë nuk e kanë ngritur zërin kundër angazhimit të Serbisë në disa vende të Afrikës, me qëllim të tërheqjes së njohjes së pavarësisë së Kosovës, sepse një gjë të tillë nuk po e bëjnë as përfaqësuesit shqiptarë në bisedimet në Bruksel. Në këtë rast, e pazakonshme ishte vetëm angazhimi i një numri aq të madh të policëve në pjesën veriore, kur një gjë e tillë në një vend normal do të ndodhte me 2-3 policë dhe ne askush nuk e di se kush e urdhëroi Policinë të mobilizohet në atë mënyrë dhe të shkojë në veri.

Deportimi i gjashtë qytetarëve të Turqisë nga Kosova, pa respektimin e procedurave të parapara me ligj, është shkelje e procedurave dhe ligjeve të Kosovës, pavarësisht se a janë ata qytetarë terroristë apo qytetarë të ndershëm, ligjet duhet të respektohen, sepse edhe kur persona të caktuar mund të jenë të rrezikshëm për një vend, ligji edhe atëherë duhet të respektohet. Prandaj, është obligim i institucioneve dhe shoqërisë në këtë vend që të identifikojë shkelësit e ligjit dhe t'i vendosë para përgjegjësisë.

Në këtë vend duhet të ndërpritet praktika e hedhjes së gurit dhe fshehjes së dorës. Urdhërdhënësit për secilin rast që u përmend duhet të identifikohen, kërkesa për respektim të ligjit dhe zbatim të tij nuk mund të interpretohet si dëmtim i marrëdhënieve në mes të dy shteteve tona, pra të Kosovës dhe të Turqisë, që janë tradicionalisht të mira dhe kështu do të mbesin, pavarësisht se ne kërkojmë që ligjet në Kosovë të respektohen qoftë edhe për qytetarët e Turqisë. Për këto shkelje hetimet duhet të ndodhin, fajtorët duhet të japin llogari. M'u duk interesante oferta e LDK-së për bërjen bashkë dhe angazhimin për ta rrëzuar presidentin e vendit, por nuk e di sa është e besueshme kjo ofertë kur e kemi parasysh marrëveshjet që LDK me Thaçin i bëri qoftë në vitin 2014 për të hyrë në pushtet dhe hoqi dorë nga marrëveshja e nënshkruar muaj më parë me tri subjekte të tjera politike, qoftë votën që ia dha të njëjtit në vitin 2016, në këmbim të vazhdimin të

pushtetit, por edhe hezitimin e LDK-së në vitin 2017 për të bërë koalicion dhe kështu e ndihmoi edhe krijimin e kësaj qeverie që sot po e kritikon dhe po angazhohet ta rrëzojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryesues!

Kryesisht u thanë të gjitha, unë si duket jam i parafundit, vetëm një rikapitulim shkurt, më shumë nga pozicioni i anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së.

Qëllimi kryesor i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e AKI-së është që të mbahet organizata e përgjegjshme për politikën dhe veprimet e saj, sa i përket ligjshmërisë, drejtësisë dhe efikasitetit. Për të mbajtur të përgjegjshëm AKI-në, ne si komision do të duhej të kemi informacion mbi punën e kësaj organizate dhe në bazë të këtij informacioni, të përfshihemi në dialog me AKI-në dhe në fund të nxjerrim gjetjet dhe rekomandimet. Pa këto tri kompetenca, nuk mund të ketë llogaridhënie të vërtetë dhe mbikëqyrja e inteligjencës ka gjasa të dështojë. Mbikëqyrja nuk e ndërthet vetëm drejtësinë dhe ligjshmërinë e aktiviteteve të AKI-së, por edhe nëse veprimet e saj janë moralisht të justifikueshme. Në fund, dua të ndaj me ju vlerësimin tim se, edhe pas dy përpjekjeve për të komunikuar me zyrtarët e AKI-së në lidhje me operacionin e saj ndaj gjashtë qytetarëve turq, nuk kemi arritur që të sigurojmë informatat, nga fakti se drejtuesit e AKI-së nuk janë llogaridhënës ndaj komisionit dhe Parlamentit të Kosovës.

Pa pasur dëshirë që të paragjykoj për arsyeshmërinë e operacionit të AKI-së dhe në pamundësi që si anëtar i komisionit parlamentar të mbikëqyrim punën e AKI-së, mendoj se i vetmi instrument ligjor parlamentar për të nxjerrë të vërtetën për operacionin e AKI-së dhe organizatat e tjera, të përfshira në dëbimin e qytetarëve turq, është ngritja e Komisionit për hetim parlamentar sipas Ligjit për hetim parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Tashmë u bisedua gjatë gjithë ditës për këtë temë kaq të rëndësishme dhe ka pothuajse një javë që nga dita e rrëmbimit të gjashtë qytetarëve turq me të drejtë qëndrimi në Kosovë, që po flitet për këtë skandal, duke shprehur një indinjatë dhe duke u kundërshtuar ashpër nga qytetarët gjithandej, ashtu edhe sikurse nga zyrtarët e lartë të BE-së.

U kritikua ky kidnapim i qytetarëve, shkelja flagrante e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ligjeve edhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu si edhe konventave ndërkombëtare. U fol edhe nga personat me pozita kyçe në vendin tonë, jo më pak se nga krerët e vendit, por nga

këta dëgjuam kryesisht deklaratat për mosinformim për këtë vepër. Përderisa edhe kryeministri i vendit deklaroi se nuk ka qenë i informuar fare për këtë dhe duket se është e vërtetë kjo deklaratë e tij, madje ai deklaroi se as procedurat që u kryen më herët, si kryerja e hetimeve dhe marrja e vendimit për një bashkëpunim me një agjenci të inteligjencës së një shteti tjetër, nuk ishte i informuar. Pamë edhe një konferencë për media nga vetë presidenti i vendit, i cili në vend se të sqaronte këtë skandal dhe të njoftonte qytetarët se sa më parë do të merren të gjitha masat për të zbuluar dhe për të vënë para përgjegjësisë personat që urdhëruan këtë kidnapim, foli për të mos thënë asgjë.

Në fakt, ai e arsyetoi kidnapimin e shtetasve turq pa e treguar se çfarë krimesh paskan bërë ata, për më tepër, refuzoi lirin nga detyra e shefit të AKI-së, duke kundërshtuar kështu zotën Ramush Haradinaj, i cili pati thënë se shefi i AKI-së tashmë është shkarkuar, pra kërkoi lirin e tij nga detyra. Për më shumë, presidenti i vendit e shfrytëzoi konferencën për media për të shpifur ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe duke shpifur e hedhur akuza të pabazuara për një subjekt politik dhe për kryetarin e këtij subjekti, ai shkeli edhe Kushtetutën e vendit. Andaj, edhe po shfrytëzoj rastin që të ftoj tani kolegët deputetë nga LDK-ja dhe të tjerët që e kërkuan shkarkimin e Thaçit që për shkeljen e fundit të tij kushtetuese, pra për mostrajtim të njëjtë të subjekteve politike, ta dërgojmë bashkarish në kushtetuese.

Sot foli ministri i Drejtësisë për ekstradimin dhe rikonfirmoi se nuk ishte ekstradim dhe se nuk ishte përmbushur asnjë obligim ligjor në këtë rast. Duke u munduar kështu të largojë përgjegjësitë nga vetja, në fakt, ai vetëm se e vërtetoi se sa shumë shkelje janë bërë. Tashmë duket se AKI-ja ka bashkëpunuar me Agjencinë Inteligjence të Turqisë dhe për këtë nuk janë respektuar procedurat ligjore, andaj edhe për këtë sabotazh dhe rrezikim të sovranitetit të shtetit të Kosovës nuk mjaftojnë vetëm shkarkimet e ministrit, si të atij të Punëve të Brendshme, ministrit të Drejtësisë, drejtorit të AKI-së, drejtorit të Policisë, por duhet një hetim i menjëhershëm dhe masa ndalimi për ta. Kjo do të ndodhte në secilin vend vërtet demokratik dhe kjo është më e pakta që duhet të kërkojmë.

I përmendën kolegët shumicën e ligjeve, por dua vetëm të sjell shkurtimisht në vëmendje se Ligji për të huajt, në nenin 6 e përcakton se si bëhet revokimi apo refuzimi i lejeqëndrimit për rrethana të sigurisë shtetërore. Parashihet se në rast të refuzimit apo revokimit të lejeqëndrimit të një të huaji për arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, mund të lëshohet vendimi pa arsyetim lidhur me rrethanat për të cilat është nxjerrë ky vendim, por i huaji ka të drejtë ankese në gjykatën kompetente, gjë që nuk iu mundësua shtetasve që u kidnapuan më 29 mars. Ndërsa, sipas Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, për transferimin e personave të dënuar në bazë të urdhrave për deportim apo dëbim, ministria mund të japë pëlqim për transferimin e personit të dënuar edhe pa pëlqim të tij apo të saj, por vetëm kur iu është shqiptuar urdhri për dëbim apo deportim për ndonjë masë tjetër, sipas të cilit personi nuk lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Kosovës, pasi që ai apo ajo të lirohet, gjë që ministri i Drejtësisë na njoftoi se nuk

e ka bërë. Po ashtu, sipas të njëjtit ligj, ministria mund të lejojë transferimin vetëm pasi të jetë njoftuar me mendimin e personit të dënuar.

Por, për asnjërin nga gjashtë qytetarët e kidnapuar dhe për aq sa e dimë, të deportuar pa asnjë procedurë me aeroplanë të një shteti tjetër, nuk u dha mundësia e shprehjes së tyre dhe lë më mundësia e ankesës. Së paku dy nga gjashtë të kidnapuarit u morën me dhunë në oborrin e shkollës në Gjakovë, para nxënësve dhe kolegëve të tyre. Duhet përmendur se këto shkolla janë licencuar nga Ministria e Arsimit, madje sa më kujtohet, në Prizren hapja e shkollës “Mehmet Akif” ishte bërë me insistimin e vetë Ambasadës Turke, e cila kishte ndërhyrë për sigurimin e lokacionit dhe për këtë ka edhe një kontest gjyqësor tashmë në Komunën e Prizrenit, madje edhe ministri i cili tani nuk është i pranishëm këtu, e i cili hodhi akuza për mësimdhënësit e depërtuar, duke i quajtur “terroristë”, e kishte prerë shiritin inaugurues në hapjen e shkollës në Prizren.

Këta mësimdhënës kanë edukuar fëmijët tanë, pra të rinjtë e Republikës së Kosovës. Madje, edhe vetë djalin e presidentit. Atëherë, nëse presidenti i vendit deklaroi se ata mësimdhënës ishin “terroristë”, sa kohë më parë ai e ka ditur këtë çështje? Dhe, si ka lejuar që ata të qëndrojnë afër dhe të edukojnë fëmijët tanë në shkollat e licencuara nga Ministria jonë e Arsimit. Pa dashur të paragjykoj fajësinë ose pafajësinë e tyre, dua të cek fare në fund se nuk mendoj dhe as që kam për qëllim që të përfshihem në konfliktin që ekziston në Turqi, por që përgjegjësia jonë është të kujdesemi për funksionimin e rendit e ligjit në vendin tonë.

Beteja në Turqi duket se do të vazhdojë edhe për një kohë, por ajo nuk është puna jonë. Ne nuk kemi pse të përfshihemi në këtë betejë të dy taborëve që ekzistojnë atje, por ne kemi problem me vendimmarrësit tanë. Kemi problem me këta pushtetarë që shkelin Kushtetutën e ligjet tona me vetëdije, andaj edhe nuk mund të presim as t'i brejë ndërgjegjja ata. Çështjet që ne duhet t'i trajtojmë me seriozitet dhe me urgjencë është, e përmendën edhe disa nga kolegët deputetë, se kush janë personat përgjegjës që e shkaktuan këtë skandal? Kush urdhëroi dhe mori vendim për rrëmbimin e qytetarëve turq, duke shkelur kështu të drejtat themelore të njeriut? Me çfarë të drejte nuk i përgjigjet drejtori i AKI-së tri herë radhazi komisionit parlamentar, e anashkalon detyrën e tij ligjore për të informuar kryeministrin e vendit dhe vazhdon punën, përkundër kërkesës të kryeministrit për të liruar atë detyrë.

Tani dëgjuam edhe nga deputetja Osmani për mospërgjigjen e ministrit në ftesën e saj si kryetare e komisionit, por e shohim se edhe për këtë debat nuk pati asnjë respekt dhe përgjegjësi nga përfaqësuesit e Qeverisë. Si duhet vepruar tutje me këta njerëz të papërgjegjshëm, të korruptuar dhe aventurierë që për interesa personale vënë në rrezik sigurinë e vendit, obligimet kushtetuese dhe aleancat shtetërore? Andaj, ky Kuvend dhe secili prej nesh duhet të ndërmarrim të gjitha veprimet e domosdoshme që kjo situatë të përfundojë sa më parë, mungesa e llogaridhënies dhe e përgjegjësisë duhet të marrë fund një herë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Po munguaka Kabineti qeveritar dhe shefi i Qeverisë, i cili është ftuar të jetë prezent në këtë debat që konsideroj që këto 18 vjetët e fundit në liri e ka lyer me ngjyrë të zezë edhe shtetin tonë të ri, edhe këtë tempull të demokracisë, edhe neve si të zgjedhur të popullit, por komplet në veçanti institucionet e shtetit “të pavarur” të Kosovës.

Dhe, tani në vend që ne si deputetë, si të zgjedhur të popullit të diskutonim për tema zhvillimore, për reforma në sektorë strategjikë, të bisedonim për projekte në interes nacional dhe të zhvillimit të këtij shteti, ky lidërsip, këta tre liderë institucionalë na vënë në sprovë edhe traditat tona, edhe qasjen dhe orientimin demokratik dhe properëndimor, edhe vlerat e këtij populli që disa prej këtyre virtyeteve i kemi traditë historike dhe jemi krenuar me to. Ngjarja e 29 marsit tregon për brishtësinë e shtetit të Kosovës sa e cenueshme është Kushtetuta dhe kushtetutshmëria e Kosovës, sa i cenueshëm është rendi kushtetues dhe siguria nacionale në Kosovë dhe tani po e them me një ironi satirike, paramendoni sikurse ai aeroplan i shërbimit sekret të ishte aeroplan i shërbimit sekret rus ose iranian dhe paramendoni po t’i kidnaponin këta tre liderë institucionalë, emëruesi i përbashkët do të ishte, do të ishte çliruar ky vend dhe ky popull.

Nga këta njerëz që e kanë vrarë edhe shpresën e fundit të këtij populli dhe të rinisë të këtij vendi për prosperitet, për zhvillim dhe që të qëndrojnë këtu, paramendoni, kur e tërë Qeveria do të duhej të ishte këtu dhe të përballej me këtë sfidë serioze, morale, kushtetuese, të cenimit të sigurisë nacionale, të rrënimit përtokë të imazhit të këtij vendi, nuk vjen askush! I dërgojnë do ministra të papërvojë e axhami dhe që nuk e kanë haberin se çka është kushtetutshmëria, çka është rendi juridik, e të tjera, e tjera, apo kanë paraqitje si do t’inejxherë që ende nuk e kanë kryer maturën. Paramendoni kur shefi i AKI-së nuk i përgjigjet komisionit parlamentar dhe ministrat përkatës nuk u përgjigjen komisioneve parlamentare dhe, realisht emëruesi i përbashkët i këtyre liderëve institucionalë është “nuk dimë”. Ne e dimë që ju nuk dini, jeni të paaftë, jeni analfabetë, por një gjë është e keqe, nuk duhet të interferohet në raporte bilaterale me shtete dhe popuj miq, siç është Turqia. Çështjet e brendshme në Republikën e Turqisë janë çështje të tyre, ne po bisedojmë për shkelje kushtetuese, për shkelje ligjore dhe për cenim të sigurisë nacionale dhe rendit kushtetues në vend. Dhe, këto duhet t’i dallojmë qartë, sepse paramendoni që në vitet ’95, ’96 apo ’97, kur tre liderët tanë institucionalë kanë qenë azilkërkues politikë në Zvicër dhe t’i dërgonin në Beograd, paramendoni këta azilkërkues që tani e luajnë rolin e të fortit delegojnë në mënyrë joligjore, nuk ka të bëjë kjo me ekstradim, se ministri i Drejtësisë tentoi të shfajësohet, por jo. Do të vijë shumë shpejt në krye të këtij shteti një qeveri normale dhe do të kërkojë përgjegjësi juridike, penale dhe kushtetuese dhe paramendoni kur të gjithë këta liderë

institucionalë i kanë dërguar dhe i kanë fëmijët e tyre në shkollën “Mehmet Akif”, po ua edukuakan terroristët!

Prandaj, mblidhni çaklat ngadalë dhe çlironi këtë vend, sepse e keni terrorizuar, na e keni ulur autoritetin dhe kohës së këtyre grupeve azilantësh që kanë ardhur dhe po e mbajnë peng këtë vend këto 18 vjet e fundit i ka ardhur fundi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po ta përkujtoj, zoti Rugova, që ata azilantë kanë qenë udhëheqës të luftës dhe pikërisht në saje të tyre ti sot po fol këtu.

Kujtim Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë ju përgëzoj që edhe pas kaq orëve jeni këtu dhe të përqendruar, por ndërhyrja e fundit e kryesuesit të seancës më bëri që të marr fjalën që të bëj dy-tri nënvizime që shkojnë edhe përtej saj.

E para, unë mendoj që debatet e kësaj natyre dhe për çështje të kësaj natyre janë shumë të rëndësishme dhe nuk mund të kthehen në debate të opozitës kundër të tjerëve, çfarë u pa në disa raste ose anasjelltas, ose të një pjese të opozitës, siç ndodhi sot me Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” që më shumë se të komunikojë me institucionet, ka komunikuar me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Kjo zbulon që sa herë që ka opozitë normale, këta nuk duken, sepse atë e bëjmë ne. Tani për debatin e sotëm dhe për çështjen, unë besoj që mungesa e përfaqësuesve të Qeverisë, sidomos mungesa e kryeministrit, jo simbolikisht, por që të japin informacione të reja, të cilat ne nuk i kemi, informacione të mundshme që mund të japë në këtë debat, në esencë e bën të padobishëm, gati e zhbën. Ne po flasim edhe pas katër-pesë ditëve, po flasim sot, kemi debatuar edhe një ditë tjetër, por sot jemi sikur atë ditë. Do të thotë, ne nuk dimë më shumë dhe supozohet, meqë ashtu thonë edhe drejtuesit e shtetit, që as ata nuk dinë më shumë. Dhe, ky është problemi themelor.

Nëse nuk dinë më shumë, mua më duhet të pyesja edhe para katër-pesë ditëve, kush di dhe kush po drejton këtu?

Shkarkimi i ministrit të Brendshëm dhe tentimi që të shkarkohet drejtori i AKI-së në këtë kuptim, kështu si po e shpjegoj unë, duken simbolike, sepse ato shkarkime nuk po çojnë te referenca të reja. Ne nuk po mësojmë më shumë, e nga kjo unë kam frikë që ne e mësojmë një të vërtetë tjetër, që është shumë më e madhe, shumë më e rrezikshme sesa të gjitha këto, që është e pamundur që drejtuesit e shtetit për një çështje kaq të rëndësishme të mos dinë. Është e pamundur. Gjasa është që marrëveshja është që të “mos dinë”, që do të thotë të mos flasin dhe



kjo lidhet me pozicionin e tyre që e kanë me atë që e quajnë “pushtet” dhe unë besoj se ky është gabim i madh.

Kjo e bën të pamundur funksionimin e institucioneve, që ne i quajmë të pavarura dhe kështu i përcakton edhe Kushtetuta, dhe kjo e bën të pamundur edhe funksionimin normal të shumicës. E keni parasysh që Qeveria sot edhe në Kuvend nuk e ka shumicën. Tani ka pasur edhe një komunikim interesant ndërmjet drejtuesve tanë, herë drejtpërdrejt, ose me ndërmjetësim, me përfaqësuesit e Republikës së Turqisë, që është një nga komunikimet më të çuditshme që mund të dëgjohen. Unë, si dhe kolegët e mi të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Grupi ynë Parlamentar, mendojmë që ne nuk duhet ta trajtojmë specifikisht atë sjellje, sepse ata njerëz që komunikojnë ashtu ndërmjet tyre, raportet e tyre ndërmjet tyre i njohin më mirë sesa ne dhe le t'i sqarojnë vetë.

Unë nuk mund t'ia jap një përgjigje specifike konkrete, të prerë, të fortë, ose të butë presidentit të Turqisë, nëse atë përgjigje s'e ka kryeministri dhe ai e di pse s'e ka. Unë s'mund të zhvilloj një komunikim me të, nëse atë komunikim nuk e zhvillon presidenti, as s'mund të flas si deputet, nëse atë nuk e bën kryetari i Kuvendit, sepse këto kështu funksionojnë.

Unë vetë e kam pasur një përvojë në Ministrinë e Jashtme që nga fillimi dhe dëshmoj që Republika e Turqisë është nga vendet që neve na ka ndihmuar në këtë proces dhe që na kanë njohur herët, ata thonë se janë vendi i dytë. E tash çka do të thotë kjo? Na kanë njohur dhe kanë ndihmuar, do të thotë që e njohin subjektivitetin tonë dhe ai që e njih subjektivitetin ndërton partneritet, por komunikimi i tyre ditëve të fundit nuk ka qenë komunikim i partnerit. Ka qenë një komunikim i një natyre tjetër. Prandaj, e vemja gjë që unë mund ta them dhe është e domosdoshme, duhet ta them sonte, është ky që emri i vendit tonë është Republika e Kosovës, e jo “Vilajeti i Kosovës”. Por, para se ta themi ne, duhet ta thonë drejtuesit e shtetit, sepse ata për atë punë janë në krye.

Tani për ju, kolegë të opozitës, të Lëvizjes “Vetëvendosje”, meqë ju po pretendoni që po flisni saktë dhe kundërshtimin politik të LDK-së nuk po e llogaritni të vërtetë, domethënë s'po e konsideroni LDK-në sot si kundërshtar të vërtetë të PDK-së, shiheni gjithë historinë politike të Kosovës. Por, nëse ju edhe pas kësaj e harroni, atëherë si mund të ju konsideroj unë juve kundërshtarë të vërtetë të PDK-së, kur një pjesë e madhe prej jush jeni këtu prej PDK-së, ose nëpërmjet derës së saj, ose si ish-funksionarë të saj, militantë të zjarrtë, kundërshtarë të parë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ashtu jeni edhe sot, sepse e keni atë “legacy” atë trashëgimi, e jo pse jeni ulur sot aty. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë, fjalën e kanë kërkuar Milaim Zeka dhe Arbërie Nagavci.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse ma përmendi emrin Naser Rugova, se edhe unë kam qenë azilant, desha t'i tregoj Naserit shumë miqësisht se duke filluar prej Skënderbeut, që ka qenë azilant, e deri te Ismajl Qemajli, që ka qenë azilant, e deri te Agim Ramadani, te Noli, Fishta e Faik Konica, edhe këta azilantë sikur të mos ishin, edhe dymijë vjet s'do të ishte bërë UÇK-ja. Tash t'i ndajmë gjërat, të flasim për pas 12 qershorit të '99-tës e këndeje, edhe përpara. Nuk është mirë të shfryhemi me inate politike dhe, në fund të fundit, u përmendën Lidhja Demokratike e Kosovës dhe PDK-ja. Mos ia mohoni njeriut, se edhe Hashim Thaçi ka qenë anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ka qenë një lëvizje ku të gjithë kemi qenë bashkë aty, por sikur të mos ishte Diaspora, që e përbëjnë 60% të kombit, Naser Rugova, ti edhe unë edhe dymijë vjet këtu s'do të ishim ulur, por në vend tënd e timin do të ishte ulur veç Rada Trajkoviqi me atë Simiqin, e me "viçat" tjerë. Kështu që, të lutem, kur flet mos i jep shumë hapur e t'i përziësh kështu azilantët, se për mua ishte fyerje shumë e rëndë.

KRYESUESI: Kundër-replikë, Naser Rugova!

NASER RUGOVA: Së pari, koleg deputetë, unë s'ia përmenda emrin askujt, nën një. Dhe, nën dy, unë fola për një proces, që dikush bën deportime apo kidnapime dhe ka qenë azilkërkues politik. Unë kam edhe familjarë që kanë qenë azilkërkues dhe nuk e fyeva askënd, për e bëra një digresion shumë parimor si deputet. Dhe, po këta tre krerët institucionalë kanë qenë azilkërkues dhe iu referova atyre, e askujt tjetër.

Edhe një gjë, po të mos ishte edhe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe vizioni i saj, as ti zotëri nuk do të ishte këtu. Ne jemi kreatorët e krijimit të shtetit të ri të Kosovës, për ty dhe për të gjithë ata tjerët që kanë hezitime. Faleminderit!

KRYESUESI: Je i pasaktë, Naser! Veç dy kanë qenë, njëri s'ka qenë. Edhe ata që kanë ikur dhe këta refugjatët, që po i përmend ti, me pushkë në krah kanë ikur prej këtu, nuk kanë ikur me "me bisht ndër shalë". Ta kesh parasysh, se dallon ajo "me bisht ndër shalë" dhe ta humbë vetveten nga ata që kanë dalë me pushkë në dorë dhe janë kthyer me pushkë në dorë. Zonja Nagavci e ka fjalën për replikë.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti Shala, faleminderit që e përmende historinë politike të LDK-së. Në fakt, është pikërisht historia politike e LDK-së që ka dëshmuar se ju ia keni mundësuar gjithmonë PDK-së jo vetëm të vijë në pushtet, por edhe të keqqueverisë bashkë me PDK-në. Dhe tjetra, meqenëse iu referuat disa herë Thaçit, jeni ju ata që e keni mundësuar bërjen e Hashim Thaçit president të Republikës së Kosovës. Këtë e tregon historia politike e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Meqenëse i përmendët anëtarët tonë që kanë qenë ish-anëtarë të PDK-së, është shumë mirë që secili prej atyre që e shohin se një subjekt i caktuar ka marrë rrugë jo të mirë, të jenë të gatshëm që të gjenden në subjektin që është subjekt që vepron për të mirën e vendit dhe është shumë mirë që ata që kanë reflektuar janë bërë pjesë e Lëvizjes “Vetëvendosje”. Për më tepër, e përmenda edhe pak më herët, në konferencën e fundit për medie, presidenti i vendit Hashim Thaçi e ka shkelur Kushtetutën kur ka shpifur dhe ka akuzuar për një subjekt politik. Kështu që na jepni nënshkrimet që ta dërgojmë në Kushtetuese këtë deklaratë të Thaçit dhe të punojmë për shkarkimin e tij si president.

Dhe, për fund, na jepni nënshkrimet për hetimin e SHIK-ut, nëse vërtet dëshironi të bëni një opozitë, sepse më vjen keq, por historia e LDK-së ka treguar që as sa keni qenë në qeverisje nuk keni qeverisur si duhet, e as në opozitë nuk po e bëni opozitën si duhet.

KRYESUESI: Harrova se i paskan huazuar edhe nja dy a tre kënde prej LDK-së... Kundër-replikë, Kujtim Shala!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqë unë gjithmonë jam në LDK dhe këtë zonjën s’e njoh, unë s’pranoj të flas për historinë e LDK-së, se kur unë s’e njoh i bie që kjo s’ka lidhje me atë punë. Kjo është e para.

E dyta, po të jetë që njerëzit largohen, sepse e kuptojnë që ai subjekt të cilit i takojnë e ka keq, pse e keni gjysmën e partisë prapa, e s’e keni bashkë?

KRYEUSEI: Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Po më vjen mirë që atmosfera u relaksua pak pas kaq shumë debateve serioze gjatë gjithë ditës.

Unë gjithmonë entuziazmohem kështu kur e shoh që “Vetëvendosja” dhe LDK-ja s’kanë tjetër punë veç e akuzojnë njëra-tjetrën se cili është më shumë me PDK-në më shumë, cilin e ka bërë PDK-ja..., por unë nuk i fajësoj sepse për ta cituar Albin Kurtin, PDK-ja është konstante, këta tjerët janë krejt variable dhe do të vazhdojnë të jenë.

KRYESUESI: Glauku tash, Ismajl pastaj ti e ke fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Meqenëse, Kujtimi po do ta marrë parinë e vet si shembull, ndoshta pikërisht prej LDK-së jemi inspiruar, veç nuk i kemi përdorur karriget.

KRYESUESI: Kujtim, tash edhe ti, merre fjalën.

KUJTIM SHALA: Unë me Glaukun e pranoj të debatoj me kënaqësi, por kësaj radhe ai e ka totalisht gabim, sepse s'ka qenë inspirimi juaj, por i grupit tjetër. Ju inspirohuni për diçka tjetër. Por, firmën për Gjykatë Kushtetuese unë jua jap. E SHIK-un keni filluar ta hetoni ju me PDK-në, hetojeni ju me PDK-në.

KRYESUESI: Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Së pari, dëshiroj t'i them Kujtimit që i shikova këta deputetë që janë këtu në "Vetëvendosje" dhe përveç vetvetes sime asnjë s'e pashë që ka qenë më herët në PDK. Mirëpo...,

*(Reagime nga salla)*

Jo, s'ka qenë kurrë Samiu. Samiu kurrë s'ka qenë, as Shema, kurrë nuk kanë qenë, hiç. Pavarësisht! Unë thashë, unë kam qenë dhe kjo nuk është kurrfarë e mete, sepse dukuritë negative i kam luftuar edhe në LDK kur kam qenë, edhe në PDK. Mirëpo, ajo që shpreha mosbesim në iniciativat tuaja është bazuar në të kaluarën tuaj. Ju, në të tri rastet që i përmende ia keni zgjatur jetën PDK-së në pushtet, prandaj s'di ku po e merrni atë fytyrë, pa asnjë vetëkritikë, tash të dilni e të kritikoni.

Njëherë thoni se "kemi gabuar, ia kemi zgjatur jetën", e pastaj "hajde flasim për ndonjë iniciativë, që..."

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Mos u bëni merak fort për PDK-në. Kur të ketë zgjedhje, matemi përsëri. Mendoj se ka përfunduar. Ka përfunduar debati, nuk ka më. Ka përfunduar debati. Fjalën e ka ushtruesi i kërkesës, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Me kryetarët e grupeve parlamentare ne diskutuam dhe i dakorduam rekomandimet. Ato janë si në vijim, të dakorduara me të gjitha grupet parlamentare dhe i falënderoj që u bashkuan në këtë nismë të LDK-së.

1. Të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar për ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018.

2. Kërkohet nga grupet parlamentare që brenda tri ditësh t'i dërgojnë në Kryesinë e Kuvendit emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë komision, në përputhje me Ligjin për hetimet parlamentare.

3. Në funksion të ndriçimit të plotë të kësaj çështjeje, Kuvendi i obligon të gjitha institucionet relevante që lidhen me çështjen në fjalë t'u përgjigjen kërkesave të Komisionit Hetimor Parlamentar.

4. Kuvendi e mandaton Komisionin Hetimor Parlamentar ta shqyrtojë përputhshmërinë e procedurave të ndjekura lidhur me këtë rast me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e dëshiron fjalën. Atëherë, unë i hedh në votim rekomandimet e miratuara nga kryetarët e grupeve parlamentare bashkë me ushtruesin e kërkesës.

Në sallë janë 64 deputetë. Ju lus që të përgatiteni për votim. Votojmë tani!

Atëherë, edhe një është pa kartelë, zoti Reçica. A ka dikush tjetër pa kartelë, ose që është vonuar?

Kanë votuar 61 deputetë, 59 janë për, 1 ka abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi rekomandimet dhe besoj që kryetarët e grupeve parlamentare do të procedojnë.

Ju kisha lutur që nesër, kush është anëtar i Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare, mbledhje në orën 10:00.

I kemi shumë çështje për t'i shqyrtuar gjatë javës së ardhshme. Sot s'ka pasur kuorum, prandaj e lus edhe Sekretarinë që t'i thërrasë ata që s'janë të pranishëm këtu. Mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*